



PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR

Eficiencën e Energjisë

PVVEE - MIRDITË
2025 – 2028



Financuar nga
Bashkimi Evropian

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR

Eficiencën e Energjisë

PVVEE – MIRDITË

2025 – 2028

Projekti EFFORT - “Përmirësimi i Objekteve për një të Ardhme me një Trajektore Optimale të Burimeve dhe Eficiencës së Energjisë” ka për qëllim përmirësimin e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike të Bashkisë Mirditë dhe Komunës Junik. Përmes implementimit të teknologjive inovative dhe masave për reduktimin e konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të gazeve të efektit serrë, projekti do të ndihmojë në përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ndërtesave dhe do të kontribuojë në uljen e ndikimeve negative mjedisore. Gjithashtu, projekti fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Mirditë dhe Komunës Junik, Kosovë, si dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira. Pjesë e rëndësishme është edhe rritja e ndërgjegjësimit publik për përfitimet e eficiencës së energjisë dhe zbatimi i masave për edukimin dhe përfshirjen e komunitetit në këtë proces.



Deklarim

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit EFFORT - “Përmirësimi i Objekteve për një të Ardhme me një Trajektore Optimale të Burimeve dhe Eficiencës së Energjisë”, i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit IPA Cross-Border Shqipëri-Kosovë. Pikëpamjet dhe konkluzionet e përfshira në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian, Programit IPA Cross-Border Shqipëri-Kosovë apo institucioneve të tjera partnere. Dokumenti është hartuar nga ekspertët e projektit bazuar në informacionin dhe njohuritë më të mira të disponueshme.

Ky material mund të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në projekt dhe nuk mund të shpërndahet ose modifikohet pa miratimin paraprak të palëve përkatëse. Për çdo informacion shtesë ose kërkesa të tjera, ju lutemi të kontaktoni autoritetet përkatëse të projektit.



MIRËNJOHJE

Plani Vendor i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PVVEE) për Bashkinë Mirditë është hartuar falë bashkëpunimit të ngushtë midis Bashkisë Mirditë dhe projektit EFFORT - “Përmirësimi i Objekteve për një të Ardhme me një Trajektore Optimale të Burimeve dhe Eficiencës së Energjisë”.

Procesi i hartimit të PVVEE-së në Bashkinë Mirditë është mbështetur nga Kryetari, Albert Mëlyshi, dhe Nënkryetari, Gjergj Prenga, të cilët kanë marrë pjesë në aktivitetet dhe takimet me palët e interesit dhe kanë angazhuar stafin e bashkisë në grumbullimin dhe verifikimin e të dhënave.

Procesi u koordinua nga Koordinatori i Projektit “EFFORT”, Nik Nikolli, në bashkëpunim me Julian Tusha, Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit; Ariel Marku, Drejtor i Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes; Vjollca Gjoka, Drejtor e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim-Taksave; Aurel Çupi, Drejtor i Agjencisë së Arsimit, Sportit dhe Ndhmës Sociale; Manjola Doda, Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore, Juridik dhe Marrëdhënieve me Qytetarët; Zef Margjini, Përgjegjës i Inspektoriatit të Mjedisit dhe Pyjeve; Gjin Mandreja, Administrator i Njesisë Administrative Rrëshen; Armando Ndoj, Administrator i Njesisë Administrative Rubik; Adriana Laska, Specialiste dhe Zëdhënëse Shtypi; dhe Gjovalin Marfana, Përgjegjës i Njesisë për Koordinimin e Integritetit Evropian dhe Projekteve. Kontributi i tyre ka qenë thelbësor për sigurimin e të dhënave bazë, përcaktimin e objektivave të eficiencës së energjisë dhe formulimin e strategjisë së zbatimit të masave, duke siguruar që këto masa të jenë realiste dhe të zbatueshme në kontekstin lokal.

Një falenderim i veçantë shkon për ekspertët e CoPlan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, të cilët realizuan një analizë të detajuar të të dhënave të disponueshme, duke përcaktuar situatën aktuale të eficiencës së energjisë, identifikimin e potencialeve të kursimit dhe vlerësimin e reduktimit të gazeve të efektit serrë.

Përkushtimi dhe profesionalizmi i ekspertëve të CoPlan, përfshirë z. Elvis Ndreka, znj. Rudina Çopa, z. Imeldi Sokoli, znj. Greta Shehu, znj. Enkela Poro, znj. Fiona Imami, znj. Kejt Dhrami dhe znj. Ogerta Gjikhuri, znj. Erinda Dheskali dhe znj. Klesta Galanxhi kanë qenë kyç në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik.

Ky bashkëpunim i frytshëm shërben si një shembull i mirë i përpjekjeve të përbashkëta për të arritur objektivat e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së energjisë në nivel vendor.

Falenderime të sinqerta për të gjithë të përfshirët në këtë proces!

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR EFICIENCËN E ENERGJISË

Bashkia Mirditë

për periudhën 2025-2028

Plani Vendor i Veprimit Për Eficiencën e Energjisë për Bashkinë Mirditë përcakton strategjinë e zhvillimit të eficiencës së energjisë në nivel vendor dhe masat që do të zbatohen me prioritet gjatë periudhës trevjeçare 2025-2028 në përputhje me dispozitat e nenit 9/1, të ligjit nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar.

1.1 Të dhëna për personat përgjegjës

Emri, mbiemri dhe kontaktet e personave përgjegjës për menaxhimin e energjisë nga njësia e qeverisjes vendore, përgatitja e programit dhe miratimi i tij jepen në tabelat e mëposhtme:

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës (menaxheri i energjisë)	Gjergj Prenga
Adresa/ kodi postar/ Bashkia	Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen
Telefon	+355 216 22 33

Grupi i punës për zhvillimin e planit			
Emri	Mbiemri	Pozicioni	E-mail
Gjergj	Prenga	Nënkryetar i Bashkisë	gjergj.prenga@bashkiamirdite.gov.al
Zef	Margjini	Përgjegës i SMP	zef.margjini@bashkiamirdite.gov.al
Aurel	Çupi	Drejtor AASNS	aurel.cupi@bashkiamirdite.gov.al
Nik	Nikolli	Koordinator Projekti EFFORT	nidoni2000@yahoo.com
Adenis	Dedaj	Specialist DPZHT	Adenis.dedaj@bashkiamirdite.gov.al

Përmbajtja

1. Kuadri i përgjithshëm	8
1.1 Kuadri Ligjor Ekzistues	18
1.1.1 Baza e Planit Vendor të Eficiencës së Energjisë	18
1.1.2 Përcaktimet Ligjore të Detyrimeve të Bashkisë	18
1.1.3 Baza Ligjore	19
1.2 Qëllimi dhe Objektivat e Planit Vendor të Veprimit të Eficiencës së Energjisë	23
1.3.Procedurat per Hartimin dhe Miratimin e PVVEE	24
1.4 Zbatimi dhe Monitorimi	25
2. Situata aktuale e konsumit të energjisë	26
2.1 Objektet dhe aktivitetet/ shërbimet e njësive të qeverisjes vendore	28
2.1.1 Vështrim i përgjithshëm i konsumit të energjisë	28
2.1.2 Konsumi i energjisë në ndërtesat publike	31
2.1.3 Sistemi i furnizimit me ujë	39
2.1.4 Sistemi i trajtimi/ largimit të ujërave të zeza	41
2.1.5 Ndriçimi publik dhe sinjalistika e trafikut	41
2.1.6 Transporti publik	43
2.1.7 Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve	45
2.1.8 Makinat e pasagjerëve dhe minibuset (nën juridiksionin e njësive të qeverisjes vendore)	48
2.1.9 Bujqësia	51
2.2 Konsumi i energjisë në sektorin rezidencial dhe sektorët e tjerë	53
3. Vizioni dhe analiza e gjetjeve për Eficiencën e Energjisë në Bashkinë Mirditë	55
3.1 Vizioni	55
3.2 Gjetjet Kryesore	56
3.3 Analiza e Gjetjeve	56
4. Masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë	56
EE1 Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Energjisë	58
EE1.1 Krijimi i Kornizës për Menaxhimin e Energjisë	59
EE1.2 Analiza dhe vlerësimi i performancës energjetike në ndërtesat publike	59
EE1.3 Rritja e Kapaciteteve për Menaxhimin e Eficiencës së Energjisë	60
EE2 Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë në Ndërtesa Publike	61
EE2.1 Instalimi i paneleve fotovoltaike në ndërtesa publike	61
EE2.2 Zëvendësimi i Kaldajave të naftës me Kaldaja elektrike/pellet	62
EE2.3 Sistemet e Izolimit Termik	63
EE2.4 Sisteme Inteligjente për Menaxhimin e Energjisë	63
EE2.5 Instalimi i Paisjeve Eficiente	64
EE3 Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë në Shërbimet e Bashkisë	65
EE3.1 Përmirësimi i eficiencës së energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe vaditjes	65
EE3.2 Përmirësimi i Ndriçimit Publik	65
EE3.3 Përmirësimi i Flotës së Automjeteve të Bashkisë	66
EE4 Përfshirja e Komunitetit dhe Bizneseve në Eficiencën e Energjisë	67
EE4.1 Fushata Informative dhe Ndërgjegjësuere për Komunitetin	67
EE4.2 Promovimi i Eficiencës së Energjisë për Bizneset	68
EE4.3 Masa Lehtesuese për Komunitetin dhe Bizneset	68
4.1 Pasqyra e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë	69
4.1.1 Analiza e Emetimeve të Gazeve të Efektit Serrë	69
4.1.2 Pasqyra e Kostove të Masave dhe Reduktimi i CO ₂	70
4.2 Analiza e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë	74
4.2.1 Analiza e Kostos dhe Përfitimeve Mjedisore dhe Sociale	75
5. Skemat e financimit dhe plani financiar	76
5.1 Skemat e financimit	76
5.2 Skema e Financimit	77
6. Referencat	79

Figura

Figura 1. Harta e Relievit në Bashkinë Mirditë	9
Figura 2. Harta e ndarjes klimaterike të Shqipërise	10
Figura 3. Pozicioni Gjeografik i Bashkisë Mirditë. (CoPlan, 2024)	11
Figura 4. Harta e dendësisë së popullsisë	13
Figura 5. Harta e Përdorimit të tokës në Bashkinë Mirditë	14
Figura 6. Organigrama e Bashkisë Mirditë	17
Figura 7. Potenciali i Energjisë Fotovoltaike dhe Rrezatimi Normal Direkt në Shqipëri	27
Figura 8. Relievi, Sistemi ujqor dhe vendodhja e HEC në territorin e Bashkisë Mirditë	28
Figura 9. Konsumi mesatar vjetor i energjisë elektrike në Bashkinë Mirditë sipas kategorisë së klientëve	30
Figura 10. Shpërndarja e ndërtesave arsimore sipas llojit dhe NJA	37
Figura 11. Lidhjet e ujit me ujësjellësin	41
Figura 12. Konsumi i ujit sipas vendndodhjes së banorëve	41
Figura 13. Infrastruktura rrugore në NJA Rrëshen	45
Figura 14. Sasia e mbetjeve të gjeneruara për secilën njësi administrative	46
Figura 15. Trendi i sasisë së mbetjeve të gjeneruara sipas NJA	47
Figura 16. Frekuenca e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve për NJA	48
Figura 17. Mjetet e Bashkisë Mirditë sipas vitit të prodhimit	50
Figura 18. Ndarja e mjeteve sipas lëndës djegës	51
Figura 19. Numri i mjeteve sipas llojeve kryesore për Bashkinë Mirditë	51
Figura 20. Sipërfaqja e kulturave të mbjella, 2019	52
Figura 21. Shpërndarja e bizneseve dhe fermave për çdo NJA	55
Figura 22. Shpërndarja e sipërfaqeve bujqësore për çdo NJA	56

Tabela

Tabela 1. Njësitë Administrative dhe popullsia e tyre	12
Tabela 2. Shpërndarja e Numrit të Bizneseve, Fermave dhe Sipërfaqeve Bujqësore për çdo NJA	15
Tabela 3. Shpërndarja e ndihmës sociale për bashkinë Mirditë	16
Tabela 4. HEC-et në territorin e bashkisë Mirditë	29
Tabela 5. Konsumi total i energjisë dhe kostot sipas llojit të burimit të energjisë për vitin 2023	31
Tabela 6. Konsumi total i energjisë sipas sektorëve	32
Tabela 7. Ndërtesat publike të ndara sipas qëllimit të përdorimit	32
Tabela 8. Kontratat e energjisë për bashkinë Mirditë me konsumin më të lartë të energjisë	33
Tabela 9. Performanca energjetike e ndërtesave publike	35
Tabela 10. Sipërfaqja Totale dhe Sipërfaqja e Kushtëzuar e ndërtesave	36
Tabela 11. Ndërtesat Arsimore sipas llojit për çdo Njësi Administrative	36
Tabela 12. Të dhënat e kalidajave për vitin 2023.	38
Tabela 13. Të dhënat e konsumit të drurit për ngrohje për vitin 2023	39
Tabela 14. Konsumi i energjisë elektrike për ndriçim rrugor dhe sinjalistikë për vitin 2023	43
Tabela 15. Gjatësia dhe Sipërfaqja e rrugëve	43
Tabela 16. Të dhënat për ndriçimin rrugor	44
Tabela 17. Të dhënat e përgjithsme të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve	47
Tabela 18. Mjetet bujqësore në bashkinë Mirditë	53
Tabela 19. Konsumi i energjisë elektrike në Mirditë	54
Tabela 20. Pasqyra e Kostove të Masave, Kursimeve dhe Reduktimi i GES	72
Tabela 21. Analiza Financiare e Masave të Eficiencës së Energjisë	76
Tabela 22. Burimet e financimit dhe plani financiar i përmirësimit të eficiencës së energjisë	78


1. KUADRI I PËRGJITHSHËM

Të dhënat mbi bashkinë Mirditë janë paraqitur duke ofruar një analizë të detajuar për secilën prej tyre. Kjo qasje synon të japë një pasqyrë të plotë dhe të qartë të situatës aktuale, duke mundësuar një kuptim më të thelluar të karakteristikave dhe sfidave të bashkisë.

Bashkia Mirditë është një zonë me një histori të pasur dhe një gjeografi të larmishme që shtrihet midis maleve dhe fushave të Shqipërisë veriore, me koordinata gjeografike $41^{\circ} 43'$ e $41^{\circ} 59'$ gjerësi veriore dhe $19^{\circ} 43'$ e $20^{\circ} e 12'$ gjatësi lindore. Nga

pikëpamja fizike territori karakterizohet nga formacione malore, lugina, pllaja, fusha dhe fushëgropa. Bashkia Mirditë është e rrethuar nga malet Terbun, dhe Munellës në veri dhe veri - perëndim, malet Kaçinar, Zepes, Lures, Shejtit, Kullgjatë perëndim - jug-perëndim, dhe Patokut, Veles, Dervenit në lindje. Lartësia mesatare arrin në 557 m mbi nivelin e detit, me Majën më të lartë, Mali i Dejës (2121 m). Territori përshkohet nga lumenjtë Fani i Madh, Fani i Vogël, Uraka. Këta lumenj si dhe përrenj të tjerë malorë, kanë jo vetëm kapacitete prodhuese energjetike, por edhe për kultivimin e faunës ujore.

Figura 1. Harta e Relievit në Bashkinë Mirditë.



Burimi: CoPLAN, 2024

Siç mund të vemë re në figurën e mësipërme, ku është paraqitur harta e relievit të territorit, mjedisi natyror i bashkisë Mirditë është i pasur me pyje, vendburime

minerare, burime hidrike me potencial ujitës e hidroenergjetik si dhe veçoritë e saj peisazhistike, karakterizuar nga një shumëllojshmëri relievësh (male, lugina,


shpate, etj.) Ekosistemet pyjore të masiveve gjysmë-malore dhe malore të bashkisë dhe të zonave parabregore (Fan i Madh, Fan i Vogël) sigurojnë kushte të favorshme për ruajtjen e larmishmërisë së florës dhe faunës.

Shqipëria ka një klimë tipike mesdhetare, me dimër të lagësht, të butë dhe verë të nxehtë dhe të thatë. Regjimi i klimës ndikohet herë pas here nga sistemet atmosferike, si përplasje nga Oqeani Atlantik i Veriut dhe Deti Mesdhe, dhe anticiklone që vijnë nga Siberia dhe Azoret. Një faktor tjetër kyç që ndikon në klimën është afërsia me detin.

Territori i Shqipërisë është i ndarë në katër zona të ndryshme klimatike:

- Mesdhetare Fushore
- Mesdhetare Kodrinore
- Mesdhetare Paramalore
- Mesdhetare Malore

Figura 2. Harta e ndarjes klimaterike të Shqipërisë



Burimi: IHM


Klima në bashkinë Mirditë është kryesisht mesdhetare-malore dhe mesdhetare paramalore, me karakteristika të qarta të klimës së rajoneve malore dhe ndikime mesdhetare nga ultësirat përreth. Karakteristikë e klimës janë dimri i ftohtë me reshje të dendura, shpeshherë me dëborë në lartësitë më të mëdha, dhe verë e ngrohtë dhe e thatë, veçanërisht në zonat e ultësirave. Në lartësitë më të ulëta, temperaturat janë më të buta në krahasim me zonat malore, ndërsa lartësitë më të mëdha si mali i Munellës kanë dimër të gjatë dhe të ashpër me reshje të shumta dëbore.

Reshjet janë relativisht të larta gjatë gjithë vitit, por kryesisht në vjeshtë dhe dimër. Gjatë periudhës së dimrit ka më shumë reshje sesa në verë, me një mesatare prej 1'335 mm. Sasia më e vogël e reshjeve bie në korrik ndërsa sasia më e madhe e reshjeve bie në nëntor, mesatarisht 178 mm. Ky tipar ndikon pozitivisht në pyjet e dendura dhe pasuritë natyrore të zonës, si dhe në mbajtjen e burimeve ujore që furnizojnë zonat bujqësore dhe blegtorale të bashkisë. Kjo klimë është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e veprimtarive ekonomike lokale, si bujqësia, blegtoria dhe pylltaria.

Klima e bashkisë Mirditë, megjithëse ndihmon në ruajtjen e pasurive natyrore, përbën gjithashtu sfida për komunitetin, veçanërisht për infrastrukturën e ngrohjes në dimër, duke ndikuar në kostot e energjisë dhe përballjen me varfërinë energjetike.

Nga pikëpamja administrative, bashkia Mirditë kufizohet në veri me bashkinë e Fushë-Arrëzit dhe bashkinë Pukë, në perëndim me bashkinë Lezhë dhe në lindje me bashkinë Kukës dhe bashkinë Dibër. Në jug me bashkinë Mat dhe bashkinë Kurbin. Në figurën e mëposhtme mund të shikojmë vendndodhjen gjeografike të bashkisë Mirditë në Shqipëri duke pasqyruar dhe numrin e popullsisë për çdo njësi administrative, sipas të dhënave të Censusit 2023, e cila varion nga 275 banorë në NJA Kaçinar, në rreth 6,773 banorë në NJA Rrëshen.

Figura 3. Shpërndarja e popullsisë në bashkinë Mirditë



Burimi: CoPLAN, 2024

Në përputhje me Ligjin 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i cili ripërcaktoi kufijtë e njësive lokale dhe rajonale, bashkia Mirditë ka një sipërfaqe prej 870 km² dhe përbëhet prej njësive administrative Rrëshen, Rubik, Selitë, Kthellë, Fan, Orosh dhe Kaçinar.

NJA Rrëshen ka një sipërfaqe prej 120 km² dhe përfshin fshatrat: Ndërfushas, Ndërfan, Gëziq, Tarazh, Jezull, Kodër Rrëshen, Sheshaj, Fushë-Lumth, Malaj, Malaj Epërm, Tenë, Lurth, Bukmirë dhe Kulmë.

NJA Rubik ndodhet në pjesën perëndimore të qytetit të Rrëshenit dhe ka një sipërfaqe prej 140,5 km², në një distancë rrugore prej 11 km larg nga qendra e bashkisë Rrëshen. Kjo njësi përfshin fshatrat: Fierzë, Bulshizë, Fang, Rasfik, Katund i Vjetër, Munaz, Rreja e Zezë, Rreja e Veles, Vau Shkezë, Rrethi i Sipërm, Livadhëz dhe Bulger.

NJA Selitë shtrihet në pjesën lindore të qytetit të Rrëshenit me një distancë 36 km larg qendrës së bashkisë dhe me një sipërfaqe prej 101 km². Kjo njësi përbëhet nga fshatrat: Kurbnesh, Lufaj, Bardhaj, Lëkundë, Zajs, Kthellë e Sipërme, Kurbnesh-fshat, Mërkurth dhe Kumbull.

NJA Kthellë shtrihet në pjesën jugore të qytetit të Rrëshenit, në një distancë prej 13 km. Ajo përbëhet nga fshatrat: Perlat Qendër, Perlat i Sipërm, Shebe, Tharr, Trojë, Prosek, Rushkull, Ujë dhe Shtrezë.

NJA Fan shtrihet në pjesën veri-lindore të qytetit të Rrëshenit me distancë 42 km. Territori i njësive përbëhet nga fshatrat: Klos, Shtrungaj, Bisakë, Fan, Zall- Xhuxhë, Katundi i Ri, Konaj, Shëngjin, Petoq, Xhuxhë, Dardhëz, Thirrë, Sang, Hebe, Domgjon, Gjakëz dhe Munellë.

NJA Orosh shtrihet në pjesën veri-lindore të qytetit të Rrëshenit me një distancë prej rreth 23 km. Ajo përfshin fshatrat si: Reps, Kullaxhi, Blinisht, Pshqesh, Mashtëkor, Shëmri, Grykë Orosh, Lgjin, Bulshar, Planet, Ndërshen, Nënshajt, Kodër-Spaç, Gurth-Spaç dhe Lajthizë.

NJA Kaçinar shtrihet në pjesën veriore të qytetit të Rrëshenit në një distancë prej 26 km dhe përfshin fshatrat: Kaçinar, Arrëz, Kuzhnen, Simon, Shëngjergj, Shtuf dhe Shpërdhezë. Qendra e bashkisë është qyteti i Rrëshenit.


Tabela 1. Njësitë Administrative dhe popullsia e tyre

Njësia Administrative	Nr i fshatrave për çdo NJA	Nr gjithsej i popullsisë	Nr i popullsisë Femra	Nr i popullsisë Meshkuj
Bashkia Mirditë		13,625	6,818	6,807
Rrëshen	14	6,773	3,423	3,350
Rubik	12	2,550	1,301	1,249
Orosh	14	900	443	457
Fan	17	1,585	768	817
Kaçinar	7	275	122	135
Kthellë	9	1,202	588	614
Selitë	8	358	173	185

Sipas censusit të vitit 2011, popullsia e regjistruar e bashkisë Mirditë ka qene 37,091 banorë, me dendësi mesatare 42.98 banorë/ km², ndërkohë që sipas të dhënave të gjendjes civile, në vitin 2020, bashkia Mirditë ka pasur 22'103 banorë, në një sipërfaqe prej 870 km², e cila tregon një rënie të dendësisë së popullsisë në 25.41 banorë/ km². Të dhënat e Censusit 2023 tregojnë një rënie të mëtejshme të numrit të popullsisë dhe dendësisë. Të dhënat për njësitë administrative sipas të dhënave të Censusit 2023 dhe ndarja e popullsisë sipas gjinisë për secilën NJA janë të paraqitura në

tabelën e mësipërme vëmë re se në vitin 2023 popullsia e bashkisë Mirditë ishte 13,625 banorë, me një rënie të popullsisë me rreth 63 % nga viti 2011. Dendësia e popullsisë për vitin 2023 është 15.66 banorë/ km². Qendra administrative e bashkisë, qyteti i Rrëshenit, është një pikë referimi kryesore për banorët e zonës dhe luan një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të komunitetit dhe përfaqëson përqendrimin më të madh të popullsisë, me 50% të banorëve. Po ashtu, aty gjenden shumica e bizneseve dhe ndërtesave të tjera që janë në funksion të qytetarëve.

Figura 4. Harta e dendësisë së popullsisë



Burimi: CoPLAN, 2024

Sikurse vërehet dhe në figurën e mësipërme, dendësia më e lartë e popullsisë është në NJA Rrëshen dhe NJA Rubik, kjo për faktin se këto zona përbëjnë qendrat kryesore urbane dhe ekonomike të Bashkisë Mirditë, ku janë përqendruar më shumë shërbime publike dhe mundësi punësimi.


Ekonomia e Bashkisë Mirditë është kryesisht e orientuar drejt sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë, me një përqendrim të veçantë në vreshtarinë dhe zhvillimin e agrobiznesit. Megjithatë rajoni ka një histori të pasur të industrisë minerare, me pasuri nëntokësore si bakri, piriti dhe kromi, shumica e këtyre

aktiviteteve janë ndalur. Ky ndryshim ka ndikuar negativisht në ekonominë lokale dhe ka çuar në një nivel të lartë të migrimit të brendshëm dhe emigrimit, duke e bërë Mirditën një zonë me shifrat më të larta të largimit të popullsisë në Shqipëri.

Ndërtimi i autostradës A1, e njohur si Rruga e Kombit, ka përmirësuar lidhjen e Mirditës me

pjesën tjetër të vendit dhe me Kosovën, por impakti i kësaj rruge në zhvillimin ekonomik të zonës ka qenë modest. Bashkia vazhdon të përballet me sfida të mëdha infrastrukturore dhe përmirësimi i saj mbetet një prioritet për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të zonës. Në figurën e mëposhtme është paraqitur harta e përdorimit të tokës në bashkinë Mirditë.

Figura 5. Harta e sistemeve të territorit në Bashkinë Mirditë



Burimi: CoPLAN, 2024

Sipërfaqja e territorit të Bashkisë është 870 km², dhe përben rreth 3% të sipërfaqes së territorit të Republikës së Shqipërisë. Nga sipërfaqja e Bashkisë, vetëm 1% e sipërfaqes është sistem urban, ndërsa 99% e saj është e përbërë nga sistemet bujqësore, ujore dhe natyrore. Sa i përket aktivitetit ekonomik,

vihet re një diferencë e madhe në numrin e bizneseve ndërmjet qytetit të Rrëshenit dhe njësive të tjera administrative.

Në Rrëshen, zhvillimi ekonomik dhe bujqësor është më i përparuar, duke e bërë atë njësinë më të rëndësishme me 264

biznese dhe 983 ferma bujqësore, si dhe sipërfaqe të madhe toke bujqësore (1,857 ha). NJA Rubik gjithashtu tregon përqendrim të konsiderueshëm në aktivitete bujqësore me 624 ferma, por ka sipërfaqe më të vogël toke (566 ha). NJA Rrëshen dhe Rubik kanë numrin më të madh të bizneseve për të gjithë bashkinë, por NJA Rubik ka vetëm 30 % të numrit të bizneseve të NJA Rrëshen.

Zhvillimi ekonomik në njësitë më të vogla si Kaçinar, Kthellë, dhe Selitë, kryesisht mbështetet tek bujqësia, me vetëm 1

ose 2 biznese. NJA Kthellë, megjithëse ka vetëm një biznes, zotëron një sipërfaqe të tokës bujqësore prej 1,485 ha dhe një numër relativisht të lartë të fermave, që tregon potencial për zhvillim të mëtejshëm bujqësor.

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e numrit të bizneseve, fermave dhe sipërfaqes së tokës bujqësore në çdo njësi administrative. (Bashkia_Mirditë, VLERËSIMI I SITUATËS SË QEVERISJES VENDORE NË SHQIPERI – VALA 2, 2020)

Tabela 2. Shpërndarja e Numrit të Bizneseve, Fermave dhe Sipërfaqeve Bujqësore për çdo NJA

Njësia Administrative	Nr i bizneseve gjithsej	Nr i fermave gjithsej	Sipërfaqe e tokës bujqësore
Rrëshen	264	983	1'857
Rubik	76	624	566
Orosh	18	370	648
Fan	29	595	731
Kaçinar	2	269	526
Kthellë	1	600	1'485
Selitë	2	276	505

Një ndër sfidat kryesore në bashkinë Mirditë është niveli i lartë i papunësisë, i cili arrin në rreth 25%. Sektorët e bujqësisë, pylltarisë, dhe shërbimit janë sektorët ku punësohet pjesa më e madhe e popullsisë, por mungesa e mundësive për të rinjtë dhe personat mbi 50 vjeç është evidente. Problemet sociale si dhuna në familje, mungesa e qendrave për mbrojtjen dhe trajtimin e grave dhe fëmijëve të dhunuar, si dhe vështirësitë për personat me aftësi të kufizuara, janë shqetësuese.

Për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, është thelbësore që të ketë një qasje të integruar që përfshin të gjitha grupet e interesit, të përmirësohet infrastruktura dhe të krijohen mundësi për edukim dhe trajnim profesional.

Sipas një studimi të fundit, të financuar nga Komuniteti i Energjisë, të paktën 37% e shqiptarëve vuajnë nga varfëria energjetike (DOOR/EIHP, 2021:229), vlerë kjo rreth 4 herë më e lartë se mesatarja europiane (9%). Varfëria energjetike reflektohet në ngrohjen e vetëm një dhome, për vetëm 6–8 orë në ditë. Shumica e familjeve përdorin dru për të ngrohur shtëpitë e tyre të cilat kryesisht nuk kanë izolim apo dritare eficiente. Uji i nxehtë shpesh prodhohet me kaldaja elektrike. Si rezultat, kostot e energjisë konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të tyre.

Kjo situatë është veçanërisht e rënduar për familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, ku mbështetja financiare është shpesh e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat energjetike bazë. Për këtë arsye, nevoja për

masa të mirëstrukturuara për përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe rritjen e mbështetjes financiare për familjet në nevojë është e një rëndësie të veçantë, veçanërisht në bashki si Mirdita, ku sfidat ekonomike dhe kushtet klimatike përkeqësojnë problemin e varfërisë energjetike.

Po të shohim tabelën e mëposhtme, vihet re se rreth 9% e familjeve në Bashkinë

Mirditë përfitojnë ndihmë ekonomike, ose nëse e shprehim me shifra, 1063 familje nga 11'853 famije në total janë pjesë e skemës së mbështetjes sociale, nga të cilat 620 ndihma ekonomike, ose 58%, janë pagesa për paaftesi, ndërsa 38% janë për arsye të tjera. Njësia Administrative me përqindjen më të lartë të numrit të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është NJA Selitë, me 18.7%. (Bashkia_Mirditë, 2020)

Tabela 3. Shpërndarja e ndihmës sociale për Bashkinë Mirditë

Njësia Administative	Nr i Familjeve	Përfituesit e Ndihmës Ekonomike - Numër Familjesh	Numri i popullsisë përfituese të pagesës së paaftesisë	Përqindja e familjeve që përfitojnë Ndihmë Ekonomike	Fondi gjithsej i Ndihtes Ekonomike (Lekë)
Bashkia Mirditë	11'853	1'063	620	8.3	58'338'517
Rrëshen	5173*	250	230	6.5	14'236'629
Rubik	2653	117	108	4.4	6'724'428
Orosh	1065	83	52	7.8	4'761'284
Fan	1394	241	87	17.3	5'249'624
Kaçinar	*	85	32	*	15'653'812
Kthellë	1123	119	60	10.6	7'030'344

**Njësitë Administrative Rrëshen dhe Kaçinar bashkëndajnë të njëjtin regjistër të gjendjes civile, prandaj evidencat për Njësinë Kaçinarin janë të përfshira tek numri total për NJA Rrëshen*

Struktura e Bashkisë Mirditë luan një rol kyç në zhvillimin dhe implementimin e planeve vendore, duke siguruar një koordinim efektiv ndërmjet sektorëve të ndryshëm për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Organigrama e Bashkisë Mirditë, e paraqitur ne figurën më sipër, përfaqëson strukturën organizative dhe mënyrën se si janë të ndara funksionet, hierarkinë e institucioneve dhe mënyrën e lidhjes ndërmjet drejtorive dhe agjencive për të siguruar një menaxhim të mirë dhe të koordinuar. Çdo drejtori dhe agjenci ka një rol specifik në realizimin e objektivave të bashkisë, duke kontribuar në funksionimin efikas të saj në fushat e

drejtësisë, financave, planifikimit urban, shërbimeve sociale dhe publike.


Organigrama përfshin një sërë drejtorish dhe agjencish që mbulojnë funksione të ndryshme administrative dhe operative:


- Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Rregullit të Brendshëm – Siguron respektimin e ligjeve dhe rregulloreve, mbikëqyr prokurimet publike dhe menaxhon disiplinën e brendshme.
- Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Supervizionit - Përcakton dhe menaxhon buxhetin, mbikëqyr financat e bashkisë dhe siguron përdorimin efikas të burimeve financiare.

- Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit – Merret me planifikimin e territorit dhe zhvillimin urban, duke përfshirë edhe politikën e strehimit.
- Agjencia e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Kulturës – Ofron shërbime sociale dhe promovon arsimin dhe kulturën në komunitet.
- Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave – Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe standardeve dhe menaxhon emergjencat lokale.
- Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes – Merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës publike dhe menaxhimin e projekteve të punëve publike.

Këto drejtori dhe agjenci luajnë një rol thelbësor në përgatitjen dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe në zbatimin e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë në Bashkinë Mirditë. Bashkia Mirditë nuk disponon një drejtori apo njësi të dedikuar për përmirësimin e eficiencës së energjisë apo menaxhimin e veprimeve të lidhura me të. Përpjekjet në këtë fushë janë shpesh të fragmentuara dhe të mbështetura kryesisht nga projekte të jashtme apo iniciativa individuale. Kjo mungesë e një strukture të veçantë mund të ndikojë në zbatimin dhe koordinimin e masave të qëndrueshme për eficiencën e energjisë. Prandaj, në plan janë përfshirë një sërë masash të cilat synojnë përmirësimin e sistemit të menaxhimit të eficiencës së energjisë. Këto masa do të ndihmojnë në krijimin e një qasjeje më të strukturuar dhe të qëndrueshme, duke adresuar sfidat aktuale dhe duke përmirësuar performancën energjetike të bashkisë në tërësi.

Figura 6. Organigrama e Bashkisë Mirditë





1.1 Kuadri Ligjor Ekzistues

1.1.1 Baza e Planit Vendor të Eficiencës së Energjisë

Bashkitë në Shqipëri kanë detyrimin ligjor të pregatisin dhe zbatojnë Planin Vendor të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, mbështetur në Ligjin nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë” (ndryshuar me ligjin nr. 5/2019, datë 7 shkurt 2019 dhe nr. 28/2021, datë 8 mars 2021), i cili përcakton detyrimin që ka bashkia dhe Këshilli Bashkiak në Nenin 9/1:

Pika 1. Bashkitë përgatisin planet vendore të veprimit për eficiencë të energjisë në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe me Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës, të cilat përfshijnë politikat dhe masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë për të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel lokal, mbi bazën e konsumit të energjisë në nivel lokal

Pika 2. Para miratimit nga Këshilli Bashkiak, projektplanet vendore të veprimit për eficiencë të energjisë konsultohen me ministrinë dhe agjencinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me përfaqësues të grupeve të interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me politikat kombëtare të eficiencës së energjisë dhe objektivat përkatës.

Pika 3. Plani vendor i veprimit për eficiencë të energjisë dhe raporti i progresit për zbatimin e planit vendor të veprimit për eficiencën e energjisë hartohen sipas formatit të miratuar nga ministri në Urdhërin Nr. 206, Datë 25.10.2022 Për Miratimin e Formatit të Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe Raporti i Progresit për Zbatimin e Planeve.

Pika 4. Bashkitë, përmes menaxherëve të emëruar të energjisë, monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e objektivave të kursimit të energjisë. Për këtë qëllim, në përputhje me parashikimet në fuqi për

bazat e të dhënave shtetërore, bashkitë krijojnë dhe mirëmbajnë bazën e të dhënave për konsumin e energjisë në objektet nën kontrollin e tyre dhe monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, sistemet e ujësjellësve, të ndriçimit dhe të gjitha aktivitetet me konsum të lartë të energjisë.

Pika 5. Bashkitë promovojnë në nivel vendor politikat kombëtare për eficiencën e energjisë dhe informojnë qytetarët për përfitimet nga masat për rritje të eficiencës së energjisë dhe mënyrën e realizimit të tyre.

1.1.2 Përcaktimet Ligjore të Detyrimeve të Bashkisë

Përveç detyrimeve ligjore për PVVEE, Bashkia ka dhe detyrime të tjera të cilat lidhen me energjinë, eficiencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të cilat lindin si detyrime sipas akteve ligjore të përmendura më poshtë:

Ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin e territorit” cakton se kryetari i bashkisë është përgjegjës për zhvillimin e territorit vendor duke hartuar dhe zbatuar dokumentet e planifikimit, të cilat harmonizohen me planet kombëtare dhe sektoriale. Ai koordinon institucionet publike, alokon burimet e nevojshme, dhe dorëzon dokumentet për verifikim të AKPT, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me standardet kombëtare. Ndërsa Këshilli Bashkiak është përgjegjës për miratimin e mjeteve financiare të akorduara nga bashkia për zbatimin e ligjit. Ai miraton dhe rishikon dokumentet vendore të planifikimit, monitoron zbatimin e planeve dhe kuadrin ligjor për pjesëmarrjen publike, dhe shqyrton raportet vjetore mbi zbatimin e objektivave të planifikimit.

Neni 15/1, të Ligjit nr. 124/2015, për të nxitur eficiencën e energjisë në ngrohje dhe ftohje, ministria, në bashkëpunim me

agjencinë për energjinë, bën një vlerësim gjithëpërfshirës të potencialit për aplikimin e teknologjive si kogjenerimi me eficiencë të lartë dhe sisteme të tjera eficiente të ngrohjes dhe ftohjes. Bashkitë kanë detyrim të bashkëpunojnë për zbatimin e masave për mbështetjen dhe zhvillimin e infrastrukturës eficiente, duke përfshirë edhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë për prodhimin e nxehtësisë dhe energjisë elektrike.

Në bazë të përkufizimit të “Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme” në **Ligjin nr. 24/2023 “Për Nxijtjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme”**, bashkitë kanë detyrimin të mbështesin krijimin dhe funksionimin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme. Këto komunitete janë entitete juridike të pavarura dhe vullnetare, që synojnë të sigurojnë përfitime mjedisore, ekonomike dhe sociale për aksionerët dhe anëtarët e tyre. Bashkitë, si pjesë e këtyre komuniteteve, duhet të bashkëpunojnë me persona, NVM (Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) dhe autoritete lokale për të zhvilluar projekte energjie të rinovueshme dhe për të promovuar pjesëmarrjen e hapur dhe të drejtë në këto projekte.

Detyrimet e bashkisë në kontekstin e politikave për energjinë dhe transportin që lindin nga **VKM nr. 480, datë 31.7.2018 “Për Miratimin E Strategjisë Kombëtare Të Energjisë Për Periudhën 2018–2030”** përfshijnë vendosjen dhe zbatimin e standardeve të larta të eficiencës së energjisë në prokurimin e automjeteve dhe shërbimeve publike të transportit. Bashkitë kanë detyrimin ligjor të promovojnë përdorimin e makinave elektrike dhe të ndërmerren hapa konkrete për të përmirësuar infrastrukturën e transportit qytetar në mënyrë të qëndrueshme. Përmbyllja e këtyre detyrimeve ndihmon në uljen e emetimeve të gazrave të efektshëm serë dhe në përmirësimin e cilësisë së mjedisit në bashkitë dhe rajonet përreth.

Neni 56 i Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” rregullon të

drejtat e pronësisë së të licencuarit. Ai lejon të licencuarin të kërkojë përdorimin e të drejtave të pronësisë së tagrave për instalimin e linjave dhe pajisjeve të nevojshme për shërbimin me energji elektrike. Në zonat natyrore të mbrojtura, këto të drejta mund të jepen vetëm me miratimin e autoriteteve për mbrojtjen e natyrës dhe në zonat me mbrojtje lokale, nevojitet miratimi i bashkisë ose komunës përkatëse.

1.1.3 Baza Ligjore

Aktet ligjore të përmendura më poshtë janë të rëndësishme për krijimin e një kornize të qëndrueshme dhe efikase për energjinë elektrike dhe burimet e rinovueshme, duke promovuar eficiencën e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Ato gjithashtu përfaqësojnë përpjekjet e Shqipërisë për t’u integruar në tregjet rajonale dhe europiane të energjisë dhe për të përmirësuar kushtet për investime në sektorin energjetik.

- Ligji nr. 8261, datë 11.12.1997, “Për ratifikimin e Traktatit të Kartës së Energjisë dhe Protokollit të Kartës së Energjisë për eficientësinë e energjisë dhe aspektet përkatëse të mjedisit”. Ky ligj është një hap i rëndësishëm për Shqipërinë në përpjekjet për të përmirësuar eficientësinë e energjisë dhe për të mbrojtur mjedisin, duke përfshirë masa për të reduktuar ndikimin negativ të prodhimit dhe konsumit të energjisë.
- Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, rregullon veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri. Ky ligj përcakton të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë, të administratës publike të përfshirë në këtë sektor, si dhe procedurat për përzgjedhjen dhe zhvillimin e një modeli tregu dhe të rregullave të funksionimit të tij. Ligji synon të sigurojë furnizimin e qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike për konsumatorët, duke promovuar konkurrencën dhe minimizimin e kostove të shërbimit

- Ligji nr. 9560, datë 12.06.2006, “Për ratifikimin e amendamentit të dispozitave, që lidhen me tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë”. Ky ligj është një hap i rëndësishëm për të përmirësuar dhe harmonizuar rregullat tregtare në sektorin e energjisë, duke siguruar një kuadër të qartë dhe të qëndrueshëm për transaksionet ndërkombëtare të energjisë.
- Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” të ndryshuar). Ligji përmban dispozita për parandalimin dhe riparimin e dëmeve mjedisore, duke vendosur përgjegjësi për ndotësit dhe duke promovuar masa për mbrojtjen e mjedisit.
- Ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin e territorit” (ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015, nr. 28/2017, datë 23.3.2017; nr. 42/2019, datë 4.7.2019, nr. 119/2020, datë 7.10.2020, shfuqizuar pjesërisht një pikë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 41/2024, datë 2.5.2024), Ky ligj synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit përmes përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore, duke balancuar nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore. Ndryshimet e bëra kanë për qëllim të përmirësojnë dhe përshtatin më tej dispozitat e ligjit për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të harmonizuar të territorit.
- Ligji nr. 43/2015, “Për energjinë elektrike dhe gazin” (ndryshuar me vendimin nr. 59, datë 15.3.2018; nr. 47, datë 19.3.2019; nr. 207, datë 16.12.2019, nr. 99, datë 24.6.2020 Ky ligj ka për qëllim krijimin e një tregu të hapur dhe konkurrues, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe inkurajimin e investimeve në infrastrukturën e energjisë. Ndryshimet e bëra me vendimet e mëvonshme kanë përmirësuar kornizën ligjore për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe efikas me energji.
- Ligji nr. 124 / 2015, “Për eficiencën e energjisë” (ndryshuar me ligjin nr. 5/2019, datë 7 shkurt 2019 dhe nr. 28/2021, datë 8 mars 2021). Qëllimi i tij është të nxisë përdorimin efikas të energjisë, të reduktojë konsumimin dhe të inkurajojë investimet në teknologjitë e efikasitetit energjetik. Ky ligj është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e burimeve natyrore. Ndryshimet e bëra kanë për qëllim të përmirësojnë më tej kornizën ligjore për të nxitur kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit.
- Ligji nr. 24 / 2023 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme” (Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, e ndryshuar). Qëllimi i këtij ligji është të rrisë përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse fosile dhe emetimin e gazeve me efekt serrë, të nxisë zhvillimin e energjisë elektrike të rinovueshme dhe integrimin rajonal të saj, të përmirësojë furnizimin me energji në zonat rurale dhe të izoluara.
- Ligji nr. 52 / 2024 “Për Etiketimin e Produkteve me Ndikim në Energji” (Ky ligj është përafuar plotësisht me rregulloren (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 4 korrik 2017, “Për përcaktimin e kuadrit ligjor për etiketimin e energjisë dhe shfuqizimin e direktivës 2010/30/BE). Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë detyrimet për etiketimin energjetik të

produkteve, të sigurojë informacion standard për eficiencën e energjisë dhe konsumin e energjisë gjatë përdorimit, ndihmojë konsumatorët të zgjedhin produkte më eficiente për të reduktuar konsumin e energjisë.

- VKM nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, (ndryshuar me VKM nr. 718, datë 12.10.2016; nr. 633, datë 27.10.2021; nr. 192, datë 5.4.2023; nr.117, datë 6.3.2024. Në thelb, ky vendim synon të rregullojë procesin e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, duke siguruar që këto projekte të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë në Shqipëri.
- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”. Ky vendim është pjesë e përpjekjeve për të nxitur përdorimin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri dhe për të siguruar një çmim të drejtë dhe të qëndrueshëm për prodhuesit e vegjël të energjisë.
- VKM nr. 27, datë 17. 1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”. Ky vendim miraton metodologjinë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.
- VKM nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës” (ndryshuar me VKM nr. 858, datë 4.11.2020). Vendimi miraton masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës. Ky vendim përcakton procedurat për përzgjedhjen e projekteve që përfitojnë nga këto masa, duke siguruar një proces konkurrues, të hapur, transparent dhe jodiskriminues. Ndryshimet e bëra me VKM nr. 858, datë 4.11.2020, kanë për qëllim të përmirësojnë dhe të përshtatin më tej këto masa mbështetëse për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të burimeve të rinovueshme.
- VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për strategjinë kombëtare të energjisë 2018-2030” është një vendim i rëndësishëm që përcakton strategjinë kombëtare të energjisë për Shqipërinë për periudhën 2018-2030. Kjo strategji ka për qëllim të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji, të promovojë përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe të përmirësojë eficiencën energjetike në të gjitha sektorët.
- VKM nr. 580, datë 28.8.2019 “Për Miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 2019–2021” është një vendim i rëndësishëm që synon të promovojë përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në Shqipëri. Ky plan përfshin masa dhe politika për të rritur përqindjen e energjisë së rinovueshme në totalin e konsumit të energjisë, duke përfshirë hidrocentralet e vogla, energjinë fotovoltaike, energjinë e erës dhe biomasën.
- Udhëzimi nr. 3, datë 20.6.2019, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla

të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli” (ndryshuar me udhëzimin nr. 8, datë 2.5.2023) është një udhëzim që synon të thjeshtojë procesin e autorizimit për instalimin e projekteve të vogla të energjisë diellore. Ky udhëzim lejon vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli të lidhin sistemet e tyre në rrjetin e shpërndarjes me një procedurë të lehtësuar.

- Urdhër Nr.27 datë 18.01.2021 “Për miratimin e strategjisë së transformimit të mbështetjes feed-in-tariff në kontratë për diferencë”. Qëllimi i kësaj strategjie është të sigurojë një mbështetje më të drejtë dhe transparente për prodhuesit e energjisë së rinovueshme, nxisë konkurrencën dhe eficiencën në tregun e energjisë, reduktojë kostot për konsumatorët dhe shtetin.
- Urdhër Nr.28 datë 18.01.2021 “Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe de-rregullimin e cmimit të energjisë elektrike,” është një dokument që synon të hapë tregun e energjisë elektrike dhe të liberalizojë çmimet. Ky udhërrëfyes përfshin masa për të siguruar një treg të hapur dhe konkurrues, duke lejuar që çmimet të përcaktohen nga forcat e tregut.
- Urdhëri Nr. 203, datë 18.10.2022, “Për Miratimin e Formatit të Planeve të Veprimit të Konsumatorëve të Mëdhenj të Energjisë dhe të Raportit Vjetor të Progresit” shërben për të rregulluar dhe monitoruar procesin e hartimit dhe implementimit të planeve të veprimit për konsumatorët e mëdhenj të energjisë. Ai përcakton kriteret për auditimin e energjisë, krijimin e objektivave për kursimin e energjisë dhe periudhat e zbatimit, si dhe procedurat për miratimin dhe raportimin e progresit. Urdhëri ka për qëllim përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe mbështetjen për konsumatorët në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

- Urdhër Nr. 206, Datë 25.10.2022 “Për Miratimin e Formatit të Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë Dhe Raporti i Progresit për Zbatimin e Planeve,” është një dokument që përcakton formatin dhe strukturën e planeve vendore të veprimit për eficiencën e energjisë. Ky urdhër synon të standardizojë mënyrën se si njësitë e qeverisjes vendore hartojnë dhe raportojnë planet e tyre për përmirësimin e eficiencës së energjisë. Qëllimi i këtij urdhri është të sigurojë një qasje të unifikuar për hartimin e planeve vendore të veprimit për eficiencën e energjisë, përmirësojë monitorimin dhe raportimin e progresit në zbatimin e këtyre planeve, nxisë transparencën dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin e energjisë në nivel vendor.
- Vendimi i ERE nr. 120, datë 27.7.2017, “Mbi përcaktimin e çmimeve të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MË dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MË”, përcakton çmimet e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MË dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MË. Ky vendim është në përputhje me ligjin për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.
- Vendimi i ERE nr. 229, datë 20.12.2019, “Mbi miratimin e rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”. Kjo rregullore është në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike dhe synon të sigurojë transparencë dhe besueshmëri në tregun e energjisë së rinovueshme.
- Strategjia Kombëtare për Energjinë ka përcaktuar synimet energjetike të

vendit për të mundësuar integrimin evropian të Shqipërisë në të gjithë infrastrukturën energjetike evropiane. Objektivat e REV-ve janë: •Synimi i energjive të rinovueshme kundrejt konsumit total do të arrijë 42% në vitin 2030. •Reduktimi i emetimeve të GS-ve kundrejt totalit do të arrijë 11.5% në vitin 2030. Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë që përcakton synimet e eficiencës së energjisë për të gjithë sektorët ekonomikë dhe socialë. Mbështetja ndërkombëtare mund të vazhdojë, por për të rritur veprimet e eficiencës së energjisë kërkohet disponueshmëria e fondeve të rritura kombëtare (publike dhe private).

- Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme që përcakton synimet e BRE-ve për të gjithë sektorët e energjisë

1.2 Qëllimi dhe Objektivat e Planit Vendor të Veprimit të Eficiencës së Energjisë

Qëllimi kryesor i këtij plani është përafrimi i objektivave të tij me objektivat e Planit Kombëtar për Efikasitetin e Energjisë (PKEE), duke parashikuar veprime konkrete dhe të matshme në nivel lokal, për të synuar rritjen e eficiencës së energjisë dhe promovimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Në këtë drejtim, objektivat e Planit Vendor të Veprimit të Eficiencës së Energjisë përqendrohen në disa aspekte kryesore:

- Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në infrastrukturën publike dhe private do të jetë prioritet, me synimin për të arritur kursim energjie me 15% deri në vitin 2030. Ky objektiv do të realizohet përmes rinovimit të ndërtesave dhe zbatimit të teknologjive të reja që ndihmojnë në reduktimin e konsumit të energjisë
- Promovimi i teknologjive të reja dhe reduktimi i emetimeve të CO₂ janë

elektrike, transportit dhe ngrohjes. Ky Plan bazohet në detyrimet e Shqipërisë si Palë Kontraktuese në Traktatin e Komunitetit të Energjisë për të qenë në përputhje me Direktivat e BE-së për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Shqipëria është e detyruar të rrisë pjesën e burimeve të rinovueshme në 38% të konsumit total të energjisë deri në vitin 2020, e cila duhet të rritet më tej deri në 42.5% deri në vitin 2030.

Në përfundim, respektimi i këtyre ligjeve dhe rregulloreve është thelbësor për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e energjisë së rinovueshme. Angazhimi i Bashkisë Mirditë për të zbatuar këto politika do të ndihmojë në krijimin e një të ardhmeje më të gjelbër dhe më të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

gjithashtu në qendër të përpjekjeve të Bashkisë. Kjo do të përfshijë nxjerrjen në pah të rëndësisë së përdorimit efikas dhe ekonomik të burimeve të energjisë, si dhe nxitjen e përdorimit të energjive të rinovueshme nga qytetarët dhe kompanitë. Një tjetër qëllim është rritja e sigurisë së furnizimit me energji, duke e bërë këtë një aspekt të rëndësishëm të politikave energjetike të bashkisë.

Me objektiva të qarta dhe të matshme, ky plan synon të reduktojë emetimet e CO₂, të rrisë efikasitetin e energjisë dhe të promovojë përdorimin e teknologjive të reja që mbështesin këto qëllime. Këto objektiva do të arrihen përmes rinovimit të infrastrukturës publike dhe mbështetjes së përdorimit të burimeve të rinovueshme nga qytetarët dhe bizneset, do të arrihet një rritje e qëndrueshme e sigurisë së furnizimit me energji dhe do të kontribuohet në përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjithë komunitetin. Ky plan do të shërbejë

si një udhërrëfyes për të realizuar këto qëllime në afatin e parashikuar dhe do të monitorohet vazhdimisht për të siguruar që

objektivat e tij të arrihen në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

1.3 Procedurat për Hartimin dhe Miratimin e PVVEE

Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor të Veprimit të Eficiencës së Energjisë (PVVEE) është një proces i strukturuar dhe gjithëpërfshirës që synon krijimin e një dokumenti strategjik për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në nivel vendor. Nga pikepamja procedurale, përgatitja e planit ndjek hapat si më poshtë vijon:

- Proces nis me mbledhjen e të dhënave për situatën aktuale të konsumit të energjisë në sektorët kryesorë, përfshirë banesat, industrinë, transportin dhe shërbimet publike. Për të ndërtuar planin grupi i punës ka marrë të gjithë të dhënat që disponon vetë bashkia, mbi konsumin e energjisë elektrike, mbi transportin, furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizime, bujqësi, ndërtimin publik, grumbullimin e mbetjeve dhe makinat e pasagjereve.
- Hapi tjetër ka qenë grumbullimi i të dhënave nga drejtoritë përgjegjëse si OSHEE, SHRUK, DPSHTRR, etj.
- Të dhënat e mbledhura i nënshtrohen një faze të dytë, verifikimit të të dhënave, për të siguruar saktësinë dhe përputhshmërinë e tyre me burimet zyrtare dhe metodologjitë e aprovuara.
- Në vijim, kryhet një analizë e detajuar e sektorëve, përfshirë identifikimin e potencialeve të kursimit të energjisë dhe masave specifike që mund të zbatohen. Analiza e të dhënave sasiore pasohet nga një rishikim fillestar i energjisë, ku përcaktohen sektorët më kritikë që kërkojnë ndërhyrje dhe investime.

- Pasi është bërë verifikimi i të dhënave dhe analiza e detajuar e sektoreve, bëhet vendosja e objektivave, duke marrë në konsideratë politikat kombëtare të energjisë, potencialin lokal për përmirësime dhe qëllimet e përgjithshme të reduktimit të emetimeve të gazeve serrë.
- Bazuar në këto përfundime, kalojmë në fazën e hartimit të planit, ku përpilohet një dokument gjithëpërfshirës që përmban masat konkrete, burimet e financimit dhe treguesit e monitorimit për efikasitetin e energjisë.
- Përpara miratimit nga Këshilli Bashkiak, plani i përgatitur i nënshtrohet një procesi konsultimi me ministrinë dhe agjencinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me përfaqësues të grupeve të interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ky proces siguron përputhjen e planit me nevojat lokale dhe politikat kombëtare.
- Pas përfundimit të konsultimeve dhe përfshirjes së komenteve të marra, plani final dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak.

Miratimi i PVVEE-së nga Këshilli Bashkiak shënon zyrtarisht fillimin e zbatimit dhe monitorimit të tij, me qëllim arritjen e objektivave për efikasitetin e energjisë dhe reduktimin e ndikimit mjedisor në nivel vendor. Ky proces gjithëpërfshirës siguron që plani të jetë i qartë, i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për nevojat dhe mundësitë lokale, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet.

1.4 Zbatimi dhe Monitorimi

Për të arritur qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, Bashkia Mirditë duhet të krijojë një strukturë organizative të qartë për zbatimin dhe monitorimin e Planit Vendor të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PVVEE). Formimi i një grupi pune të dedikuar, i cili do të përfshijë përfaqësues nga njësitë e qeverisjes vendore dhe aktorët të rëndësishëm do të ndihmojë në zbatimin e masave të PVVEE. Ky grup do të ketë përgjegjësinë për koordinimin e aktiviteteve dhe sigurimin e zbatimit efektiv të masave të propozuara.

Përzgjedhja e grupit të punës dhe aktorëve që do të përfshihen në zbatimin e PVVEE-së është gjithashtu një hap i rëndësishëm. Angazhimi i njësive të qeverisjes vendore, agjencive të linjës dhe aktorët kryesor për të mbështetur implementimin e masave. Kjo do të sigurojë një qasje më gjithëpërfshirëse dhe më të efektshme.

Një aspekt thelbësor i zbatimit është identifikimi i burimeve të financimit. Bashkia shqyrton mundësitë për të siguruar financim nga fondet e saj, donacione, dhe projekte me bashkëfinancim. Po ashtu, sugjerohet që të zhvillohen incentiva për të nxitur investimet në energji të rinovueshme nga qytetarët. Për të arritur këto do të bëhen fushata të ndryshme advokimi dhe ndërgjegjësimi.

Për monitorimin e progresit, është e rëndësishme të krijohet një sistem i qartë raportimi. Raportimi do të bëhet në bazë të Shtojcës 2 të Urdhërit Nr. 206, Datë 25.10.2022 "Për Miratimin e Formatit të Planeve Vendore të Veprimit për Eficiencën e Energjisë Dhe Raporti i Progresit për Zbatimin e Planeve". Kjo do të përfshijë matjen e kursimeve të energjisë dhe emetimeve të

gazrave, si dhe rezultateve të arritura në zbatimin e masave.

Kjo qasje do të ndihmojë në arritjen e qëllimeve për efikasitetin energjetik dhe zhvillimin e një mjedisi më të qëndrueshëm në Bashkinë Mirditë.

Zbatimi i PVVEE përfshin:

- Zbatimi i strategjive dhe masave të rekomanduara në plan përfshin ndarjen e burimeve të nevojshme dhe koordinimin me aktorët kryesorë për të siguruar një implementim efektiv.
- Krijimi dhe promovimi i mekanizmave financiarë të qëndrueshëm për investimet në efikasitetin e energjisë, duke përfshirë mundësi të financimit dhe kursimeve afatgjata.
- Forcimi i kapaciteteve të Bashkisë dhe krijimi i një njësie të veçantë për mbikëqyrjen e implementimit të planit.

Monitorimi dhe Raportimi përfshijnë:

- Krijimi i mekanizmave për monitorimin e vazhdueshëm të avancimeve në zbatimin e masave të planit, duke ndjekur performancën dhe identifikuar sfidat e mundshme.
- Raportimi i rregullt mbi përparimin e realizimit të objektivave dhe përmbushjen e qëllimeve të planit për të vlerësuar efektivitetin e masave dhe për të bërë përshtatjet e nevojshme.
- Rishikimi dhe përditësimi i planit në bazë të rezultateve të monitorimit dhe raportimit për të adresuar nevojat e ndryshuara ose sfidat e reja.

2. SITUATA AKTUALE E KONSUMIT TË ENERGJISË

Shqipëria është një vend me burime të shumta ujore dhe ka një peizazh të pasur energjie të ndërtuar krejtësisht mbi burimet e rinovueshme. Hidrocentralet vazhdojnë të jenë burimi kryesor i energjisë, duke gjeneruar pjesën më të madhe të energjisë elektrike në vend. Në të njëjtën kohë, ka pasur një rritje në zhvillimin e burimeve të tjera të rinovueshme, siç janë energjia diellore dhe ajo e erës. Këto zhvillime kanë pasur një ndikim pozitiv në shtimin e rrymave të prodhimit të energjisë në vend dhe kanë kontribuar në reduktimin e varësisë nga

hidrocentralet. Ndryshimet në nivelet e ujit dhe temperaturat ndikojnë në produktivitetin e hidrocentraleve, ndërsa projekte të reja në sektorin e energjisë diellore dhe eolike kanë kontribuar në rritjen e kapacitetit total të prodhimit. Me rrezatim diellor vjetor të lartë (1'350 – 1'600 kWh/m²) dhe orë vjetore me diell optimale (2'100-2'700 orë/ vit), nga të cilat 1'500 orë/ vit me diell në pik për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet fotovoltaike, Bashkia Mirditë shfaq potencial të lartë për prodhimin e energjisë diellore.

Figura 7 Potenciali i Energjisë Fotovoltaike dhe Rrezatimi Normal Direkt në Shqipëri



Burimi: SolarGIS

Konsumi i energjisë elektrike totale në vend përgjatë vitit 2023 është mbuluar nga gjenerimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, si dhe nga importi i energjisë elektrike. Sasia totale e energjisë




elektrike e hyrë në sistemin e transmetimit për vitin 2023 është rreth 10,147 GWh. Sasia totale e energjisë elektrike e hyrë në sistemin e shpërndarjes është rreth 7,062 GWh. Energjia elektrike në sistemin e shpërndarjes injektohet nga sistemi i transmetimit dhe

nga impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Sistemi i transmetimit ka injektuar për vitin 2023 në rrjetin e shpërndarjes sasinë prej 6,492 GWh, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura direkt në rrjetin e shpërndarjes kanë injektuar në këtë rrjet sasinë neto të energjisë elektrike prej rreth 570 GWh. Prodhimi neto vendas për vitin 2023 rezulton të jetë 8 796 GWh, nga të cilat 0.9% është energji e prodhuar nga

energji diellore, ndërkohë që konsumi total i vendit rezulton të jetë 7,876 GWh, me një balancë neto në drejtimin export 920 GWh. (OSHEE, 2023) Vihet re se në 5 vitet e fundit kemi një rritje të energjisë së prodhuar nga energji diellore me rreth 3.5 herë. Në vitin 2019 kapaciteti prodhues i energjisë nga panelet fotovoltaike ishte 22'196 MWh, ndërkohë që për vitin 2023 ka arritur 80'874 MWh.

Figura 8. Relievi, Sistemi ujq dhe vendodhja e HEC në territorin e Bashkisë Mirditë



Burimi: CoPLAN, 2024

Përveç potencialit për të prodhuar energji elektrike nga panelet fotovoltaike dhe nga parqet aoelike, Bashkia Mirditë me rrjet hidrik të pasur, është një rajon me potencial të lartë edhe për prodhimin e energjisë elektrike përmes hidrocentraleve. Në territorin e Bashkisë Mirditë janë të ndërtuar

14 HEC, nga të cilët 4 në transmetim e 10 në shpërndarje. Në vitin 2023, HEC në transmetim prodhuan 515'604 MWh ndërsa HEC në shpërndarje prodhuan 35'846 MWh duke kontribuar në total në prodhimin e rreth 6% të prodhimit neto të energjisë elektrike për vendin tonë.

Tabela 4. HEC-et në territorin e Bashkisë Mirditë

	HEC	Fuqia MW	LIDHJA	MWh
Transmetim	Hec "Prella"	14.97	110 kV	42,523
	Hec "Ulëz"	25.2	110 kV	120,000
	Hec "Peshqesh"	28	220 kV	102,939
	Hec "Fangu"	74.6	220 kV	250,142
	Totali Energjisë në Transmetim			515,604
Shpërndarje	Hec "Ballenje"	1.9	35kV	4,121
	Hec "Lena 1"	1.95	35kV	7,962
	Hec "Lena 2"	2.3	35kV	
	Hec "Lena 2A"	0.25	35kV	
	Hec "Shengjon 1"	0.651	35kV	5,520
	Hec "Shengjon 2"	0.356	35kV	2,627
	Hec "Ura e Fanit "	1	35kV	6,089
	Hec "Bisak"	1.3	6kV	4,175
	Hec "Klos"	1.95	6kV	3,549
	Hec "Kumbull- Merkurth"	0.83	6kV	1,806
	Totali Energjisë në Shpërndarje			35,849

Burimi: OSHEE, 2023

2.1 Objektet dhe aktivitetet/ shërbimet e njesisë së qeverisjes vendore

Bashkia Mirditë ofron shërbime dhe aktivitete që përfshijnë menaxhimin e infrastrukturës lokale, si rrugët, hapësirat e gjelbra dhe zonave publike. Pjesa tjetër e shërbimeve përfshin menaxhimin e mbetjeve dhe përkujdesjen për higjienën dhe pastërtinë e zonave urbane dhe rurale. Ky kapitull synon të shqyrtojë përdorimin e energjisë në disa sektorë kyç, si ndërtesat publike dhe private, sistemet e furnizimit me ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza, ndriçimin publik, transportin publik, dhe shërbimet e tjera që mbulojnë nevojat e përditshme të bashkisë Mirditë.


2.1.1 Vështrim i përgjithshëm i konsumit të energjisë

Bashkia Mirditë, me një konsum total prej 17.8 GWh në vit, përfaqëson vetëm 0.22% të konsumit total vjetor të energjisë elektrike në Shqipëri, i cili është 7,923.7 GWh. Ky konsum përfshin objektet publike dhe private, si dhe aktivitetet dhe shërbimet që bashkia ofron për komunitetin. Aktivitetet kryesore përfshijnë furnizimin me energji të ndërtesave publike, shkollave, qendrave shëndetësore dhe shërbimeve të tjera të domosdoshme për funksionimin e qytetit. Bashkia është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve energjetike në këto aktivitete, si dhe për promovimin e politikave të qëndrueshme energjetike për të ulur

konsumimin e energjisë dhe për të nxitur përdorimin e burimeve të rinovueshme.

Të dhënat e ofruara nga Drejtoria Rajonale e OSHEE Burrel tregojnë se rreth 61% e konsumit të përgjithshëm të energjisë në bashkinë Mirditë vjen nga sektori rezidencial. Kjo tregon se pjesa më e madhe e energjisë konsumohet nga banesat private dhe familjet, të cilat, duke qenë konsumatorët më të mëdhenj, ofrojnë një mundësi për të zbatuar masa për përmirësimin e efikasitetit energjetik, si izolimi më i mirë termik, instalimi i pajisjeve më efikase dhe promovimi i përdorimit të energjisë diellore për ngrohje dhe furnizim me ujë të ngrohtë. Në figurën e mëposhtme paraqitet grafikisht përqindja e konsumit të energjisë sipas kategorisë së konsumatorëve.

Figura 9. Konsumi mesatar vjetor i energjisë elektrike në Bashkinë Mirditë sipas kategorisë së klientëve



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Sektori i biznesit, i cili përbën 19% të konsumit të përgjithshëm, është një kontribues i rëndësishëm në ekonomi, dhe përmirësimi i efikasitetit të tyre energjetik mund të çojë në uljen e kostove operacionale, përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe uljen e ndotjes mjedisore. Duke analizuar konsumatorët kryesorë të energjisë në këtë sektor, bashkia mund të promovojë politika që inkurajojnë bizneset të investojnë në teknologji të gjelbërta dhe energji të rinovueshme.

Në bashkinë Mirditë, konsumatorët e energjisë elektrike për vitin 2023 kanë konsumuar një sasi totale prej 17,800 MWh, e cila ka një kosto të përgjithshme prej rreth 320 milionë lekësh. Në Tabelën e mëposhtme është paraqitur konsumi total i energjisë dhe kostot sipas llojit të burimit të energjisë. Ky konsum i përgjithshëm është i ndarë midis sektorëve të ndryshëm, ku Bashkia Mirditë, me të gjitha ndërtesat që ndodhen në menaxhimin e saj – përfshirë ndërtesa administrative, shkolla, dhe ndërtesa të tjera kulturore dhe sportive – konsumon 652 MWh. Ky konsum i përkthyer në vlerë monetare është rreth 12,000,000 Lekë, ose rreth 3.7% të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike në të gjithë bashkinë.

Përveç koston për energjinë elektrike, Bashkia Mirditë ka edhe shpenzime shtesë për burime të tjera energjie, si nafta dhe druri. Kostoja e këtyre burimeve është njësoj e rëndësishme dhe kontribuon në shpenzimet totale të bashkisë për energji. Në rastin e naftës, ajo përdoret për dy funksione kryesore: për transportin e flotës së makinave të Bashkisë, me një sasi vjetore prej 48,767 litra dhe për ngrohjen e ndërtesave publike, si shkollat dhe zyrat, me një sasi vjetore prej 34,960 litra. Këto shpenzime kanë një kosto të përgjithshme prej rreth 17 milion lekësh, e cila përfshin shpenzime për karburantin e përdorur në transport dhe ngrohje.

Nga ana tjetër, druri përdoret kryesisht për ngrohje, veçanërisht në shkollat e caktuara që kanë soba me dru. Konsumi i drurit në Bashkinë Mirditë arrin në 314 m³ dru në

vit, dhe kostoja e tij është 1,432,000 lekë. Ky burim energjie është një mundësi për të ulur shpenzimet në kushte të caktuara, duke pasur parasysh që përdorimi i drurit është një opsion më i përballueshëm në disa zona të bashkisë, por ndihmon gjithashtu për të ulur ngarkesën në energjinë

elektrike. Megjithatë, përdorimi i drurit duhet të jetë i menaxhuar me kujdes për të shmangur dëmtimin e mjedisit dhe uljen e rezervave pyjore. Promovimi i burimeve të rinovueshme, si panele diellore për ngrohje, mund të jetë një zgjidhje më afatgjatë dhe më miqësore për mjedisin.

Tabela 5. Konsumi total i energjisë dhe kostot sipas llojit të burimit të energjisë për vitin 2023

	Konsumi vjetor i energjisë		Kostoja vjetore e energjisë	Gjurma e Karbonit
Bartësi i Energjisë	Njësia	Sasia	[Lekë]	kton CO2 Ekuivalent
Elektricitet	14	17'800	320,000,000*	8,348
Bashkia Mirditë				
Elektricitet	MWh	652	12,000,000**	306
Naftë e lehtë - karburant i lehtë diesel - Diesel	m3	85	17'000'000**	228
Druri	m3	314	1'432'000***	471
Total për Bashkinë Mirditë	MWh		30,432,000	9,353

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

*është paraqitur konsumi dhe kosto e energjise elektrike për të gjithë konsumatorët që ndodhen në territorin e bashkisë Mirditë

**është paraqitur sasia dhe kosto që paguhet nga buxheti i Bashkisë Mirditë, për nevojat e Bashkisë

***të dhënat tregojnë konsumin e drurit për ngrohje nga Bashkia, për vitin 2023.

Përmes analizës së detajuar të sektorëve kryesorë të përdorimit të energjisë, mund të identifikohen mundësitë për të përmirësuar efikasitetin energjetik dhe për të ulur ndotjen mjedisore, duke kontribuar kështu në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm për qytetarët. Secili sektor ka nevojat e tij specifike për energji, dhe kjo analizë do të ofrojë një pasqyrë të qartë të konsumit të energjisë, si dhe mundësitë për zbatimin e masave që do të përmirësojnë efikasitetin e përdorimit të energjisë.

Tabela e mëposhtme për konsumin total të energjisë sipas sektorëve tregon shpërndarjen e përdorimit të energjisë në disa fusha kyçe për Bashkinë Mirditë dhe shërben për të identifikuar fushat ku përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe

përdorimi i burimeve të rinovueshme mund të ketë ndikim më të madh.

Përqindja më e madhe e konsumit të energjisë shkon për ndërtesat private dhe publike, që tregojnë fusha me potencial të madh për përmirësim të efikasitetit energjetik dhe për instalimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme. Investimet në këto sektorë do të ndikojnë ndjeshëm në reduktimin e konsumit total të energjisë dhe kostove për bashkinë dhe qytetarët.

Sektorët që përdorin burime fosile, si transporti publik, shërbimet e mbetjeve dhe aktivitetet e tjera të bashkisë, përbëjnë gjithashtu një pjesë të konsiderueshme të konsumit të energjisë.

Tabela 6. Konsumi total i energjisë sipas sektorëve

Sektori	Elektricitet	Burime të tjera fosile	Total
	MWh	MWh	MWh
Ndërtesat publike	874	363	1,237
Ndërtesat private	10'800		
Sistemi i furnizimit me ujë	320		320
Sistemi trajtimit/ largimit të ujërave të zeza*	0	0	0
Ndriçimi publik dhe sinjalistika e trafikut	150		150
Shërbimet e grumbullimit të mbetjeve		125	125

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Kalimi nga burime fosile në automjete elektrike do të ndihmonte në reduktimin e varësisë nga nafta dhe uljen e emetimeve të karbonit, duke e bërë bashkinë më të gjelbër dhe më të qëndrueshme.

Në përfundim, duke parë këtë analizë, është e qartë se Bashkia Mirditë ka mundësi të mëdha për përmirësimin e menaxhimit të energjisë, duke u fokusuar në eficiencën energjetike dhe kalimin drejt burimeve të rinovueshme. Kjo jo vetëm që do të ulë kostot operacionale, por do të kontribuojë edhe

në qëndrueshmërinë mjedisore afatgjatë të komunitetit.

2.1.2 Konsumi i energjisë në ndërtesat publike

Bashkia Mirditë, dikur një zonë e industrializuar për shkak të funksionimit të minierave, trashëgon një infrastrukturë të pasur me ndërtesa publike, të ndërtuara kryesisht për të mbështetur aktivitetet ekonomike dhe shërbimet e popullsisë në atë periudhë.

Tabela 7 Ndërtesat publike të ndara sipas qëllimit të përdorimit

Kategoria	Numri i Ndërtesave
Ndërtesa Administrative	20
Ndërtesa Arsimore	80
Ndërtesa Shëndetësore	40
Ndërtesa Kulturore/Sportive	15

Burimi: Bashkia Mirditë

Shumë objekte publike, si ish-ndërtesa administrative, shkollat dhe qendrat kulturore, kanë mbetur të papërdorura ose janë në gjendje të keqe fizike. Përveç kësaj, ndërtesat qendrave shëndetësore

dhe arsimit në zonat rurale kanë nevojë për rikonstrukcion duke përfshirë ambulancat e dëmtuara dhe shkollat që nuk funksionojnë. Në tabelen e mëposhtme jepet një listë e përafërt e numrit të ndërtesave sipas

kategorisë së përdorimit. Vëmë re se numrin më të madh të ndërtesave e zenë ndërtesat arsimore, ku futen ndërtesa si Çerdhe, Kopshte, Shkolla dhe Gjimnaze. Edhe pse një numer i lartë i ndërtesave publike janë arsimore, vetëm 45 objekte janë funksionale.

Ndërtesat administrative përfshijnë ndërtesa si bashkia, zyrat e njësive administrative dhe ndërtesa të tjera që përdoren për të ofruar shërbime publike në territorin e Bashkisë Mirditë. Objekti i Bashkisë Mirditë ka një konsum mesatar vjetor me rreth 150 MWh. Në listën e kontratave të

energjisë elektrike me konsumin më të lartë të energjisë përfshihet po ashtu edhe Ujësjellësi i Bukimirës i cili është ujësjellësi kryesor vaditës me sistem pompimi, dhe ka një konsum të konsiderueshëm, por të balancuar, krahasuar me ndikimin thelbësor që ka për bujqësinë e zonës. Më pas në listë renditen Shkolla 9 Vjeçare nr 3, Bashkia Rreshen-Kopshti Femijeve, Kopshti i Femijeve Rreshen, Bashkia Rubik Çerdhja, Bashkia Mirdite – zyrat e bashkisë, Bashkia Rreshen Konvikti, që të gjitha kanë një konsum mesatar vjetor me mbi 15'000 kWh.

Tabela 8. Kontratat e energjisë për Bashkinë Mirditë me konsumin më të lartë të energjisë

Emertimi	Konsumi kWh	Kosto Lekë
Bashkia Mirditë Rreshen Mirdite	147,920.00	3,256,623.36
Bashkia Mirditë Bukmire	48,960.00	849,987.84
Bashkia Rreshen Shkolla 8 Vjeçare nr 3	25,443.00	428,642.40
Bashkia Rreshen Kopshti Femijeve	21,082.00	431,697.60
Rreshen Kopshti I femijeve Rreshen ,	20,196.00	340,492.80
Bashkia Rubik Çerdhja	19,977.00	337,570.08
Bashkia Mirdite Rreshen	17,931.00	302,440.80
Bashkia Rreshen Konvikti	17,533.00	295,754.40
Prefekti Lezhe Zjarrfiksi	14,786.00	249,604.80
Rreshen Shkolla e mesme	14,631.00	247,000.80
Rreshen Pallati Sportit 2	13,495.00	227,916.00
RUBIK Konvikti	11,323.00	191,906.40
Rreshen Dega Kultures	10,277.00	173,853.60
Shkolla Mesme	9,967.00	168,645.60
Motrat Vincensiane	9,740.00	112,236.00
Bashkia Rreshen Shkolla 8 Vjeçare Nr 2	9,350.00	158,280.00
Bashkia Rreshen Çerdhja e femijeve	8,883.00	150,434.40
Bashkia Rubik	7,712.00	130,761.60
Bashkia Rrubik Zdrukthtaria e shkolles se mesme	7,083.00	121,154.40

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Kontratat e energjisë elektrike me konsumin më të lartë janë të listuara në tabelën më sipër, ku kemi të pasqyruar emertimin, konsumin e energjisë elektrike për vitin 2023 dhe koston respektive. Në listë janë paraqitur vetëm kontratat të cilat kanë konsum mbi 7'000 kWh në vit duke përjashtuar kontratat e ndricimit rrugor (OSHEE, 2023).

Grupi i punës gjatë vitit 2024, në kuadër të procesit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, kanë analizuar një total prej 105 kontratash të lidhura me furnizimin me energji elektrike dhe shërbime të lidhura me të. Ndër kontratat e konsideruara për këtë analizë, përfshiheshin ato që mbulonin furnizimin me energji për objektet administrative të bashkisë, institucionet e varësisë si shkolla, kopshte dhe çerdhe, shërbimet publike si ndriçimi rrugor, si dhe objektet e tjera të infrastrukturës bashkiake. Në përfundim të këtij procesi, u dokumentua konsumi total i energjisë për secilën kontratë. Në bazë të të dhënave të konsumit të energjisë elektrike të kontratave të Bashkisë Mirditë vihet re dhe se 35% e kontratave janë me konsum 0 kWh. Ky është një tregues se këto ndërtesa nuk përdoren më për funksionin e tyre të mëparshëm. 26 nga 36 ndërtesa janë shkolla që janë mbyllur për mungesë të nxënësve dhe mësuesve.

Konsumi i energjisë gjithashtu varet nga sipërfaqja e ndërtesës. Ndërtesat me sipërfaqe më të madhe zakonisht kanë nevojë për më shumë energji për të funksionuar, për shkak të nevojës për më shumë ngrohje, ftohje dhe ndriçim. Megjithatë, sipërfaqja nuk është i vetmi element që ndikon në konsumimin e energjisë. Eficienca e sistemit të ngrohjes dhe ftohjes, izolimi i ndërtesës, dhe mënyra e përdorimit të hapësirës gjithashtu luajnë role të rëndësishme. Ndërtesat me izolim të dobët ose sisteme energjetike të vjetra mund të konsumojnë më shumë energji për të mbajtur kushtet e dëshiruara, pavarësisht nga sipërfaqja e tyre. Për të analizuar më mirë konsumin e energjisë elektrike dhe efikasitetin e ndërtesave të Bashkisë Mirditë, është përgatitur një tabelë që paraqet të dhënat kryesore mbi konsumin

vjetor të energjisë elektrike (në kWh) dhe sipërfaqen totale të secilës ndërtesë (në m²). Këto të dhëna mundësojnë llogaritjen e treguesit kWh/m² në vit, i cili përfaqëson efikasitetin energjetik të ndërtesës dhe ndihmon në identifikimin e ndërtesave që kanë konsum më të lartë ose më të ulët se mesatarja. Ky tregues është i rëndësishëm për të planifikuar masat për përmirësimin e performancës energjetike dhe reduktimin e shpenzimeve.

Siç mund të vërehet në tabelën e mëposhtme ku janë pasqyron të dhënat mbi performancën energjetike të ndërtesave publike në bashkinë Mirditë, konsumi i lartë i energjisë karakterizon disa ndërtesa kryesore, si Spitali “Shenjta Mari” dhe Drejtoria e Policisë, të cilat, për shkak të madhësisë dhe funksionalitetit të tyre, kanë një performancë energjetike relativisht të dobët.

Ndërtesat me performancë energjetike të dobët, si Posta Shqiptare (60.43 kWh/m²/vit) dhe Zyra e Punës (53.56 kWh/m²/vit), kanë kosto disproporcionale për sipërfaqet e tyre të vogla, duke treguar nevojën për investime në eficiencë energjetike.

Në përfundim, tabela nxjerr në pah rëndësinë e një qasjeje strategjike për menaxhimin e energjisë në ndërtesat publike, jo vetëm për të ulur kostot financiare, por edhe për të rritur qëndrueshmërinë mjedisore.

Për të kuptuar më mirë gjendjen e ndërtesave publike në Bashkinë Mirditë, nëpërmjet projektit EFFORT është bërë analiza bazë për 15 objekte publike, të ndara në kategori të ndryshme: 5 shkolla, 2 konvikte, 3 çerdhe dhe kopshte, si dhe 5 ndërtesa administrative. Qëllimi i kësaj analize është të ofrojë një pasqyrë të detajuar mbi performancën energjetike, konsumimin e burimeve dhe kostot funksionale të këtyre objekteve, duke identifikuar mundësitë për përmirësime dhe optimizime të mundshme. Një aspekt thelbësor i analizës është dhe vlerësimi i mundësisë për implementimin e paneleve fotovoltaike, duke analizuar

nëse këto objekte janë të përshtatshme për përdorim dhe nëse investimi në to do të ishte ekonomikisht i justifikueshëm. Për më tepër, ky proces shërben si bazë për analizat e ardhshme të ndërtesave të tjera, duke

krijuar një kornizë metodologjike që mund të përdoret në projekte të ngjashme dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Tabela 9. Performanca energjetike e ndërtesave publike

Nr	Ndërtesat Publike	Siperfaqja totale e ndërtesës	Konsumi Vjetor kWh	Kosto Vjetore (Lekë)	Performanca e nergjetike kWh/ m2/ vit
1	Pallati i Kulturës	1,310	10,277	173,854	7.85
2	Pallati i Sportit “Arjana Arapi	835	13,495	227,916	16.16
3	Muzeu Historik i Qytetit	572	3,544	61,459	6.20
4	Spitali “Shenjta Mari”	4,680	177,172	2,978,890	37.86
5	Drejtoria e Policisë, Mirditë	2,806	101,870	1,716,316	36.30
6	Posta Shqiptare Mirditë	140	8,460	144,048	60.43
7	Ujesjellesi	286	3,677	62,494	12.86
8	Zyra Arsimore	384	7,415	125,772	19.31
9	Zyra Punës	70	3,749	64,183	53.56
10	Dega e Sigurimeve Shoqërore	37	3,215	55,212	86.89
11	NJVKSH	1,508	50,657	869,948	33.59
12	Zjarrfiksj	280	14,789	249,604	52.82
13	OSHEE	150	20,697	351,689	137.98
14	Njesia Administrative Fan	300	221	4,913	0.74
15	Njesia Administrative Orosh	480	4,310	73,608	8.98
16	Njesia Administrave Selite	500	1,533	26,954	3.07
17	Njesia Administrative Perlat	540	1,620	28,416	3.00
18	Njesia Administrative Kaçinar	878	2,894	49,819	3.30
19	Njesia Administrative Rubik	320	3,857	65,998	12.05
20	Shkolla e Mesme Rrëshen	3,840	14,631	247,000	3.81
21	Bashkia Mirditë	1,912	147,920	3,256,623	77.36
22	Shkolla 9 Vjeçare “Pashko Vasa”	4,425	25,443	428,642	5.75
23	Kopështi i Fëmijëve Rrëshen (i ri)	3,465	20,196	340,492	5.83
24	Konvikti Rrëshen	1,646	17,533	295,754	10.65
25	Shkolla 9 vjeçare “Nënë Tereza”	1,122	9,350	158,280	8.33
26	InfoKulla	440	7,435	126,588	16.90
27	Baza e Praktikës Profesionale	498	5,313	90,358	10.67
28	Kopështi i Fëmijëve pa drekë	768	19,627	330,833	25.56
29	Shkolla Profesionale Rubik	3,869	4,661	79,744	1.20
30	Ish Godina e Bashkisë	1,253	757	12,259	0.60
31	Shkolla 9 Vjeçare Rubik	2,400	214	5,538	0.09
32	Konvikti Rubik	1,717	10,786	182,784	6.28
33	Kopeshti i Fëmijëve Rubik (i ri)	658	10,017	182,785	15.22

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Për të bërë analizën bazë, janë marrë në konsideratë katër faktorë kryesorë që shërbejnë si shtyllat kryesore për vlerësimin dhe prioritarizimin e ndërtesave:

1. Gjendja fizike e objekteve, është një faktor mjaft i rëndësishëm sepse investimet në panele

Tabela 10. Sipërfaqja Totale dhe Sipërfaqja e Kushtëzuar e ndërtesave

Qëllimi i Ndërtesës	Sipërfaqja Totale (m ²)	Sipërfaqja e Kushtëzuar (m ²)
Shkolla (5)	15'656	6'512
Konvikt (2)	1'578	3'558
Kopsht dhe Çerdhe (3)	6,650	4'891
Ndërtesa Administrative (4)	4'357	1'764

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Një kategori me rëndësi të veçantë për zhvillimin afatgjatë të komunitetit janë ndërtesat arsimore, përfshirë shkollat, kopshtet dhe çerdhet, të cilat përveç rolit edukativkanëedhenjëndikim të rëndësishëm në konsumin energjetik dhe shpenzimet operacionale. Duke kaluar tek analiza e këtyre ndërtesave, është e rëndësishme të kuptojmë si mund të optimizohen burimet energjetike për të mbështetur një ambient më të qëndrueshëm për brezat e rinj.

Një numër i madh ndërtesash arsimore janë mbyllur ose janë jashtë funksionit, ndërsa disa nga ndërtesat funksionale janë rikonstruktuar vitet e fundit nga fondi i

rikonstrukcionit pas termetit. Megjithatë, ekzistojnë ende shkolla që ndodhen në zona rurale me kushte të vështira, ku nevojiten investime të mëtijshme për të siguruar një mjedis më të përshtatshëm për mësimdhënie.

Nëse marrim në shqyrtim të dhënat e tabelës së mëposhtme ku janë pasqyruar numri i ndërtesave arsimore sipas llojit për njësi administrative, numrit të nxënësve dhe numrit të fëmijëve, mund të themi se, strukturat edukative janë shpërndarë në njësitë administrative për të siguruar akses të barabartë në arsim për fëmijët dhe të rinjtë. (Bashkia_Mirditë, 2020)

Tabela 11. Ndërtesat Arsimore sipas llojit përçdo Njësi Administrative

	Çerdhe		Kopshtet			Shkollat nëntëvjeçare			Shkollat e mesme		
Njësitë administrative	Numri i fëmijëve të regjistruar	Numri i edukatorëve	Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve të regjistruar	Numri i edukatorëve	Numri i shkollave nëntëvjeçare	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i shkollave të mesme	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
Rreshen	66	8	5	247	22	6	907	94	2	655	61
Rubik	11	3	7	86	10	3	270	31	2	160	22
Orosh	-	-	1	27	2	3	100	17	1	24	6
Fan	-	-	3	42	3	2	211	19	1	61	7


	Çerdhe		Kopshtet			Shkollat nëntëvjeçare			Shkollat e mesme		
Kaçinar	-	-	1	4	1	2	11	6	-	-	-
Kthellë	-	-	3	31	3	4	81	17	1	28	8
Selitë	-	-	1	8	1	4	41	13	-	-	-
Total	77	11	21	445	42	24	1621	197	7	928	104

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Bashkia Mirditë përballlet me sfida për sa i përket numrit të ulët të nxënësve në disa shkolla, sidomos në zonat rurale. Shkollat me më shumë nxënës ndodhen në qytetin e Rrëshenit dhe Rubikut, ku ka më shumë

nxënës dhe mësues. Në krahasim, njësitë administrative si Oroshi, Fan, Kaçinari, Kthella, dhe Selita reflektojnë një tendencë të largimit të popullsisë nga këto zona.

Figura 10. Shpërndarja e ndërtesave arsimore sipas llojit dhe NJA



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Njësitë administrative Rrëshen dhe Rubik janë të vetmet që ofrojnë shërbimin e çerdheve, me 66 fëmijë të regjistruar në çerdhe në NJA Rrëshen dhe 8 edukatorë,

ndërkohë që Rubik ka 11 fëmijë të regjistruar në çerdhe dhe 3 edukatore. Të dhënat për njësitë e tjera si Orosh, Fan, Kaçinar, Kthellë dhe Selitë tregojnë mungesën e çerdheve, që

mund të tregojë një nevojë për përmirësime në ofrimin e këtyre shërbimeve në këto zona. Sa për Shkollat 9-vjeçare, NJA Rrëshen ka 6 shkolla 9-vjeçare me 907 nxënës dhe 94 mësues. Rubiku ka 3 shkolla me 270 nxënës, ndërsa njësitë e tjera kanë shkolla të vogla, si Orosh me 100 nxënës dhe Fan me 211 nxënës. Kaçinar, Kthellë dhe Selitë kanë numër të vogël nxënësish të regjistruar.

Për shkollat e mesme, Rrësheni ka 2 shkolla me 655 nxënës, dhe Rubiku ka 2 shkolla me

160 nxënës. Njësitë e tjera si Orosh, Fan, dhe Kthellë kanë shkolla të mesme me nxënës të regjistruar, ndërsa njësitë Kaçinar dhe Selitë nuk kanë shkolla të mesme.

Për ngrohjen e ambienteve të brendshme 8 kopështe dhe shkolla përdorin 9 kaldaja. Të dhënat për secilën kaldajë mbi fuqinë, orët e punës, konsumin, dhe energjinë janë pasqyruar në tabelën e mëposhte. (Bashkia Mirditë, 2023)

Tabela 12. Të dhënat e kaldajave për vitin 2023.

Kaldaja	Fuqia kW	Orë pune në vit	Konsumi l/ore	Naftë l/ vit	Energjia kWh
Gjimnazi Rrëshen	291	240	18	4,320	69,840.00
Shkolla 9-Vjecare Pashko Vasa	116+116	240	15+15	7,200	55,680.00
Kopshti i Fëmijëve Rrëshen (I RI)	191	500	14	7,000	95,500.00
Shkolla 9-Vjeqare Rubik	190	240	17	4,080	45,600.00
Konvikti Rrëshen	116	240	11	2,640	27,840.00
Shkolla Nënë Tereza	116	407	18	7,320	47,173.33
Shkolla e mesme Profesionale Rubik	116	240	10	2,400	27,840.00

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Kaldajat janë të vendosura në Shkollën e Mesme Fan, Shkollën 9 vjeçare Rubik, Shkollën e mesme industriale Rubik, dy kaldaja në Shkollën “Pashko Vasa”, nga një për secilën ndërtesë, Shkollën “Nënë Tereza”, Kopështin e ri Rrëshen, Gjimnazin Rrëshen dhe Konviktin Rrëshen. Nga të dhënat vëmë re se kaldaja me fuqi më të lartë është e instaluar në Gjimnazin e Rrëshenit, me fuqi 291 kW, ndërsa kaldaja me fuqi më të ulët është instaluar në shkollën e mesme Fan, me fuqi 85 kW. Kaldaja me më shumë orë pune në vit është kaldaja e Kopështit të ri të fëmijëve, Rrëshen. Kaldaja me konsumin më të lartë të naftës është kaldaja e Shkollës Nënë Tereza. Nëse fuqinë e kaldajave e shumëzojme me orët e punës në vit, na del konsumi i energjisë në kWh, nga vlerat e nxjerra rezulton se kaldajat me

konsum energjie më të lartë janë respektivisht kaldajat e Kopështit të fëmijëve Rrëshen, Gjimnazi Rrëshen dhe Shkolla 9 vjecare Pashko Vasa. Në përpjekje për të menaxhuar kostot, disa ndërtesa, përfshirë shkollat dhe institucionet, përdorin sistemet e ngrohjes me orar të kufizuar. Ky kufizim ndikon negativisht në konfortin termik për nxënësit dhe stafin, veçanërisht gjatë periudhave të ftohta.

Një pjesë e ndërtesave arsimore në Bashkinë Mirditë përdorin akoma soba me dru për ngrohje. Soba me dru për ngrohje përdoren në ato ndërtesa arsimore ku numri i nxënësve është relativisht i ulët dhe investimet për kaldaja nuk janë të justifikueshme. Ndërtesat arsimore që konsumojnë dru për ngrohje janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 13. Të dhënat e konsumit të drurit për ngrohje për vitin 2023

INSTITUCIONI	Sasia Dru m3
Shkolla 9-vjecare + Kopshti Malaj	12
Kopshti Tarazh	4
Shkolla 9-vjecare Rrasfik	14
Kopshti + Çerdhja Rubik	38
Shkolla 9-vjecare Domgjon	43
Kopshti Shengjin	9
Kopshti Klos	12
Shkolla 9-vjecare +Kopshti Kacinar	10
Shkolla 9-vjecare Kurbnesh	30
Shkolla 9-vjecare Bardhaj	25
Shkolla Kthelle e Eper	13
Shkolla 9-vjeçare Lufaj	5
SHMB Perlat Qender	29
Shkolla 9-vjecare Perlat Eper	12
SHMB Reps	44
Shkolla 9-vjecare Orosh	14
Total	314

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

SHMB Reps, Shkolla 9-vjecare Domgjon, Kopështi e Çerdhja në Rubik dhe Shkolla 9 vjeçare Kurbnesh kanë konsumin më të lartë të druve për ngrohje, duke shpenzuar 50% të sasisë vjetore, ndërsa Shkolla 9 vjecare Lufaj dhe Kopështi Shëngjin janë me konsumin më të ulët të sasisë së druve (m3) për ngrohje në vit. Konsumi i druve për ngrohje për të gjitha shkollat është 314 m3.

Përdorimi i sistemeve të ngrohjes me naftë dhe dru në institucionet arsimore të bashkisë Mirditë ka një ndikim të ndjeshëm në mjedis, duke kontribuar në ndotjen e ajrit dhe emetimin e gazrave të efektit serrë. Kaldajat që funksionojnë me naftë, veçanërisht ato me fuqi të lartë, si në Gjimnazin e Rrëshenit dhe Kopështin e fëmijëve Rrëshen, janë përgjegjëse për një konsum të konsiderueshëm naftë, duke ndikuar negativisht në cilësinë e ajrit.

Ndërkohë, përdorimi i sobave me dru, megjithëse mund të duket një alternativë

më e qëndrueshme dhe e përbalueshme, gjithashtu ka ndikim të dukshëm në mjedis. Djegia e drurit shkakton emetim të tymit dhe gazrave të dëmshëm që mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit brenda dhe jashtë ndërtesave, duke kontribuar në ndotjen e pluhurit të suspenduar dhe duke rritur rrezikun për shëndetin e përdoruesve dhe komunitetit. Po ashtu, përdorimi i këtyre sistemeve ngrohjeje shpesh nuk siguron një konfort termik të mjaftueshëm gjatë periudhës me mot më të ngrohtë, kur ndërtesat janë të ngrohta nga dielli dhe është e nevojshme një ftohje e efektshme.

Për të ulur këtë ndikim mjedisor dhe për të siguruar një konfort të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit, është e domosdoshme të shqyrtohen mundësi të tjera të energjisë të pastra dhe të qëndrueshme. Kalimi në sisteme ngrohjeje me pellet ose me energji elektrike nga burime të rinovueshme, ose integrimi i teknologjive të energjisë diellore për ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesave. Po

ashtu, investimet në përmirësimin e izolimit të ndërtesave dhe në masat e kursimit të energjisë mund të ndihmojnë në uljen e kërkesës për ngrohje dhe ftohje, duke krijuar një mjedis më të pastër, të shëndetshëm dhe të rehatshëm për nxënësit, stafin dhe gjithë komunitetin.

2.1.3 Sistemi i furnizimit me ujë

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve për bashkinë Mirditë ofrohet nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime (Sh.a.) Lezhë, e cila mbulon të gjithë qarkun e Lezhës, duke përfshirë Bashkinë Lezhë, Mirditë dhe Kurbinit. Në Mirditë, shërbimi menaxhohet përmes zyrave lokale të Shërbimit Ujësjellës Kanalizim. Kjo shoqëri menaxhon furnizimin me ujë, kanalizimet dhe trajtimin e ujërave të ndotura për këto bashki, duke luajtur një rol kyç në përmirësimin e infrastrukturës ujore dhe garantimin e shërbimeve thelbësore për komunitetet lokale.

Në vijim, paraqitet një analizë e detajuar mbi furnizimin me ujë në bashkinë Mirditë, duke përfshirë mbulimin me shërbim, cilësinë e ujit dhe sfidat kryesore që ndeshen.

Sipas të dhënave të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë, me Njësinë e Shërbimit Ujësjellës Kanalizime Mirditë, në bashkinë Mirditë sistemi i furnizimit me ujë në 4 Njësi Administrative bëhet sipas sistemeve të përshkruara si më poshtë:

- Njësia Administrative Rrëshen ka një sistem të kombinuar, duke përfshirë një stacion pompimi dhe burime me vetërrjedhje. Stacioni i Pompave Rrëshen luan një rol kritik në sigurimin e furnizimit të ujit për këtë njësi, përveç kaptazhit Bargjanë që ofron ujë me vetërrjedhje.
- Njësia Administrative Orosh furnizohet me ujë përmes burimit Grykë-Orosh, i cili operon ekskluzivisht me vetërrjedhje. Kjo metodë është e favorshme për këtë zonë, duke siguruar ujë të freskët dhe të pastër pa nevojën e pompave

- Njësia Administrative Rubik mbështetet në vetërrjedhje, me kaptazhin Qafë-Munaz që ofron një burim të qëndrueshëm të ujit për banorët.
- Njësia Administrative Kthellë furnizohet me vetërrjedhje nga Kaptazhi Bargjanë, i cili është burimi kryesor i furnizimit me ujë për këtë njësi dhe shërben për furnizim me ujë dhe të NJA Rrëshen.

Furnizimi me ujë në bashkinë Mirditë është një nga sfidat kryesore. Vetëm 54.47% e territorit është e mbuluar me shërbim ujësjellës, që nënkupton se gjysma e popullsisë ende nuk ka qasje të vazhdueshme në ujë të pijshëm. Për ata që kanë qasje në shërbim, furnizimi 24 orë në ditë, çka sugjeron ndërprerje të konsiderueshme dhe varësi nga burime alternative. (Shërbimi i Ujësjellës Kanalizimeve, 2018)


Aktualisht, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë ka në operim tre stacione pompimi në Njësinë e Shërbimit Ujësjellës Kanalizime Mirditë. Stacioni i Pompave Rrëshen është thelbësor për furnizimin me ujë në zonën e Rrëshenit dhe ka dy pompa me fuqi 45 kW dhe një pompë me fuqi 90 KW. Këto kapacitete e bëjnë të mundur sigurimin e ujit për një numër të madh përdoruesish. Stacioni Pompimi i Ndërmjetëm ka dy pompa me fuqi 9 kW, që ndihmojnë në shpërndarjen e ujit në zonat përreth dhe lehtësojnë ngarkesën në sistemin kryesor të furnizimit. Stacioni i Pompave Rubik është aktualisht jashtë funksionit, që përbën një sfidë të rëndësishme për sistemin e furnizimit me ujë. Rikonstruksioni i këtij stacioni është i rëndësishëm për të përmirësuar shërbimin në këtë zonë.

Megjithatë, cilësia e ujit të furnizuar është e kënaqshme, me 96.71% të mostrave që plotësojnë standardet për klorin mbetës dhe 100% të mostrave brenda normave të koliformit, që nënkupton se uji është i sigurt për konsum. Kjo performancë tregon për menaxhimin dhe kontrollin relativisht të mirë të cilësisë së ujit të pijshëm, por mungesa e qasjes së vazhdueshme mbetet një sfidë e madhe.

Sistemi i furnizimit me ujë në bashkinë Mirditë përfshin një rrjet transporti dhe shpërndarjeje:

- Rrjeti i transportit ka një gjatësi totale prej 49 km, i cili transporton ujë nga burimet deri në stacionet e pompimit dhe shpërndarjes.
- Rrjeti i shpërndarjes ka një gjatësi prej 174 km, i cili shpërndan ujë nëpër rrjetin e konsumatorëve. Kjo gjatësi e konsiderueshme tregon angazhimin për të mbuluar sa më shumë zona dhe për të arritur sa më shumë përdorues.

Figura 11. Lidhjet e ujit me ujësjellësin



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Numri i lidhjeve të ujit dhe përdoruesve është një tregues i rëndësishëm i efikasitetit të sistemit:

- Numri total i lidhjeve është 2,925 për familjet, 317 për entet private dhe 46 për institucionet. Këto lidhje tregojnë se sistemi i furnizimit me ujë mbështet një gamë të gjerë përdoruesish, duke përfshirë si individë ashtu edhe organizata.
- Popullsia e furnizuar nga ky sistem është e ndarë në dy kategori: 9,344 banorë në qytet dhe 2,356 banorë në fshat, duke arritur një total prej 11,700 banorë të shërbyer. Kjo tregon përpjekjet e sistemit

për të ofruar shërbime të qëndrueshme për të gjitha grupet e popullsisë.

Sistemi i furnizimit me ujë ka një hyrje të madhe uji në krahasim me sasinë që dorëzohet te përdoruesit. Sasia totale e ujit që hyn në sistem është 2,428,770 m³ (gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023). Ky është një kombinim i dy sistemeve që përbëjnë furnizimin e ujit për qytetin:


Sistemi me rrjedhje të lirë prodhon një volum prej 1,688,770 m³.

Sistemi me ngritje mekanike prodhon një volum prej 740,000 m³.

Nga kjo sasi e madhe, vetëm 429,000 m³ ose 18% janë faturuar dhe dorëzuar te përdoruesit për periudhën e vitit 2023. Kjo tregon një pabarazi të konsiderueshme mes ujit që hyn në sistem dhe sasisë që faturon, duke nënkuptuar humbje të mundshme të ujit për shkak të rrjedhjeve, humbjeve teknike ose qëndrueshmërisë së sistemit.

Për sa i përket konsumit të energjisë, të dhënat e periudhës Janar-Dhjetor 2023 tregojnë se konsumi total i energjisë për furnizimin me ujë është 286,545.60 kWh dhe kostoja totale e energjisë për këtë periudhë është 3,350,600 lekë. Ky konsum i energjisë, krahasuar me sasinë e ujit të dorëzuar, tregon se furnizimi me ujë është një proces energjiksht i shtrenjtë.

Figura 12. Konsumi i ujit sipas vendndodhjes së banorëve



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

2.1.4 Sistemi i trajtimi/largimit të ujërave të zeza

Shërbimi i kanalizimeve ofrohet për 56% të popullsisë që jeton në qytet dhe nuk ofrohet për asnjë prej fshatrave, duke treguar për një mungesë të theksuar të investimeve në këtë sektor. Sistemi i kanalizimeve funksionon me rrjedhje të lirë dhe nuk kërkon energji elektrike për funksionimin normal të tij. Mungesa e kanalizimeve në shumicën e zonave, veçanërisht në ato rurale, krijon një situatë të pafavorshme për shëndetin publik dhe mjedisin. Ujërat e ndotura, që nuk trajtohen në mënyrë të duhur, përbëjnë një rrezik për ndotjen e tokës dhe burimeve ujore, duke ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së banorëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Bashkia Mirditë është në nevojë për investime të reja për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve. Mirëmbajtja e sistemeve ekzistuese, sidomos në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, mbetet një prioritet, por ajo që është më kritike është zgjerimi i këtyre sistemeve për të mbuluar pjesën e pambuluar të popullsisë. Përmirësimet financiare dhe krijimi i një modeli të qëndrueshëm të tarifave do të ndihmonin në krijimin e fondeve të nevojshme për investime në infrastrukturë dhe për të mbuluar kostot operative.

Përballë ndryshimeve klimatike dhe sfidave të ndotjes, sidomos nga burime të ndryshme të mbetjeve të lëngëta, është e nevojshme të investohet në sistemet e trajtimit të ujërave të ndotura. Kjo do të mbronte jo vetëm popullsinë, por edhe tokat bujqësore dhe burimet natyrore të zonës, që janë thelbësore për mirëqenien e komunitetit lokal.

Me një mbulim të ulët të shërbimeve dhe nevojën për përmirësime thelbësore, Bashkia Mirditë ka një vizion për të arritur qëndrueshmëri financiare dhe për të ofruar shërbime të përballueshme për qytetarët. Kjo përfshin rritjen e kapaciteteve të brendshme të menaxhimit, përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, dhe krijimin

e mekanizmave të qëndrueshëm për mbledhjen e të ardhurave përmes tarifave të ujit dhe shërbimeve të tjera.

Gjendja aktuale e Bashkisë Mirditë tregon një sfidë të madhe për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Për të përballuar këto sfida, do të kërkohej përpjekje të vazhdueshme për investime në infrastrukturë dhe përmirësim të performancës financiare, si dhe bashkëpunim më i mirë mes sektorëve publikë dhe privatë. Zgjidhjet e qëndrueshme afatgjata do të jenë kritike për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit në këtë zonë të rëndësishme të Shqipërisë.

2.1.5 Ndriçimi publik dhe sinjalistika e trafikut

Në Bashkinë Mirditë, ndriçimi publik ofrohet kryesisht në zonat kryesore të qyteteve dhe në qendrat e njësive administrative, si dhe në vende publike me funksione të veçanta. Ky sistem ndriçimi ndihmon për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve, duke kontribuar në krijimin e një ambienti të favorshëm për aktivitetet sociale, kulturore dhe ekonomike. Ndriçimi publik luan një rol të rëndësishëm në aspektin social dhe kulturor. Një ndriçim i mirë rrit sigurinë në rrugë, ndihmon në parandalimin e krimeve dhe ndihmon në rritjen e aktiviteteve shoqërore gjatë mbrëmjes.

Në objektivat e Bashkisë Mirditë për vitin 2023 ishte sigurimi i një mbulimi efikas të energjisë për ndriçimin publik për 80% të territorit të Bashkisë dhe sipas raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit, ky zë është plotësuar. (Bashkia_Mirditë, Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, 2023)

Duke marrë në konsideratë koston e faturave të energjisë elektrike për Bashkinë Mirditë vëmë re se 23% e energjisë elektrike shpenzohet për ndriçimin publik rrugor. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat e konsumit të energjisë për ndriçimin publik, duke përfshirë emërtimin e kontratës, konsumin në kWh dhe koston përkatëse në lekë:

Tabela 14. Konsumi i energjisë elektrike për ndricim rrugor dhe sinjalistikë për vitin 2023

Emertimi i kontratës	Konsumi 2023 (kWh)	Kosto 2023 (Lekë)
Bashkia Rreshen Ndriçimi Rrugor	21'404	360'787.2
Rreshen Ndriçimi Rrugor	20'978	353'630.4
Komuna Orosh Ndriçimi rrugor Reps	18'078	305'150.4
Bashkia Rreshen Ndriçim Rrugor	18'004	303'667.2
Bashkia Rrubik Ndriçimi Rrugor	15'164	256'195.2
Bashkia Rrreshen Ndriçimi Rrugor	13'806	233'620.8
Bashkia Rubik Ndriçim Rrugor	10'854	183'547.2
Dega ushtarake Ndricim Rrugor	9'754	165'067.2
Bashkia Rubik Ndriçim Rrugor	8'495	143'916
Bashkia Rreshen Ndriçim Rrugor	7'230	122'664
Metalike Ndriçimi Rrugor	3'675	62'940
Reç Ndriçimi Rrugor	1'543	27'122.4
Rrubik Ndriçimi Rrugor	1'360	24'288
Bashkia Rubik Ndriçimi Lulishtja	175	4'620
Rubik Ndr Rrug Rruga Kishes	0	4'080
Total	150'520	2'551'296

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Ndriçimi publik dhe sinjalistika konsumon rreth 151 MWh, shifër kjo e kuptueshme sepse kemi të bëjmë me konsumin energjistik të një shërbimi dhe jo te vetëm një godine. Bashkia Mirditë ka në total 463.7 km rrugë, nëse marrim një gjërësi rruge mesatare prej

4 m, mund të themi se kemi të bëjmë me 1'854'800 m2 rrugë. Nga të cilat 1'274'000 m2 janë sipërfaqje rrugë urbane që mirëmbahen nga bashkia. (Bashkia_Mirditë, Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, 2023).

Tabela 15. Gjatësia dhe Sipërfaqja e rrugëve

Njësia Administrative	Gjatësia e Rrugëve (km)	Sipërfaqja e Rrugëve (m²)
Rreshen	105.3	421,200
Rubik	31.5	126,000
Orosh	65.5	262,000
Fan	127.5	510,000
Kaçinar	52.6	210,400
Kthellë	42.7	170,800
Selitë	38.6	154,400

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Bashkia Mirditë ka 32'000 m2 zonë urbane me ndricim funksional. Konsumi i energjisë

në këto zona ndriçohet nga një përzierje burimesh, përfshirë ndriçues LED dhe

ndriqes më të vjetër, llamba halogjene. Ndriqesit LED, të cilët janë më eficientë dhe konsumojnë më pak energji, janë një investim nga Bashkinë, duke kontribuar në uljen e kostove operative dhe ndihmuar në

përmirësimin e mjedisit, ndërsa prania e ndriqesve të vjetër ndikon negativisht në eficiencën energjetike dhe koston totale të ndriçimit publik. Nga të dhënat e bashkisë të paraqitura në tabelën e mëposhtme vemë re

Tabela 16. Të dhënat për ndricimin rrugor

Sektori	Viti 2023					
	Konsumi i energjisë (kWh/vit)	Zona urbane me ndricim funksional (m2 rrugë e ndricuar)	Sipërfaqja e rrugëve (m2)	Numri i Ndriqesve jo LED	Numri i Ndriqesve LED	Numri i Ndriqesve total
Ndricimi publik rrugor	151,000	32'000	1'854'800*	534	546	546

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

2.1.6 Transporti publik

Transporti publik ka një rëndësi thelbësore për çdo qytet, pavarësisht madhësisë së tij. Ai është një faktor kyç për sigurimin e lëvizshmërisë së qytetarëve, si dhe për mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social. Në bashkinë Mirditë, një nga sfidat kryesore është mungesa e një sistemi të transportit publik urban. Për shkak të përmasave të vogla të qytetit të Rrëshenit, nuk ekziston një linjë e rregullt transporti për të mbuluar nevojat e qytetarëve brenda qytetit. Kjo

bën që banorët të mbështeten kryesisht tek automjetet private ose tek transporti i përkohshëm, që çon në një rritje të konsumit të karburantit dhe në emetime më të larta të gazeve të dëmshme.

Bashkia ka të miratuara disa linja për lëvizje në qytetet kryesore të Shqipërisë dhe disa linja që lidhin njësitë administrative të Bashkisë Mirditë.

Linjat e miratuara janë si më poshtë:


Rrëshen - Tiranë - Rrëshen	7 orare autobuzash
Rrëshen - Durrës - Rrëshen	1 orar autobuzi
Rrëshen - Shkodër - Rrëshen:	1 orar autobuzi
Rrëshen - Lezhë - Rrëshen	3 orare autobuzash
Rrëshen - Laç - Rrëshen	2 orare autobuzash

Për lidhjet ndërmjet njërive administrative:

Kaçinar - Rrëshen - Kaçinar	2 furgona 8+1
Fan - Rrëshen - Fan	4 furgona 8+1

Orosh - Rrëshen - Orosh	3 autobuza (14+1 dhe 20+1)
Perlat - Rrëshen - Perlat	3 furgona 8+1
Kurbnesh - Rrëshen - Kurbnesh	1 furgon 8+1

Figura 13. Infrastruktura rrugore në NJA Rrëshen



Burimi: CoPLAN, 2024

Automjetet që përdoren për transportin publik në linjat e mësipërme janë të vjetra dhe jashtë kushteve optimale. Disa prej autobuzëve dhe furgonëve janë modele të viteve 1986-1993 dhe nuk janë të pajisura me teknologji moderne për efikasitet në transport. Mjetet e vjetra konsumojnë deri në 30% më shumë karburant sesa mjetet moderne, dhe kërkojnë më shumë mirëmbajtje për shkak të motorëve të teknologjisë së vjetër. Kjo çon në një rritje të ndotjes dhe një konsum të lartë energjie. Sipas një studimi të Komisionit Evropian, automjetet e vjetra mund të emetojnë deri

në 300 g CO₂ për kilometër, ndërsa autobusët modernë emetojnë më pak se 100 g CO₂ për kilometër.

Përveç kësaj, infrastruktura aktuale e transportit nuk nxit përdorimin e formave më të pastra të transportit. Sipas një raporti të Bankës Botërore (2020), aktualisht nuk ekziston një plan i qartë për integrimin e mjeteve elektrike ose hibride në sistemin e transportit publik, çka do të ndihmonte në zvogëlimin e varësisë nga karburantet fosile dhe uljen e emetimeve të gazrave serrë. Gjithashtu, sipas raportit të Ministrisë

së Infrastrukturës dhe Energjisë (2021), vetëm 3% e automjeteve në Shqipëri janë të elektrizuara ose hibride, ndërkohë që shumë qytete evropiane kanë synime për të pasur mbi 20% të flotës së tyre të transportit publik të bazuar në energji të pastër deri në vitin 2030.


Zgjidhja e këtyre problematikave kërkon një qasje të integruar që përfshin modernizimin e flotës së transportit publik dhe krijimin e një infrastrukture që mbështet përdorimin e mjeteve elektrike. Kjo do të ndihmonte në zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë, duke kontribuar në një sistem më të qëndrueshëm, me efikasitet më të lartë energjetik dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, si dhe cilësisë së jetës për qytetarët.

2.1.7 Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve

Shërbimi i menaxhimit të grumbullimit të mbetjeve ofrohet nga vetë bashkia dhe monitorohet dhe kontrollohet rregullisht nga stafi i bashkisë për Bashkinë Mirditë, NJA Rreshen, NJA Rubik, NJA Kthellë, NJA Fan dhe NJA Orosh, ndërsa në NJA Selitë dhe Kaçinar nuk ofrohet shërbim.

Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, që funksionon nën varësinë e Bashkisë, përfshin edhe Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve. Ky sektor është përgjegjës për të gjitha proceset që lidhen me mbetjet, duke përfshirë grumbullimin, mirëmbajtjen e kazanëve, menaxhimin dhe shtimin e pikave të reja për grumbullimin e mbetjeve (PGM). Përveç kësaj, agjencia është e angazhuar edhe në mirëmbajtjen e vend-depozitimit të mbetjeve, që ndodhet në periferi të qytetit.

Figura 14. Sasia e mbetjeve të gjeneruara për secilën njësi administrative



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Sipas mbetjeve të mbledhura dhe numrit të përafëruar të banorëve të shërbyer llogarimisht një gjenerim të përafërt prej 0.7 kg/banor/ditë. Gjatë procesit të planifikimit bashkia propozon vlera më të larta të normës së

gjenerimit, në krahasim me normën e grumbullimit të mbetjeve. Fakt është që jo të gjitha mbetjet hidhen në PGM, që të dërgohen në venddepozitim. Në zonat ku mungojnë PGM, mbetjet hidhen në vijat

ujore apo në vende të hapura, duke bërë që vlerat e normës që grumbullohet (pra të mbetjeve që mblidhen dhe dërgohen në lëndfill), të jenë më të ulta se vlerat e mbetjeve që realisht banorët gjenerojnë çdo ditë.

Në tabelën më poshtë jepet një vështrim i përgjithshëm i ofrimit të shërbimit në bashkinë Mirditë. (Bashkia_Mirditë, PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË MIRDITË 2020-2025, 2020)

Tabela 17. Të dhënat e përgjithsme të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve


Tipi i të dhënave	Vlera
Numri i popullsisë sipas MFE	26,599 banorë
Numri i popullsisë që merr shërbim	15,778 banorë
% e popullsisë që merr shërbim	59.30%
% e territorit të mbuluar me shërbim	75%
Sasia e mbetjeve të gjeneruara (e vlerësuar)	9708 (ton/vit)
Sasia e mbetjeve të mbledhura	4,380 (ton/vit)
Norma e gjenerimit	0.7 (kg/banore/ditë)

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Bazuar në të dhënat e mbetjeve, të cilat raportohen nga Bashkia, në grafikon më poshtë jepet trendi i sasisë së mbetjeve që

gjenerohen sipas NJA në të cilat ofrohet shërbimi me popullsinë përkatëse:

Figura 15. Trendi i sasisë së mbetjeve të gjeneruara sipas NJA



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

NJA Rreshen mban vlerën më të lartë me 2,479 ton/vit, kurse trendi vjen duke u ulur për NJA të tjera deri tek NJA Kaçinar dhe Selitë ku shërbimi nuk ofrohet. Frekuenca e shërbimit në Bashkinë Mirditë ndahet në zonat urbane dhe rurale. Më poshtë jepet frekuenca e mbledhjes së mbetjeve në të gjitha NJA.

Figura 16. Frekuenca e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve për NJA



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Mbetjet grumbullohen nga 5 makina për pastrimin e mbetjeve, të cilat konsumojnë një sasi prej 15'500 litra naftë/ vit. Këto mjete përfaqësojnë një flotë automjesh të përdorura për transportin e mbetjeve dhe pastrimin e territorit. Flota përbëhet nga makina teknologjike, kamionë për pastrim dhe transport, si dhe një kamion me vinç. Disa nga këto mjete, si kamioni ISUZU dhe kamionçina Ford, janë më të vogla dhe kanë konsum më të ulët të karburantit, ndërsa kamionët më të mëdhenj dhe me funksione specifike, si kamioni me vinç dhe kamioni Iserka, kanë konsum më të lartë dhe kërkojnë më shumë energji për funksionimin e tyre.

Megjithatë, këto automjete janë kryesisht të prodhuara në vitet '90, një periudhë kur

teknologjitë për reduktimin e emetimeve dhe efikasitetin e karburantit nuk ishin aq të avancuara sa sot. Për shembull, kamioni me vinç, i prodhuar në vitin 1992, ka një konsum të lartë naftë prej 25 litrash për 100 kilometra, ose 7 litra për orë kur përdor vinçin. Një mjet i tillë, edhe pse i nevojshëm për operacione specifike, kontribuon ndjeshëm në rritjen e ndotjes mjedisore për shkak të djegies së sasisë së madhe të karburantit.

Në të njëjtën mënyrë, kamioni Iserka, me një motor të fuqishëm prej 190 kW, konsumon 45 litra për 100 kilometra, një shifër që reflekton jo vetëm fuqinë e lartë të motorit por edhe nevojën për më shumë energji për të kryer funksionet e tij të rënda. Nëse këto makina përdoren në zona urbane ose të banuara, impakti në cilësinë e ajrit do të jetë i dukshëm, duke kontribuar në emetimet e larta të gazrave të dëmshëm (CO₂, NO_x, PM) që janë pasojë direkte e djegies së karburantit.

Nga ana tjetër, disa mjete më të vogla, si kamionçina Ford, kanë konsum më të ulët krahasuar me të tjerët, me 15 litra për 100 kilometra. Megjithatë, edhe kjo makinë kontribuon në ndotjen për shkak të përdorimit të naftës si karburant kryesor dhe vjetërsisë së saj, pasi është prodhuar në vitin 2003.

Në përgjithësi, kjo flotë përfaqëson një grup mjesh që janë shumë të rëndësishme për funksionet e përditshme të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, por që kanë një kosto të lartë mjedisore. Përdorimi i karburantit fosil, veçanërisht në makinat e vjetra, rrit ndjeshëm emetimet e gazrave serrë dhe ndotësve të ajrit, që ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit lokal dhe kontribuojnë në ndryshimet klimatike globale. Me kalimin e viteve, këto mjete janë bërë gjithnjë e më pak efikase në krahasim me teknologjitë moderne që përdorin teknologji për reduktimin e emetimeve ose dhe energji alternative si elektrike ose hidrogjeni. Kjo nënkupton se flota në fjalë, megjithëse e domosdoshme për momentin, ka nevojë për përmirësime dhe modernizim për të reduktuar impaktin

e saj në mjedis dhe për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme.

Mbetjet e grumbulluara nga të gjitha PGM (Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve) me mjetet e Bashkisë depozitohen në venddepozitim të Ndërfushasit. Mungesa e kompostimit dhe e një landfilli të licencuar në Bashkinë Mirditë paraqet një sfidë të madhe për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Aktualisht, mbetjet depozitohen në një venddepozitim të Ndërfushasit, i cili ka nisur të shndërrohet në landfill, por ende nuk ka marrë miratimin e licencës për të funksionuar si i tillë. Plani strategjik për menaxhimin e mbetjeve planifikon që mbeturinat e krijuara në Bashkinë Mirditë të dërgohen në landfillin e Bushatit. Ky landfill, megjithatë, është jashtë standardeve, pasi mungon mirëmbajtja e duhur dhe nuk ka kushte të përshtatshme për trajtimin e mbetjeve.

Në territorin e Bashkisë Mirditë, aktivitetet lidhur me riciklimin dhe kompostimin janë jo prezente. Asnjë nga njësitet administrative nuk ka një skemë të organizuar për riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve, duke e lënë menaxhimin e mbetjeve të përziera dhe pa një plan të qartë për ndarjen në burim. Mbetjet e krijuara grumbullohen dhe transportohen të përziera, pa pasur një sistem të mirëfilltë të menaxhimit të mbetjeve të riciklueshme. Komuniteti rom është i vetmi që ka marrë përsipër një aktivitet informal të përditshëm për mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme, kryesisht nga PGM, apo në vend depozitimet ilegale.

Gjendja e landfillit të Ndërfushasit është shqetësuese për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, që ka ndikuar në mundësinë e menaxhimit të mbetjeve në mënyrë të qëndrueshme. Ky venddepozitim ka rrethim dhe disa sisteme të instaluar si drenazhimi i ujërave të ndotura dhe një rrugë unazore për akses, por nuk ka përmirësime në trajtimin e gazrave dhe shllamit, duke e lënë mjedisin të ekspozuar ndaj kërcënimeve. Pa trajtim të duhur për gazrat dhe lëndët e tjera që çlirohen nga mbetjet, ky landfill paraqet një

rrezik të madh për mjedisin, pasi mund të shkaktojë ndotje të ujërave nëntokësore dhe rritje të ndotjes ajrore.

Në këtë kontekst, detyra kryesore e Bashkisë Mirditë është krijimi i një strukture të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve, duke implementuar një sistem të diferencuar për grumbullimin e mbetjeve dhe zhvillimin e një mjedisi të përshtatshëm për riciklimin dhe kompostimin. Dërgimi i mbetjeve në landfill të licencuar, implementimi i strategjive dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për të ricikluar mbetjet e riciklueshme, ndërtimi i qendrave të kompostimit dhe pastrimi i vend depozitimeve ilegale janë hapa të rëndësishëm që duhen ndërmarrë për të mbrojtur mjedisin dhe për të reduktuar ndikimin e mbetjeve në shëndetin e komunitetit.

Duke marrë në konsideratë që 99% e sipërfaqes së Bashkisë Mirditë është e përbërë nga sisteme bujqësore, ujore dhe natyrore, ndërtimi i qendrave të kompostimit do të ishte shumë i dobishëm për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve organike dhe uljen e ndikimit negativ në mjedis. Kjo do të kontribuonte në ruajtjen e fertilitetit të tokës bujqësore, zvogëlimin e mbetjeve të padëshiruara dhe promovimin e një cikli të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve.

2.1.8 Makinat e pasagjerëve dhe minibusët (nën juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore)

Transporti luan një rol të jashtëzakonshëm në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e mjedisit dhe eficiencën e energjisë. Me një numër prej 43,029 mjeteve rrugore të regjistruara deri në vitin 2023 për Qarkun Lezhë, sektori i transportit kontribuon në lehtësimin e tregtisë lokale, ku prania e kamionëve dhe mjeteve të tjera transportuese mbështet shpërndarjen e produkteve bujqësore dhe industriale nga Qarku Lezhë drejt tregjeve kombëtare dhe rajonale. Gjithashtu, transporti ndikon pozitivisht në nxitjen e turizmit, duke përmirësuar aksesin rrugor


drejt destinacioneve të njohura turistike, si Shëngjini dhe zona të tjera bregdetare. Njëkohësisht, lidhja e zonave rurale me qytetet nëpërmes rrugëve kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Megjithatë, infrastruktura aktuale rrugore dhe mungesa e transportit publik të zhvilluar mbeten sfida që pengojnë një zhvillim më të shpejtë ekonomik.

Për Qarkun Lezhë, autoveturat që përdorin naftë përfaqësojnë 73.5% të flotës totale, duke kontribuar ndjeshëm në ndotjen e ajrit. Rritja e numrit të mjeteve është e shoqëruar

me përkeqësimin e cilësisë akustike, veçanërisht në qytetet si Lezha dhe Shëngjini, ndërsa ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve ndikojnë negativisht në ekosistemet lokale, duke shkaktuar fragmentim të habitateve.

Përderisa flota e mjeteve rrugore në Qarkun Lezhë dominohet nga autoveturat me motorë konvencionalë, efikasiteti i energjisë është në nivel të ulët. Vetëm 1.3% e flotës totale janë mjete elektrike ose hibride, duke treguar për një adoptim të ngadaltë të teknologjive të reja. Pjesa më e madhe e autoveturave janë të prodhuara para vitit 2010, duke ofruar efikasitet të ulët të konsumit të karburantit.

Figura 17. Mjetet e Bashkisë Mirditë sipas vitit të prodhimit



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024


Sipas të dhënave nga DPSHTRR, Bashkia Mirditë ka gjithsej 5,694 automjete të regjistruara deri në vitin 2023. Mjetet e Bashkisë Mirditë përfaqësojnë vetëm 13% të mjeteve për të gjithë qarkun. Këto mjete janë të shpërndara në kategori të ndryshme: 512 janë prodhuar deri në vitin 1990, 1621 janë prodhuar midis viteve 1990 dhe 2000, 3071 janë prodhuar nga viti 2000 deri në vitin 2010, dhe 490 janë prodhuar pas vitit 2010.

Një pjesë e madhe e flotës është me lëndë djegëse tradicionale: 4722 automjete përdorin naftë, ndërsa 645 përdorin benzinë.

Pjesa tjetër është e ndarë mes përdorimit të gazit dhe elektricitetit, me vetëm 2 mjete plotësisht elektrike dhe 4 mjete hibride (naftë + elektrike). Po ashtu, 2 mjete përdorin gaz dhe 302 mjetet janë me kombinim të benzinës dhe gazit. Përveç kësaj, vetëm 73 autobusë janë të regjistruar në Bashkinë Mirditë, ndërkohë që ka gjithashtu një numër të vogël automjesh për përdorim të veçantë dhe për transport të perzier.

Një pjesë e konsiderueshme e flotës përbëhet nga automjete të prodhuara para vitit 2010, duke e bërë flotën e transportit të Mirditës të pasigurt dhe me efikasitet të ulët energjetik.

Figura 18. Ndarja e mjeteve sipas lëndës djegës




Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Efikasiteti i energjisë është një sfidë e madhe pasi 73.5% e automjeteve përdorin naftë dhe kanë një ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit dhe përkeqësimin e cilësisë akustike. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt me rritjen e numrit të mjeteve, ndërsa mungesa e infrastrukturës dhe transportit publik të zhvilluar pengon zhvillimin ekonomik të qarkut.

Përmirësimi i situatës kërkon një qasje të integruar që përfshin modernizimin e flotës, përfshirjen e autobusëve elektrikë dhe nxitjen e përdorimit të mjeteve të energjisë së rinovueshme. Investimet në rrugët që lidhin zonat rurale me qytetet dhe zhvillimi i një sistemi të transportit publik efikas janë të domosdoshme. Gjithashtu, instalimi i stacioneve të karikimit elektrik dhe dhënia e subvencioneve për automjete elektrike dhe hibride do të ndihmonte në promovimin e një transporti më të qëndrueshëm.

Figura 19. Numri i mjeteve sipas llojeve kryesore për Bashkinë Mirditë




Burimi: Dega Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve, Mirditë

Për të arritur këto qëllime, zbatimi i politikave për reduktimin e përdorimit të karburanteve fosile dhe mbështetje për përdorimin e energjisë së pastër është i rëndësishëm për të përmirësuar efikasitetin e energjisë dhe për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.

2.1.9 Bujqësia

Bujqësia zë një vend të rëndësishëm ndër aktivitetet dhe shërbimet e qeverisjes vendore në bashkinë Mirditë, për shkak të rolit të saj jetik në ekonominë dhe mjedisin e zonës. Vetëm 1% e sipërfaqes së bashkisë është zonë urbane, 99% e saj përbëhet nga sisteme bujqësore, ujore dhe natyrore. Kjo përqindje e lartë tregon që bujqësia është jo vetëm burimi kryesor i të ardhurave dhe mirëqenies për banorët, por edhe një faktor kyç për ruajtjen e ekosistemit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për këtë arsye, përfshirja e bujqësisë në strategjitë dhe shërbimet e qeverisjes vendore është thelbësore për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale dhe për të garantuar një menaxhim të efektshëm të tokës dhe resurseve.

Figura 20. Sipërfaqja e kulturave të mbjella, 2019



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Sipas statistikave, (Bashkia_Mirditë, Statistikat e Bujqësisë, 2019) bashkia Mirditë ka një sipërfaqe bujqësore prej 6230 hektarë, me një aftësi ujitëse prej 3400 hektarësh, nga të cilat aktualisht vetëm 1900 hektarë shfrytëzohen. Kjo tregon një potencial të madh për zgjerimin e ujitjes dhe përmirësimin e produktivitetit bujqësor.

Në vitin 2019, drithërat kryesore të kultivuara në Mirditë ishin misri dhe gruri, me një rendiment të lartë për misrin (62 kv/ha). Për perimet, janë kultivuar gjithsej 310 hektarë, me një prodhim të përgjithshëm prej 4548 tonësh. Nga këto, 231 hektarë janë të dedikuara për perime të njoma, të cilat përbëjnë shumicën e prodhimit.

Përmirësimi i produktivitetit bujqësor mbështetet edhe në mekanizimin e procesit bujqësor. Në Mirditë ka 22 traktorë, 12 minitraktorë, dhe mjete të tjera si autokombajnë dhe makineri mbjellëse. Megjithatë, përdorimi i mekanizimit mbetet ende i kufizuar krahasuar me potencialin e zonës.

Një nga sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë në Mirditë është prodhimi i bimëve foragjere. Në vitin 2019, 1350 hektarë ishin të dedikuara për prodhimin e jonxhës dhe livadheve, duke siguruar një prodhim total prej 29,700 tonësh. Kjo mbështet sektorin blegtoral, i cili përbën një pjesë të rëndësishme të ekonomisë rurale. Në Mirditë, sektori blegtoral është shumë i rëndësishëm, me 3000 krerë lopë dhe 8000 krerë dele. Prodhimi vjetor i qumështit arrin në 6433 ton, ndërsa ai i mishit arrin në 1874 ton. Ky sektor është një burim i rëndësishëm i të ardhurave për komunitetin, por edhe një burim i emetimeve të gazrave serrë, të tilla si metani.

Në Mirditë ka një përqendrim të lartë të pemëve frutore, përfshirë 9000 rrënjë mollë, 30,400 rrënjë kumbulla, dhe 11600 rrënjë arra, ndër të tjera. Këto kultura janë të rëndësishme për ekonominë lokale, duke siguruar një prodhim të qëndrueshëm të frutave. Në ullishtet e zonës janë mbjellë 587

Tabela 18. Mjetet bujqesore në Bshkinë Mirditë

Lloji i Mjetit	Numri i Mjeteve	Raporti (Numri i Mjeteve/Sipërfaqja Ha)
Traktor me rrota	22	0.00353
Minitarktoe	12	0.00193
Makine mbjellse	14	0.00225
Motokorrse	6	0.00096
Autokombanja	1	0.00016
Traktor me zinxhire	0	0
Freza	20	0.00321
Shuma	75	0.01204

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

rrënjë ulliri, që ndihmojnë në diversifikimin e ekonomisë rurale.

Bashkia Mirditë ofron një gamë të gjerë mundësish për zhvillimin e sektorit bujqësor, falë resurseve të saj natyrore dhe potencialit të lartë prodhues. Bashkia Mirditë ka një sipërfaqe bujqësore gjithsej prej 6230 hektarësh, e cila përfshin një gamë të gjerë kulturash dhe aktiviteteve bujqësore. Aftësia ujitëse në këtë zonë është 3400 hektarë, që tregon se ka kapacitet të konsiderueshëm për të mbështetur rritjen e kulturave, veçanërisht nëse respektohen praktikrat e mira të menaxhimit të ujit.

Megjithatë, aktualisht vetëm 1900 hektarë janë të shfrytëzuar, që nënkupton se ka një potencial të madh për zgjerimin e aktivitetit bujqësor. Po ashtu, sipas të dhënave, sipërfaqja faktike e mbjellë është 1780 hektarë. Kjo tregon se është e nevojshme të identifikohen dhe adresohen arsyet që pengojnë shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve bujqësore të zonës.

Një nga mundësitë është implementimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore. Këto praktika përfshijnë përdorimin e teknologjive të reja, si sistemet e ujitjes me pika dhe teknikat e mbrojtjes së tokës, që ndihmojnë

në optimizimin e përdorimit të burimeve natyrore. Kjo do të kontribuonte në rritjen e produktivitetit dhe do të minimizonte ndikimin negativ mbi mjedisin.

Investimi në mekanizimin e bujqësisë paraqet një mundësi të rëndësishme për rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit. Rritja e numrit të mjeteve mekanike, si traktorë dhe makineri mbjellëse, do të ndihmonte në uljen e kostove të punës dhe do të lehtësonte punën e fermerëve. Kjo do t'i lejonte ata të rrisnin sipërfaqen e mbjellë dhe të përballonin më mirë kërkesat e tregut. Sektori blegtoral në Mirditë ka gjithashtu potencial të madh. Me 3000 krerë lopë dhe 8000 krerë dele, ky sektor ofron mundësi për të rritur prodhimin e qumështit dhe mishit, si dhe për të zhvilluar produkte të tjera të lidhura me blegtorinë, si djathi dhe kërpudhat. Investimet në infrastrukturën blegtorale, si stallat dhe pajisjet e përpunimit, do të ndihmonin në rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve blegtorale.

Bashkia Mirditë gjithashtu ka potencial për turizëm rural, i cili mund të lidhë traditat bujqësore me zhvillimin e turizmit. Krijimi i ekskursioneve dhe aktiviteteve për vizitorët në fermat lokale do të ndihmonte në promovimin e produkteve vendase dhe do

të rrisnin të ardhurat për komunitetet rurale. Kjo do të inkurajonte gjithashtu ruajtjen e traditave dhe kulturës lokale.

Krijimi i bashkëpunimeve mes fermerëve, qeverisë dhe organizatave joqeveritare mund të ofrojë mbështetje për zhvillimin e projekteve bujqësore dhe përmirësimin e kushteve për fermerët. Kjo përfshin trajnime, mbështetje financiare dhe akses në teknologji moderne.

2.2 Konsumi i energjisë në sektorin rezidencial dhe sektorët e tjerë

Konsumi i energjisë në bashkinë Mirditë është një faktor kyç për analizën e efikasitetit energjetik në sektorin rezidencial dhe privat. Kjo analizë do të ndihmojë në identifikimin e fushave ku mund të ndërmerren masa për

Me një qasje strategjike dhe investime të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm, bashkia Mirditë ka potencial të lartë për të forcuar sektorin bujqësor dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për komunitetin e saj. Këto mundësi, të mbështetura nga praktikë të qëndrueshme dhe inovacione, do të kontribuonin në një të ardhme më të mirë për fermerët dhe për mjedisin.

të rritur eficiencën e energjisë dhe për të reduktuar ndikimet mjedisore. Në tabelën e mëposhtme kemi të pasqyruar konsumin e energjisë elektrike sipas tipologjisë për të gjithë bashkinë Mirditë. (OSHEE, 2023)

Tabela 19. Konsumi i energjisë elektrike në Mirditë

NR	Kategoria	Abonente	Çmimi leke/kë	Konsumi mesatar mujor	Konsumi mesatar Vjetor kWh
1	Familjare	6,828	11.4	900,000	10,800,000.00
2	Institucione				
	Buxhetore	151	16.8	63,000	756,000.00
	Jo buxhetore	53	16.8	9,800	117,600.00
	Total per institucione	204		72,800	
3	Privat me lidhje ne sistemin e OSHEE				
	Furra buke...	8	7.6	11,000	132,000.00
	Biznes normal	732	16.8	263,000	3,156,000.00
	Totali Privat me lidhje ne sistemin e OSHEE	740		274,000	
4	Privat me lidhje jashte sistemit te OSHE	98	22.3	235,000	2,820,000.00
	TOTAL	7,870		1,481,800	17,781,600.00

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Sektori rezidencial përbën një pjesë të madhe të konsumit të energjisë në bashkinë Mirditë.

Aktualisht, ka 6,828 abonentë familjarë, të cilët konsumojnë mesatarisht 10.8 milion


kWh në vit. Ky nivel i lartë i konsumit përbën rreth 61% të konsumit total të energjisë në territorin e bashkisë duke u ndjekur më pas nga sektori i cili në total ze 34% të konsumit, por nga këto vetëm 18% janë të lidhur me rrjetin e OSHEE, 16% e tyre operojnë jashtë këtij sistemi.

Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje është një sfidë kryesore, pasi ngrohja me elektricitet është shpesh joefikase dhe kontribuon në rritjen e kërkesës për energji gjatë muajve të ftohtë të dimrit. Shumë nga ndërtesat rezidenciale nuk kanë izolim të mirë termik, duke bërë që familjet të shpenzojnë më shumë energji për të mbajtur shtëpitë të ngrohta, duke rritur gjithashtu kostot dhe ndikimin në mjedis.

Përveç sektorit rezidencial, edhe bizneset dhe fermat përballen me sfida të ngjashme në lidhje me konsumin e energjisë për ngrohje. Shumë prej tyre varen nga energjia elektrike për të siguruar kushte optimale të punës dhe ruajtjen e produkteve, veçanërisht në sektorët e përpunimit. Përdorimi i pajisjeve me efikasitet të ulët energjetik ndikojnë drejtpërdrejt në kostot operative dhe qëndrueshmërinë e këtyre aktiviteteve ekonomike.

Për të kuptuar më mirë shpërndarjen e bizneseve dhe fermave në nivel lokal, më poshtë paraqitet një analizë vizuale që pasqyron numrin e tyre dhe sipërfaqet e tokës bujqësore sipas njësive administrative të Bashkisë Mirditë. (Bashkia_Mirditë, 2020)

Figura 21. Shpërndarja e bizneseve dhe fermave përçdo NJA




Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

Vëme re se NJA Rrëshen është njësia më e zhvilluar ekonomikisht, me numrin më të madh të bizneseve dhe fermave. Kjo zonë përfaqëson një qendër të rëndësishme për aktivitete ekonomike, duke qenë qendra administrative e bashkisë. Sipërfaqja e konsiderueshme e tokës bujqësore ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e sektorit bujqësor. Ndërsa njësitë e tjera administrative si Rubik dhe Orosh kanë një fokus të madh në bujqësi, ato përmbajnë një numër më të kufizuar të bizneseve, duke

treguar se ekonomia e tyre mbështetet kryesisht në sektorin bujqësor. Rubik, me 76 biznese dhe një sipërfaqe bujqësore prej 566 hektarësh, ofron një mundësi për zhvillimin e bizneseve që lidhen me përpunimin e produkteve bujqësore.

Në të njëjtën mënyrë, njësiti si Fan dhe Kthellë kanë një sektor bujqësor të rëndësishëm, por me një numër minimal të bizneseve. Ky fakt tregon një mundësi të madhe për përmirësimin e ekonomisë lokale

Figura 22. Shpërndarja e sipërfaqeve bujqësore për çdo NJA



Burimi: Bashkia Mirditë, përpunimi nga CoPlan, 2024

përmes investimeve në infrastrukturë dhe zhvillimin e ndërmarrjeve bujqësore.

Në lidhje me konsumin e energjisë, 740 abonentë privatë të lidhur me OSHEE kanë konsumuar rreth 3 GWh energji elektrike në vitin 2023. Një pjesë e madhe e këtij konsumi i përket bizneseve të vogla, si dhe furra buke, të cilat mbështeten në energjinë elektrike për operacionet e tyre të përditshme. Ky sektor përbën një pjesë të rëndësishme të konsumit, duke ndikuar drejtpërdrejt në kërkesën për energji dhe në kostot operacionale.

3. VIZIONI DHE ANALIZA E GJETJEVE PËR EFICIENCËN E ENERGJISË NË BASHKINË MIRDITË

3.1 Vizioni

Vizioni i PVVEE në Bashkinë Mirditë është krijimi i një komuniteti të qëndrueshëm dhe dinamik, ku energjia konsumohet në mënyrë eficiente dhe burimet e rinovueshme janë të integruara në jetën e përditshme të

Për të përballuar sfidat e paraqitura nga konsumi i energjisë në sektorin rezidencial dhe sektoret e tjerë, Bashkia Mirditë mund të ndërmarrë disa masa të rëndësishme për të përmirësuar eficiencën e energjisë si përmirësimi i izolimit termik në ndërtesat rezidenciale. Investimi në izolimin termik të ndërtesave mund të ulë ndjeshëm nevojën për energji për ngrohje dhe ftohje. Kjo do të reduktojë kërkesën për energji elektrike gjatë dimrit dhe verës, duke ndihmuar në uljen e emetimeve dhe kostove të energjisë. Një mënyrë tjetër që mund të ndihmojë në uljen e konsumit të energjisë do të ishte dhe auditim i plotë energjetik i bizneseve private do të identifikonte pikat e dobëta të përdorimit të energjisë dhe do të ndihmonte në gjetjen e masave për të përmirësuar eficiencën. Kjo do të ndihmonte bizneset jo vetëm të reduktojnë shpenzimet, por edhe të reduktojnë emetimet e karbonit.

Inkurajimi i instalimit të paneleve diellore si një burim alternativ energjie për shtëpitë dhe bizneset do të kishte një ndikim të rëndësishëm në reduktimin e varësisë nga rrjeti dhe do të kontribuonte në uljen e emetimeve të karbonit. Këto masa të kombinuara me fushatat për të edukuar qytetarët dhe bizneset mbi përfitimet e kursimit të energjisë dhe përdorimin e pajisjeve me eficiencë të lartë energjetike do të ndihmonin në ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve dhe në përmirësimin e zakoneve të konsumit.

qytetarëve. Aty kusynohet arritja e një balance të qëndrueshme mes zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit, duke promovuar teknologjitë e pastra dhe praktikatat eficiente në të gjithë sektorët e ekonomisë. Ky vizion

do të realizohet përmes implementimit të masave konkrete për reduktimin e konsumit të energjisë, rritjen e efikasitetit energjetik, dhe integrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme në nivel lokal, për të siguruar një të ardhme më të pasur dhe më të qëndrueshme për të gjitha brezat.

3.2 Gjetjet Kryesore

Pas një analize të çdo sektori ekonomik me ndikim në eficiencën e energjisë në bashkinë Mirditë, në Tabela 5. “Konsumi total i energjisë sipas sektorëve” të paraqitur ne seksionin 2.1.1, kuptojmë se sektori i ndërtesave private konsumon **10,800 MWh**, duke e bërë atë sektorin më kritik për eficiencën energjetike. Ndërtesat publike pasojnë me **874 MWh**, duke sugjeruar një potencial të madh për optimizim përmes modernizimit dhe praktikave më të mira në menaxhimin e energjisë.

Sistemi i furnizimit me ujë ka një konsum prej **320 MWh**, që ofron mundësi për përmirësim në proceset operative, ndërsa ndriçimi publik dhe sinjalistika e trafikut konsumojnë rreth **150 MWh**, çka sugjeron se zëvendësimi me teknologji LED dhe investime në panele fotovoltaike për ndriçim rrugor, mund të sjellë përfitime të mëdha.

Këto gjetje theksojnë nevojën për strategji të qëndrueshme dhe koordinuese për eficiencën energjetike në të gjithë sektorët, si dhe rëndësinë e edukimit të qytetarëve për të mbështetur masat për përmirësimin e përdorimit të energjisë.

3.3 Analiza e Gjetjeve

Bashkia Mirditë përballet me sfida të ndryshme në fushën e eficiencës energjetike, të cilat përfshijnë konsumimin e lartë të energjisë, mungesën e investimeve në burime të rinovueshme, nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të qytetarët dhe politikave të papërshtatshme. Këto sfida ofrojnë mundësi për zhvillim dhe përmirësim, duke krijuar një bazë të fortë për ndërhyrje që synojnë një të

ardhme më të qëndrueshme për bashkinë Mirditë. Ky vizion do të kontribuojë në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe në zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që del nga analiza është ndikimi mjedisor i konsumit të energjisë dhe efektet që ka përdorimi aktual i energjisë në mjedisin përreth. Konsumi i lartë i energjisë, sidomos nga ndërtesat private dhe publike, ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e ajrit dhe ngrohjen globale, duke kontribuar në rritjen e emetimeve të gazrave serë. Kjo kërkon ndërhyrje për të zbatuar praktika më efikente, siç është përdorimi i burimeve të rinovueshme dhe optimizimi i sistemeve të energjisë për të minimizuar pasojat mjedisore. Për të arritur këtë, është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse, e cila përfshin zhvillimin e politikave të qarta dhe të qëndrueshme në nivel lokal dhe kombëtar.

Rëndësia e planifikimit strategjik dhe të koordinuar për përmirësimin e eficiencës së energjisë është thelbësore. Pa një plan të detajuar dhe të miratuar, është e vështirë të identifikohen mundësitë për investime dhe përmirësime që mund të sjellin ndryshime të qëndrueshme. Një planifikim i mirë i burimeve dhe veprimeve do të mundësojë përdorimin efikas të burimeve financiare dhe do të sigurojë që masat e ndërmarra të jenë të qëndrueshme dhe të kenë ndikim të matshëm.

4. MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E EFICIENCËS SË ENERGJISË

Në një kohë kur sfidat mjedisore po bëhen gjithnjë më të dukshme, marrja e masave për rritjen e eficiencës së energjisë është një hap i rëndësishëm drejt një të ardhme më të qëndrueshme. Këto masa jo vetëm që reduktojnë ndjeshëm kostot e energjisë për komunitetin, por edhe kontribuojnë në uljen e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Çdo përpjekje për të optimizuar përdorimin e energjisë nënkupton një angazhim për të mbrojtur burimet tona natyrore dhe

për të krijuar kushte më të mira jetese për brezat e ardhshëm. Në fund të fundit, efienca energjetike nuk është thjesht një qëllim teknik, por një domosdoshmëri për të siguruar mirëqenien dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë Mirditë.

Në bashkinë Mirditë, janë realizuar një sërë projektesh të fokusuar në rikonstruksionin dhe përmirësimin e ndërtesave publike, të cilat kanë sjellë përfitime në uljen e konsumit të energjisë. Ndër projektet mund të përmendim rikonstruksionin i shkollave si “Pashko Vasa” dhe “Shkolla e Mesme Fan,” ku përveç përmirësimeve strukturore, është implementuar edhe një sistem i ri ngrohjeje, duke rritur ndjeshëm konfortin termik. Po ashtu, janë instaluar sisteme ndriçimi më të qëndrueshme dhe qw pwrdorin më pak energji, duke ndikuar pozitivisht në uljen e konsumit. Përveç ndërtesave shkollore, janë marrë masa edhe në objekte të tjera, si rikonstruksionin i pallatit të sportit “Arjana Arapi”.

Gjatë periudhës 2015-2021, Bashkia Mirditë ka përfituar nga një sërë projektesh të financuara nga donatorë të huaj, të cilët kanë pasur një ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Këto projekte, ndonëse me qëllime të ndryshme, kanë kontribuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në ruajtjen e burimeve natyrore dhe përmirësimin e kushteve mjedisore.

Një nga projektet më të rëndësishme ishte “Infokulla Mirdita” (2016-2017), që, përveç promovimit të turizmit dhe kulturës, lidhet ngushtë me zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit natyror dhe mbrojtjen e ekosistemeve lokale. Ky projekt ka ndihmuar në sensibilizimin e vizitorëve dhe komunitetit për rëndësinë e ruajtjes së natyrës, duke krijuar një model zhvillimi që respekton dhe mbron mjedisin.

Në vazhdim, “Promovimi i turizmit malor në Bashkinë Mirditë” (2018-2019) fokusohet në kthimin e resurseve natyrore në atraksione turistike të aksesueshme, duke kontribuar në ruajtjen e mjedisit malor përmes shenjave

turistike dhe shtigjeve të mirëmbajtura. Ky projekt jo vetëm që nxit zhvillimin e turizmit, por ndihmon edhe në promovimin e një qëndrimi të përgjegjshëm ndaj natyrës.

Po ashtu, projekti “Shtëpia e Bletëve” (2019) ka luajtur një rol kyç në ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e bletëve dhe insekteve për ruajtjen e ekosistemit. Përmes këtij projekti, Bashkia Mirditë ka mundësuar ruajtjen dhe zhvillimin e një aspekti të rëndësishëm të natyrës, duke nxitur gjithashtu punësimin dhe aktivitetet ekonomike në fushën e mbrojtjes së natyrës. Një tjetër projekt i rëndësishëm, “Rehabilitimi i kanalit vaditës Malaj-Tarazh” (2022), përfshin komponentë të zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor, duke ndihmuar në përdorimin më efikas të burimeve ujore dhe përmirësimin e infrastrukturës vaditëse. Ky projekt ka një ndikim të drejtpërdrejtë në ekosistemet bujqësore, duke garantuar furnizim të qëndrueshëm me ujë për bujqësinë dhe duke ulur humbjet e energjisë. Në të njëjtën linjë, projekti “Për sigurimin e një kamioni për grumbullimin e mbeturinave dhe kontejnerëve të mbeturinave” (2021) ka kontribuar në përmirësimin e kushteve mjedisore përmes menaxhimit më të mirë të mbetjeve urbane. Ky investim ka përmirësuar ndjeshëm pastërtinë në qytet dhe ka reduktuar ndotjen, duke rritur ndërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen e mjedisit.

Realizimi i projekteve të mëparshme ka krijuar një bazë të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të bashkisë Mirditë, por është e domosdoshme që të vazhdojmë të angazhohemi për implementimin e praktika të mira dhe zgjidhje inovative. Kjo do të kontribuojë në uljen e konsumit të energjisë dhe kostove për qytetarët, ndërkohë që do të përmirësojë cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e mjedisit. Është e rëndësishme të identifikojmë dhe zbatojmë masat e duhura për të rritur eficiencën energjetike, përfshirë edukimin e komunitetit, përmirësimin e infrastrukturës dhe adoptimin e teknologjive të reja që mbështesin qëllimet e qëndrueshme të Bashkisë Mirditë.

Kategoria e masave të parashikuara për rritjen e efikasitetit të energjisë në bashkinë Mirditë është e strukturuar në disa drejtim kryesore, secila me objektiva të veçantë dhe aktivitete të planifikuara. Këto kategori përfshijnë:

Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Energjisë, përfshin krijimin e strukturave të menaxhimit të energjisë në nivel lokal, përmirësimin e kapaciteteve menaxheriale, dhe implementimin e strategjive për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të energjisë.

Përmirësimi i Efikasitetit të Energjisë në Ndërtesa Publike, fokusohet në zbatimin e masave si instalimi i paneleve fotovoltaike, izolimi termik, zëvendësimi i dritareve dhe sistemeve të ngrohjes, si dhe përdorimi i pajisjeve dhe materialeve ndihmëse që kontribuojnë në uljen e konsumit të energjisë.

Përmirësimi i Eficiencës së energjisë në Shërbimet Bashkiake, përfshijnë iniciativa për përmirësimin e eficiencës për sistemet e vaditjes dhe furnizimit me ujë, modernizimin e sistemit të ndriçimit publik, si dhe përmirësimin e flotës së automjeteve të bashkisë.

Përfshirja e Komunitetit dhe Bizneseve në Eficiencën e Energjisë, ka në fokus organizimin e fushatave informuese, ndergjegjësuere dhe promovimin e eficiencës së energjisë për komunitetin dhe bizneset.

Për të lehtësuar identifikimin dhe monitorimin e masave për rritjen e efikasitetit të energjisë në bashkinë Mirditë, është e domosdoshme të krijohet një sistem klasifikimi. Ky sistem do të mundësojë një qasje të strukturuar dhe të qartë për menaxhimin e masave të eficiencës së energjisë, duke mundësuar përdorimin e kodeve të qarta për secilën masë. Kjo do të ndihmojë në kategorizimin dhe identifikimin e masave, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi progresin e zbatimit për të gjitha palët e interesuara.

Përveç identifikimit të lehtë, ky sistem do të kontribuojë në monitorimin e masave. Duke ndjekur progresin sipas kodeve, do të mund të identifikohen ato që janë përfunduar, ato që janë në proces dhe ato që kërkojnë vëmendje të veçantë. Kjo transparencë do të ndihmojë në menaxhimin e burimeve dhe do të sigurojë që masat e nevojshme të implementohen në kohë dhe me efikasitet.

Gjithashtu, të dhënat e mbledhura nga ky sistem mund të organizohen dhe paraqiten në mënyrë më të thjeshtë në forma raportesh për vendimmarrësit dhe donatorët, duke ofruar një bazë të fortë për raportimin e progresit dhe rezultateve. Ky sistem do të kontribuojë gjithashtu në një vendimarrje të informuar dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve.

Edhe pse jo të gjitha masat për eficiencën e energjisë janë të matshme, masat që përfshijnë projekte investimi mund të matën përmes analizave të kursimeve të energjisë. Megjithatë, ndikimi i masave administrative, si trajnimi, advokimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve, është më i vështirë për t'u matur në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky ndikim mund të vlerësohet më shumë përmes përmirësimit të kulturës së përdorimit të energjisë në komunitet, por pa mundësi për matje të saktë dhe të menjëhershme.

Në vijim, do të shpjegohen masat që janë planifikuar për të rritur eficiencën e energjisë në bashkinë Mirditë, të ndara sipas fushave.

EE1 Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Energjisë

Zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të energjisë për Bashkinë Mirditë ka për qëllim monitorimin dhe përmirësimin e përdorimit të energjisë në institucionet publike, duke siguruar eficiencën energjetike dhe zvogëluar ndikimin negativ në mjedis. Ky sistem do të përfshijë politika dhe procedura të miratuara që do të ndihmojnë në menaxhimin më të mirë të burimeve energjetike.

EE1.1 Krijimi i Kornizës për Menaxhimin e Energjisë

Masat e mëposhtme do të bëjnë të mundur krijimin e një kornize ligjore dhe institucionale të fortë, thelbësore për mbështetjen në menaxhimin e energjisë. Kjo kornizë do të përcaktojë politikat dhe procedurat e nevojshme për të siguruar implementimin e suksesshëm të masave për

rritjen e efikasitetit energjetik në bashkinë Mirditë. Do të krijohen struktura të dedikuara për menaxhimin e energjisë, të cilat do të monitorojnë përdorimin e energjisë dhe do të sigurojnë që masat për eficiencën energjetike të zbatohet në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periodha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE1.1.1	Caktimi i një Menaxheri të Energjisë për Bashkinë Mirditë për të koordinuar masat e eficiencës dhe raportimin	Emërimi i Menaxherit të Energjisë për koordinimin e masave të Eficencës së energjisë dhe raportimin e tyre	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Grup pune, bashkëpunim me institucione lokale
EE1.1.2	Përcaktimi i përgjegjësive dhe strukturave për menaxhimin e masave për eficiencën e energjisë në Bashkinë Mirditë	Krijimi i strukturave dhe përcaktimi i përgjegjësive për menaxhimin e masave EE për secilën strukturë	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Grup pune, bashkëpunim me institucione lokale
EE1.1.3	Përcaktimi i metodologjisë së raportimit	Hartimi i një sistemi të strukturuar për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave mbi konsumet energjetike dhe masat e zbatuara.	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Grup pune, bashkëpunim me institucione lokale

EE1.2 Analiza dhe vlerësimi i performancës energjetike në ndërtesat publike

Kjo masë përfshin një analizë të detajuar të performancës energjetike të ndërtesave publike për të identifikuar mundësitë e përmirësimit. Vlerësimi do të përdorë të dhëna të grumbulluara përmes auditimeve

energjetike dhe mjeteve të avancuara për të përcaktuar masat prioritare që do të implementohen, me qëllim reduktimin e konsumit të energjisë dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik në ndërtesat publike.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE1.2.1	Ngritja e databazës së ndërtesave publike në Bashkisë Mirditë	Krijimi i databazës së ndërtesave publike për të mbledhur të dhëna energjetike për monitorimin e përdorimit të energjisë.	06/2025 - 12/2027	Drejtoria përgjegjëse	Komision strategjik, afate periodike
EE1.2.2	Vlerësimi i ndikimit të ndërtesave në energji dhe mjedis, si dhe përcaktimi i masave konkrete për përmirësim e eficiencës	Analiza e konsumit të energjisë për ndërtesat publike dhe përlogaritja e ndikimit të tyre mjedisor, duke identifikuar ndërtesat me konsumin më të lartë dhe emetimet më të larta të gazeve serrë, si dhe hartimi i masave praktike për ndërtesat prioritare	06/2025 - 12/2027	Drejtoria përgjegjëse	Komision strategjik, afate periodike

EE1.3 Rritja e Kapaciteteve për Menaxhimin e Eficiencës së Energjisë

Kjo masë synon forcimin e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Mirditë, institucioneve publike dhe profesionistëve të rinj në fushën e menaxhimit të energjisë dhe promovimin e praktikave të

eficiencës energjetike. Ajo përfshin trajnime dhe zhvillim profesional që do t'u mundësojnë individëve të kualifikuar të menaxhojnë energjinë në mënyrë më efektive.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE1.3.1	Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të stafit të bashkisë dhe institucioneve publike	Trajnimi i stafit të Bashkisë dhe institucioneve publike për menaxhimin e energjisë	01/2025 - 12/2025	Njësia e komunikimit të bashkisë	Fushata informuese, partneritete me OJQ
EE1.3.2	Organizimi i trajnimeve për profesionistët e rinj mbi teknologjitë dhe praktikat për eficiencën e energjisë	Trajnime për profesionistët e rinj mbi praktikat dhe risitë në fushën e eficiencës energjetike	01/2025 - 12/2025	Njësia e komunikimit të bashkisë	Fushata informuese, partneritete me OJQ

EE1.3.3	Organizimi i trajnimeve edukative për shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet mbi kursimin e energjisë	Edukimi i nxënësve për kursimin e energjisë dhe praktikat e qëndrueshmërisë	01/2025 - 12/2025	Njësia e komunikimit të bashkisë	Fushata informuese, partneritete me OJQ
---------	---	---	-------------------------	----------------------------------	---

EE2 Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë në Ndërtesa Publike

Përdorimi i teknologjive të rinovueshme përfshin instalimin e paneleve fotovoltaike në objekte të ndryshme, si shkolla dhe kopshte, për të shfrytëzuar energjinë diellore dhe ulur varësinë nga burimet e energjisë tradicionale. Zëvendësimin e kaldajave të naftës me kaldaja elektrike ose me bazë pellet për të ulur ndotjen dhe për të rritur eficiencën e ngrohjes. Po ashtu, implementimi i sistemeve të izolimit termik dhe instalimi i termostateve inteligjent për

menaxhimin e temperaturës do të ndihmojë në kursimin e energjisë dhe përmirësimin e kushteve të brendshme.

EE2.1 Instalimi i paneleve fotovoltaike në ndërtesa publike

Instalimi i paneleve fotovoltaike në ndërtesat publike të Bashkisë Mirditë për të prodhuar energji të rinovueshme nga dielli dhe për të reduktuar varësinë nga burimet e energjisë tradicionale. Panele fotovoltaike do të instalohen në shkolla, kopshte dhe ndërtesa të tjera publike.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE2.1.1	Instalimi i paneleve fotovoltaike në Bashkinë Mirditë	Përdorimi i energjisë diellore për të furnizuar energji elektrike, duke përmirësuar eficiencën dhe ulur shpenzimet për energji.	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Procedura e tenderit, bashkëpunim me furnizues
EE2.1.2	Instalimi i paneleve fotovoltaike në Shkollën e Mesme Rrëshen	Përdorimi i energjisë diellore për të furnizuar energji elektrike, duke përmirësuar eficiencën dhe ulur shpenzimet për energji.	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Procedura e tenderit, bashkëpunim me furnizues
EE2.1.4	Instalimi i paneleve fotovoltaike Kopështin e ri Rrëshen	Përdorimi i energjisë diellore për të furnizuar energji elektrike, duke përmirësuar eficiencën dhe ulur shpenzimet për energji.	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Procedura e tenderit, bashkëpunim me furnizues

EE2.1.5	Instalimi i paneleve fotovoltaike në shkollën “Pashko Vasa”	Përdorimi i energjisë diellore për të furnizuar energji elektrike, duke përmirësuar eficiencën dhe ulur shpenzimet për energji.	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Procedura e tenderit, bashkëpunim me furnizues
EE2.1.6	Instalimi i paneleve fotovoltaike në shkollën “Nënë Tereza”	Përdorimi i energjisë diellore për të furnizuar energji elektrike, duke përmirësuar eficiencën dhe ulur shpenzimet për energji.	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Procedura e tenderit, bashkëpunim me furnizues
EE2.1.7	Instalimi i paneleve fotovoltaike Info Kulla	Përdorimi i energjisë diellore për të furnizuar energji elektrike, duke përmirësuar eficiencën dhe ulur shpenzimet për energji.	01/2025 - 12/2026	Bashkia	Procedura e tenderit, bashkëpunim me furnizues

EE2.2 Zëvendësimi i Kaldajave të naftës me Kaldaja elektrike/pellet

Zëvendësimi i kaldajave të naftës me kaldaja elektrike ose me bazë pellet do të ndihmojë

në uljen e ndotjes dhe përmirësimin e eficiencës energjitike në ndërtesat publike.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periodha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE2.2.1	Zëvendësimi i kaldajave në Shkollën 9 vjeçare “Nënë Tereza”	Përdorimi i ngrohjes me kaldaja elektrike ose me pellet për të zvogëluar ndikimin mjedisor dhe për të rritur eficiencën	01/2025 - 12/2027	Bashkia	Procedura e tenderit, specifikime teknike
EE2.2.2	Zëvendësimi i kaldajave në Shkollën 9 vjeçare “Pashko Vasa”	Përdorimi i ngrohjes me kaldaja elektrike ose me pellet për të zvogëluar ndikimin mjedisor dhe për të rritur eficiencën	01/2025 - 12/2027	Bashkia	Procedura e tenderit, specifikime teknike

EE2.2.3	Zëvendësimi i kaldajave në Kopështi i ri Rrëshen	Përdorimi i ngrohjes me kaldaja elektrike ose me pellet për të zvogëluar ndikimin mjedisor dhe për të rritur eficiencën	01/2025 - 12/2027	Bashkia	Procedura e tenderit, specifikime teknike
---------	--	---	-------------------------	---------	---

EE2.3 Sistemet e Izolimit Termik

Përmirësimi i izolimit termik të ndërtesave publike për të reduktuar humbjet e energjisë dhe për të përmirësuar efikasitetin. Kjo masë ka për qëllim uljen e humbjeve të energjisë

përmes instalimit të sistemeve të izolimit termik në ndërtesat publike, si dhe rritjen e eficiencës energjetike.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE2.3.1	Instalimi i sistemeve të izolimit termik në ndërtesën e InfoKullës për të ulur humbjet e energjisë	Izolimi termik në Info Kullë do të shërbejë për të ulur humbjet e energjisë dhe për të përmirësuar eficiencën energjetike të ndërtesës.	06/2025 - 12/2027	Njësia e menaxhimit të ndërtesave publike	Inspektime, certifikime për cilësi

EE2.4 Sisteme Inteligjente për Menaxhimin e Energjisë

Instalimi i sistemeve për menaxhimin inteligjent të energjisë për të optimizuar

përdorimin dhe për të ulur konsumimin e energjisë.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE2.4.1	Instalimi i termostateve inteligjent në ndërtesën e Bashkisë Mirditë	Instalimi i sistemeve për menaxhimin automatik të temperaturës në ndërtesat publike për të kursyer energjinë	01/2026 - 12/2027	Bashkia dhe sektori i IT	Kontrata me kompani IT, afate implementimi

EE2.4.2	Instalimi i termostateve inteligjent në pallatin e sportit "Arjana Arapi"	Instalimi i sistemeve për menaxhimin automatik të temperaturës në ndërtesat publike për të kursyer energjinë	01/2026 - 12/2027	Bashkia dhe sektori i IT	Kontrata me kompani IT, afate implementimi
---------	---	--	-------------------	--------------------------	--

EE2.5 Instalimi i Paisjeve Eficiente

Kjo masë përfshin zëvendësimin ose instalimin e pajisjeve që konsumojnë më pak energji, duke përfshirë ndriçimin LED, sistemet e ngrohjes dhe ftohjes me eficiencë të lartë, pajisjet elektroshtëpiake të klasës A+++, dhe teknologji të tjera që

redukojnë ndjeshëm konsumin e energjisë. Kjo masë synon të ulë kostot e energjisë dhe të reduktojë ndikimin mjedisor, duke promovuar një përdorim më të qëndrueshëm të burimeve energjetike.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE2.5.1	Paisja e ambienteve të Kopeshtit të ri me sistem qendror kondicionimi (multisplit, VRV, AC)	Instalimi i një sistemi të ri për ngrohje dhe ftohje për ambientet e brendshme.	01/2026 - 12/2027	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	Marrëveshje me kontraktorë të kualifikuar
EE2.5.2	Paisja e ambienteve të Info Kulles me sistem qendror kondicionimi (multisplit, VRV, AC)	Instalimi i një sistemi të ri për ngrohje dhe ftohje për ambientet e brendshme.	01/2026 - 12/2027	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	Marrëveshje me kontraktorë të kualifikuar
EE2.5.3	Zëvendësimi i paisjeve elektroshtëpiake, me paisje me eficiencë A++, në Kopështin e ri Rrëshen	Zëvendësimi i paisjeve ekzistuese me ato të klasës energjetike A++, që kontribuojnë në kursimin e energjisë dhe zvogëlimin e ndikimit mjedisor.	01/2026 - 12/2027	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit	Marrëveshje me kontraktorë të kualifikuar

EE3 Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë në Shërbimet e Bashkisë

Implementimi i teknologjive të rinovueshme dhe paisjeve efikase, përmirësimi i sistemeve të furnizimit me ujë, ndriçimit dhe flotës së automjeteve të Bashkisë, për të reduktuar konsumimin e energjisë dhe ndikimin mjedisor.

EE3.1 Përmirësimi i efciences së energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe vaditjes

Instalimi i paneleve fotovoltaike dhe pompave efikase për të reduktuar konsumimin e energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe vaditje. Përdorimi i energjisë solare për të furnizuar stacionet e ujësjellësit dhe pompave, si dhe zëvendësimi i pompave të vjetra me ato të efikase, duke kontribuar në kursimin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE3.1.1	Vendosja e paneleve fotovoltaike në stacionet e ujësjellësit për vaditje në Bukmirë	Instalimi i paneleve fotovoltaike për energji në stacionet e ujësjellësit për vaditje.	01/2025 - 12/2027	Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Prokurim, bashkëpunim me operatorë
EE3.1.2	Zëvendësimi me pompa me eficiencë të lartë në sistemet e furnizimit me ujë për të reduktuar konsumin energjetik	Zëvendësimi i pompave të vjetra me modele më efikase për të ulur konsumin energjetik.	01/2025 - 12/2027	Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Prokurim, bashkëpunim me operatorë
EE3.1.3	Vendosja e Paneleve Fotovoltaike në Stacionin e pompimit të ujit të pijshëm në Rrëshen	Instalimi i paneleve fotovoltaike për furnizim energjie në stacionin e pompimit të ujit të pijshëm.	01/2025 - 12/2027	Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Prokurim, bashkëpunim me operatorë

EE3.2 Përmirësimi i Ndriçimit Publik

Zëvendësimi i llambave të vjetra me llamba LED dhe krijimi i sistemeve të ndriçimit inteligjent që mundësojnë menaxhimin efikas

të energjisë në mënyrë që të përmirësohet ndriçimi dhe të ulen kostot e energjisë.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE3.2.1	Zëvendësimi i llambave me presion të lartë prej merkuri (HPM), CFB, halogjene dhe natriumi (HPS) me llamba LED	Zëvendësimi i llambave të vjetra me LED për të ulur konsumin energjetik dhe rritur efikasitetin e ndriçimit	01/2025 - 12/2027	Bashkia dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Procedurat e tenderit, bashkëpunim me kompani
EE3.2.2	Rritja me 25% e sipërfaqeve të zonave urbane me ndriçim LED/inteligjente	Shtimi i ndriçimit LED dhe inteligjent në zonat urbane për të rritur kursimin e energjisë	01/2025 - 12/2027	Bashkia dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Procedurat e tenderit, bashkëpunim me kompani
EE3.2.3	Instalimi i Sistemeve të ndriçimit me panele fotovoltaike dhe stacion karikimi për makina elektrike për zona urbane.	Investimi me qëllim furnizimin me energji të rinovueshme dhe stacione për makina elektrike	01/2025 - 12/2027	Bashkia dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Procedurat e tenderit, bashkëpunim me kompani
EE3.2.4	Instalimi i Sistemeve të ndriçimit me panele fotovoltaike për zona turistike	Përmirësimi i ndriçimit me burime të rinovueshme në zona turistike	01/2025 - 12/2027	Bashkia dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Procedurat e tenderit, bashkëpunim me kompani
EE3.2.5	Ndërtimi i një stacioni karikimi me panele fotovoltaike në ambientet rrethuese të Infokulles	Krijimi i një stacioni karikimi për makina elektrike me energji solare	01/2025 - 12/2027	Bashkia dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Procedurat e tenderit, bashkëpunim me kompani

EE3.3 Përmirësimi i Flotës së Automjeteve të Bashkisë

Zëvendësimi i llambave të vjetra me llamba LED dhe krijimi i sistemeve të ndriçimit inteligjent që mundësojnë menaxhimin efikas

të energjisë në mënyrë që të përmirësohet ndriçimi dhe të ulen kostot e energjisë.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE3.3.1	Zëvendësimi i automjeteve jashtë përdorimit apo standardeve me mjete miqësore me mjedisin	Furnizimi i Policisë Bashkiake me automjete elektrike për të kontribuar në uljen e ndotjes dhe përmirësimin e efikasitetit të operacioneve.	06/2025 - 12/2027	Bashkia dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Marrëveshje me furnizues automjesh
EE3.3.2	Zëvendësimi i automjeteve që mundësojnë mbledhjen e mbeturinave me makina më eficiente	Zëvendësimi i automjeteve të mbledhjes së mbeturinave me makina që kanë performancë më të lartë energjetike dhe më pak ndikim mjedisor.	06/2025 - 12/2027	Bashkia dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	Marrëveshje me furnizues automjesh

EE4 Përfshirja e Komunitetit dhe Bizneseve në Eficiencën e Energjisë

Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse dhe masave stimuluese për qytetarët dhe bizneset lokale, duke promovuar praktikën më të mira për eficiencën e energjisë, përdorimin e teknologjive të qëndrueshme dhe rritjen e përfshirjes në nismat për kursimin e energjisë.

EE4.1 Fushata Informative dhe Ndërgjegjëse për Komunitetin

Organizimi i aktiviteteve dhe fushatave informuese për rëndësinë e eficiencës së energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme. Krijimi i programeve ndërgjegjëse për qytetarët përmes aktiviteteve lokale dhe platformave digjitale, duke promovuar praktika të qëndrueshme dhe kursimin e energjisë në nivel familjar dhe komunitar.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE4.1.1	Organizimi i aktiviteteve për të informuar qytetarët për rëndësinë e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme	Informimi i qytetarëve përmes aktiviteteve për ndikimin e praktikave të mira në kursimin e energjisë dhe përfitimet e burimeve të rinovueshme.	03/2025 - 12/2027	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave	Bashkëpunim me media dhe OJQ

EE4.1.2	Përdorimi i platformave digjitale dhe mediave lokale për informim të gjerë	Shfrytëzimi i mediave lokale dhe platformave online për të përhapur informacion rreth kursimit të energjisë.	03/2025 - 12/2027	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave	Bashkëpunim me media dhe OJQ
EE4.1.3	Krijimi i një platforme online për ndarjen e praktikave dhe këshillave për kursimin e energjisë	Zhvillimi i një platforme interaktive për të ndarë informacione rreth masave të eficiencës së energjisë.	03/2025 - 12/2027	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave	Bashkëpunim me media dhe OJQ

EE4.2 Promovimi i Eficiencës së Energjisë për Bizneset

Aktivitetet për të inkurajuar bizneset të adoptojnë teknologji të gjelbra dhe të kursejnë energji. Organizimi i takimeve, panairove dhe garave për bizneset lokale, duke promovuar zgjidhje efikase për

konsumimin energjetik dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet ekonomike dhe mjedisore të masave të eficiencës së energjisë.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE4.2.1	Organizimi i takimeve informuese për bizneset lokale	Takime informuese për të prezantuar përfitimet e kursimit të energjisë dhe teknologjive të rinovueshme për bizneset lokale.		Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave	Grupet e punës, afate të konsultimeve
EE4.2.2	Organizimi i panairove të teknologjive të gjelbra dhe garave për lagje ose institucione që kursejnë më shumë energji	Promovimi i teknologjive të gjelbra dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit përmes konkurseve.	03/2025 - 12/2027	Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave	Bashkëpunim me media dhe OJQ

EE4.3 Masa Lehtësuese për Komunitetin dhe Bizneset

Lehtësira fiskale dhe financiare për komunitetin dhe bizneset që zbatojnë

praktika të mira për kursimin e energjisë. Vendorsja e masave lehtësuese si reduktimi

i taksave, promovimi i skemave kombëtare dhe krijimi i programeve shpërblyese për komunitetin dhe bizneset që implementojnë

masa për të përmirësuar eficiencën e energjisë dhe për të reduktuar konsumin energjetik.

Kodi i masës	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia për zbatimin/monitorimin	Marrëveshjet e zbatimit
EE4.3.1	Reduktim taksash për bizneset që implementojnë masa për kursimin e energjisë	Ulje të taksave për bizneset që zbatojnë praktika dhe masa të eficiencës së energjisë.	01/2025 - 12/2027	Drejtoria e Të Ardhurave, Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit,	Bashkëpunim me media dhe OJQ
EE4.3.2	Promovimi i mbështetjes nga skema kombëtare për komunitetin	Informimi i komunitetit mbi mundësitë e mbështetjes financiare nga programet kombëtare.	01/2025 - 12/2027	Drejtoria e Të Ardhurave, Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit	Bashkëpunim me media dhe OJQ
EE4.3.3	Krijimi i programit të shpërblimeve për individët dhe familjet që zbatojnë praktika të mira për kursimin e energjisë	Shpërblime për individët dhe familjet që kontribuojnë në kursimin e energjisë.	01/2025 - 12/2027	Drejtoria e Të Ardhurave, Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit	Bashkëpunim me media dhe OJQ

4.1 Pasqyra e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë

4.1.1 Analiza e Emetimeve të Gazeve të Efektit Serrë

Në përballjen me sfidat globale të ndryshimeve klimatike dhe përkushtimin ndaj tranzicionit energjetik, një tregues kyç i progresit është ulja e emetimeve të gazeve serrë për çdo njësi energjie të konsumuar. CO₂-ekuivalent për kWh është një koeficient që tregon sasinë e gazeve serrë të emetuara për çdo kilovat orë (kWh) energji të konsumuar. Ky koeficient, i shprehur në CO₂ ekuivalent, pasqyron ndikimin mjedisor të energjisë që konsumohet dhe mundëson llogaritjen e emetimeve të CO₂ për një sasi të caktuar energjie.

Reduktimi i GES, i shprehur në CO₂ eq, është një tregues që pasqyron efikasitetin e sistemeve energjetike dhe mundësinë për të zvogëluar ndikimin mjedisor përmes masave të ndryshme, duke përfshirë përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, përmirësimin e eficiencës së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, si dhe aplikimin e teknologjive inovative. Ky tregues është një mjet i rëndësishëm për të vlerësuar sa efikas janë politikat dhe masat për uljen e emetimeve të gazeve serrë, duke kontribuar në një sistem energjetik më të pastër dhe më të qëndrueshëm.

Në këtë seksion, do të analizojmë masat që do të merren dhe ndikimet e tyre, duke përfshirë masat e buta, të cilat ndihmojnë në krijimin e një strukture të qëndrueshme për menaxhimin e eficiencës së energjisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për rëndësinë e përdorimit të energjisë në mënyrë efikase. Këto masa përfshijnë trajnimin dhe edukimin e komunitetit, krijimin e sistemeve për monitorimin dhe menaxhimin e energjisë, dhe zhvillimin e politikave për promovimin e energjisë së pastër dhe eficientë. Edhe pse këto masa nuk mund të maten drejtpërdrejt në terma të CO₂ eq, ato kontribuojnë indirekt në përmirësimin e eficiencës dhe uljen e emetimeve të gazeve serrë.

Përveç masave të buta, janë të rëndësishme edhe masat infrastrukturore për rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe përmirësimin e eficiencës. Për shembull, implementimi i paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë ka një ndikim të dukshëm në uljen e CO₂ eq, pasi këto burime nuk lëshojnë gaze serrë gjatë prodhimit të energjisë. Për të llogaritur reduktimin e GES, do të konsiderojmë që për çdo 1 kWh energji të prodhuar nga panelet fotovoltaike, kemi kursyer 1 kWh energji të konsumuar nga rrjeti.

Energjia elektrike për Shqipërinë është kryesisht e prodhuar nga burime të rinovueshme, me përjashtim të rasteve kur energjia elektrike importohet nga shtetet fqinje. Për vitin 2023, energjia elektrike e prodhuar dhe eksportuar është më e lartë se energjia elektrike e importuar, duke e bërë llogaritjen tonë të reduktimit të gazeve të efektit serrë më konkrete dhe të sakte. Koeficienti i llogaritjes së reduktimit të gazeve të efektit serrë ndryshon në varësi të llojit të burimeve të prodhimit të energjisë dhe sasive të CO₂ të prodhuara në vend. Për këtë analizë, do të përdorim koeficientin 24.42 gCO₂/kWh, të përcaktuar nga raporti i EMBER.

4.1.2 Pasqyra e Kostove të Masave dhe Reduktimi i CO₂

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur disa nga masat kryesore për përmirësimin e eficiencës energjetike dhe uljen e emetimeve të gazeve serrë. Tabela përfshin informacion mbi kostot e investimeve, kursimet vjetore të energjisë, si dhe reduktimin e CO₂-ekuivalent për çdo masë. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të qartë të ndikimit të secilës masë në aspektin e kursimit të energjisë dhe uljes së emetimeve të gazeve serrë.

Në përballjen me sfidat globale të ndryshimeve klimatike dhe përkushtimin ndaj tranzicionit energjetik, reduktimi i emetimeve të gazeve serrë për njësi të energjisë së prodhuar është një tregues kyç i progresit drejt qëndrueshmërisë. CO₂-ekuivalent për kWh përfaqëson sasinë e përgjithshme të emetimeve të gazeve serrë, e shprehur si ekuivalent i dioksidit të karbonit, e cila prodhohet gjatë gjenerimit të një kilovat orë energji. Ky tregues pasqyron jo vetëm ndikimin mjedisor të burimeve të ndryshme energjetike, por edhe efektivitetin e teknologjive dhe proceseve të përdorura.

Ky kapitull analizon reduktimin e GES (Gazeve të Efektit Serrë) duke vlerësuar faktorët që ndikojnë në uljen e këtij treguesi. Përfshihen masat për rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, përmirësimin e eficiencës së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, si dhe zbatimin e politikave dhe teknologjive inovative. Analiza synon të evidentojë potencialin e ndërhyrjeve strategjike për të përmbushur objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare për uljen e emetimeve dhe për të kontribuar në një të ardhme më të qëndrueshme.

Eficienca energjetike është një komponent kyç për të reduktuar shpenzimet e energjisë, përmirësuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe për të mbështetur zhvillimin ekonomik afatgjatë. Në këtë kapitull, do të paraqitet

një vlerësim i kostove të nevojshme për investimet që lidhen me masat për përmirësimin e eficiencës energjetike, si dhe një analizë e kursimeve të pritshme të energjisë dhe kostos që do të arrihen nga zbatimi i këtyre masave.

Procesi i vlerësimit përfshin identifikimin dhe kategorizimin e masave të propozuara, vlerësimin sasior të ndikimeve të tyre dhe llogaritjen e përfitimeve ekonomike që ato sjellin. Në rastet kur nuk është e mundur të sigurohen të dhëna të veçanta për çdo masë,

do të paraqiten vlerësime të grupuara për masat e ndërlidhura.

Ky vlerësim do të ndihmojë në krijimin e një plani të qartë dhe të zbatueshëm për të arritur përmirësime të konsiderueshme në përdorimin e energjisë, duke minimizuar kostot operacionale dhe duke kontribuar në arritjen e objektivave kombëtare dhe lokale për zhvillimin e qëndrueshëm. Kapitulli përmban gjithashtu rekomandime për përparësitë që duhet të merren parasysh në procesin e zbatimit të masave.

Tabela 20. Pasqyra e Kostove të Masave, Kursimeve dhe Reduktimi i GES

Nr	Kodi i masës	Masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë	Kostot e vlerësuara të investimit (Lekë)	Kursimet vjetore të vlerësuara (MWh/vit)	Kursimet e përlllogaritura të kostos vjetore [Lekë/ vit]	Reduktimi i GES ton CO2 ekuivalent
1	EE1.1.1	Caktimi dhe trajnimi i një Menaxheri të Energjisë për Bashkinë Mirditë për të koordinuar masat e eficiencës dhe raportimin	3,000,000	n/a	n/a	
2	EE1.1.2	Përcaktimi i përgjegjësive dhe strukturave për menaxhimin e masave për eficiencën e energjisë në Bashkinë Mirditë	-	n/a	n/a	
3	EE1.1.3	Përcaktimi i metodologjisë së raportimit	-	n/a	n/a	
4	EE1.2.1	Ngritja e databazës së ndërtesave publike në bashkinë Mirditë	-	n/a	n/a	
5	EE1.2.2	Vlerësimi i ndikimit të ndërtesave në energji dhe mjedis, si dhe përcaktimi i masave konkrete për përmirësim e eficiencës	2,500,000	n/a	n/a	
6	EE1.3.1	Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të stafit të bashkisë dhe institucioneve publike	200,000	n/a	n/a	
7	EE1.3.2	Organizimi i trajnimeve për profesionistët e rinj mbi teknologjitë dhe praktikatat për eficiencën e energjisë	150,000	n/a	n/a	
8	EE1.3.3	Organizimi i fushatave edukative për shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet mbi kursimin e energjisë	300,000	n/a	n/a	
9	EE2.1.1	Instalimi i paneleve fotovoltaike në Bashkinë Mirditë	7,095,000	62	1,000,000	28.986
10	EE2.1.2	Instalimi i paneleve fotovoltaike në Shkollën e Mesme Rrëshen	720,000	40	670,000	18.496

Nr	Kodi i masës	Masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë	Kostot e vlerësuara të investimit (Lekë)	Kursimet vjetore të vlerësuara (MWh/vit)	Kursimet e përlogaritura të kostos vjetore [Lekë/ vit]	Reduktimi i GES ton CO2 ekuivalent
11	EE2.1.3	Instalimi i paneleve fotovoltaike në Konviktin Rrëshen	855,000	32	540,000	14.894
12	EE2.1.4	Instalimi i paneleve fotovoltaike në Kopështin e ri Rrëshen	990,000	43	750,000	20.331
13	EE2.1.5	Instalimi i paneleve fotovoltaike në shkollën "Pashko Vasa"	1,245,000	43	750,000	20.359
14	EE2.1.6	Instalimi i paneleve fotovoltaike në shkollën "Nënë Tereza"	465,000	41	700,000	19.489
15	EE2.1.7	Instalimi i paneleve fotovoltaike Info Kulla	360,000	22	400,000	10.269
16	EE2.2.1	Zëvendësimi i kaldajave në shkollën 9 vjeçare "Nënë Tereza"	2,350,000	0	815,000	25.202
17	EE2.2.2	Zëvendësimi i kaldajave në shkollën 9 vjeçare "Pashko Vasa"	4,225,000	0	815,000	47.314
18	EE2.2.3	Zëvendësimi i kaldajave në Kopështi i ri Rrëshen	2,200,000	0	815,000	21.528
19	EE2.3.1	Instalimi i sistemeve të izolimit termik në ndërtesat publike për të ulur humbjet e energjisë. (Info Kulla)	4,500,000	45	400,000	6.324
20	EE2.4.1	Instalimi i termostateve inteligjent në Bashkinë Mirditë	250,000	n/a	n/a	
21	EE2.4.2	Instalimi i termostateve inteligjent në Pallatin e Sportit "Arjana Arapi"	250,000	n/a	n/a	
22	EE2.5.1	Paisja e ambienteve të Kopështit të ri me sistem qendror kondicionimi (multisplit, VRV, AC)	300,000	n/a	n/a	
23	EE2.5.2	Paisja e ambienteve të Info Kullës me sistem qendror kondicionimi (multisplit, VRV, AC)	800,000	n/a	n/a	
24	EE2.5.3	Zëvendësimi i paisjeve elektroshtëpiake, me paisje me eficiency A++, në Kopështin e ri Rrëshen	600,000	n/a	n/a	
25	EE3.1.1	Vendosja e paneleve fotovoltaike në stacionet e ujësjellësit për vaditje në Bukmirë	2,500,000	35	600,000	2.625
26	EE3.1.2	Zëvendësimi me pompa me eficiency të lartë në sistemet e furnizimit me ujë për të reduktuar konsumin energjetik	1,000,000	75	1,500,000	5.625
27	EE3.1.3	Vendosja e Paneleve Fotovoltaike në Stacionin e pompimit të ujit të pijshëm në Rrëshen	5,500,000	75	2,800,000	5.625

Nr	Kodi i masës	Masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë	Kostot e vlerësuara të investimit (Lekë)	Kursimet vjetore të vlerësuara (MWh/vit)	Kursimet e përlllogaritura të kostos vjetore [Lekë/ vit]	Reduktimi i GES ton CO2 ekuivalent
28	EE3.2.1	Zëvendësimi i llambave me presion të lartë prej merkuri (HPM), CFB, halogjene dhe natriumi (HPS) me llamba LED	5,000,000	n/a	n/a	
29	EE3.2.2	Rritja me 25% e sipërfaqeve të zonave urbane me ndriçim LED/ inteligjente	6,500,000	n/a	n/a	
30	EE3.2.3	Instalimi i Sistemeve të ndriçimit me panele fotovoltaike dhe stacion karikimi për makina elektrike për zona urbane.	7,500,000	n/a	n/a	
31	EE3.2.4	Instalimi i Sistemeve të ndriçimit me panele fotovoltaike për zona turistike	5,000,000	n/a	n/a	
32	EE3.2.5	Ndërtimi i një stacioni karikimi me panele fotovoltaike në ambientet rrethuese të Infokulles	1,000,000	n/a	n/a	
33	EE3.3.1	Zëvendësimi i automjeteve jashtë përdorimit apo standardeve me mjete miqësore me mjedisin	4,500,000	n/a	n/a	
34	EE3.3.2	Zëvendësimi i automjeteve që mundësojnë mbledhjen e mbeturinave me makina më efikente	7,000,000	n/a	n/a	
35	EE3.3.3	Paisja e Policisë Bashkiake me automjete elektrike	4,500,000	n/a	n/a	
36	EE4.1.1	Organizimi i aktiviteteve për të informuar qytetarët për rëndësinë e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme	300,000	n/a	n/a	
37	EE4.1.2	Përdorimi i platformave digjitale dhe mediave lokale për informim të gjerë	100,000	n/a	n/a	
38	EE4.1.3	Krijimi i një platforme online për ndarjen e praktikave dhe këshillave për kursimin e energjisë	100,000	n/a	n/a	
39	EE4.2.1	Organizimi i takimeve informuese për bizneset lokale	200,000	n/a	n/a	
40	EE4.2.2	Organizimi i panairëve të teknologjive të gjelbra dhe garave për lagje ose institucione që kursejnë më shumë energji	500,000	n/a	n/a	
41	EE4.3.1	Reduktimi i taksash për bizneset që implementojnë masa për kursimin e energjisë	500,000	n/a	n/a	

Nr	Kodi i masës	Masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë	Kostot e vlerësuara të investimit (Lekë)	Kursimet vjetore të vlerësuara (MWh/vit)	Kursimet e përlllogaritura të kostos vjetore [Lekë/ vit]	Reduktimi i GES ton CO2 ekuivalent
42	EE4.3.2	Promovimi i mbështetjes nga skema kombëtare për komunitetin	100,000	n/a	n/a	
43	EE4.3.3	Krijimi i programit të shpërblimeve për individët dhe familjet që zbatojnë praktika të mira për kursimin e energjisë	1,000,000	n/a	n/a	

Nga analiza e të dhënave të paraqitura në tabelë, investimet që synojnë reduktimin e emetimeve të gazrave serrë (GES) janë kryesisht ato që përfshijnë instalimin e paneleve fotovoltaike dhe zëvendësimin e kalladave në institucionet publike. Disa nga pikat kyçe janë:

Zëvendësimi i kaldajave në shkollën 9-vjeçare “Pashko Vasa” ka një kursim të konsiderueshëm të GES prej 47.314 ton CO₂ ekuivalent, duke u renditur si masa me ndikimin më të madh në këtë drejtim. Zëvendësimi i kaldajave në shkollën 9-vjeçare “Nënë Tereza” ka një kursim prej 25.202 ton CO₂ ekuivalent, duke qenë investimi i dytë

më i rëndësishëm në termat e kursimeve të GES. Po ashtu, zëvendësimi i kaldajave në Kopështin e ri Rrëshen kontribuon në kursimin e 21.528 ton CO₂ ekuivalent. Këto masa janë ndër më të efektshmet për reduktimin e emetimeve të GES në krahasim me investimet e tjera, si instalimi i paneleve fotovoltaike dhe sistemeve të izolimit termik.

Në përgjithësi, investimet që përfshijnë teknologjitë e rinovueshme dhe përmirësimin e infrastrukturës së ndriçimit (p.sh., zëvendësimi i kalladave) janë parësore për arritjen e kursimeve të mëdha në emetime të GES, duke pasqyruar përpjekjet për efikasitet më të lartë në sektorin publik.

4.2 Analiza e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë

Përmirësimi i eficiencës së energjisë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe reduktimit të ndikimeve mjedisore. Një analizë e detajuar e masave të propozuara për eficiencën energjetike shërben si bazë për hartimin e strategjive efektive dhe të zbatueshme, duke siguruar që secila masë të jetë e mirëplanifikuar dhe e orientuar drejt rezultateve të prekshme.

Në këtë pjesë, masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë trajtohen me një përjasje të strukturuar, duke përfshirë përshkrimin e tyre të detajuar, oraret e

zbatimit, dhe marrëveshjet e nevojshme për realizimin e suksesshëm. Për më tepër, identifikohen burimet e mundshme të financimit, duke përfshirë investime publike dhe private, mbështetje ndërkombëtare apo partneritete strategjike, ndërsa vlerësohen rreziqet dhe sfidat që mund të pengojnë progresin.

Zbatimi i këtyre masave kërkon gjithashtu një mjedis të favorshëm, i cili përfshin një kuadër rregullator të përshtatshëm, angazhimin e aktorëve të ndryshëm dhe një nivel të lartë ndërgjegjësimi nga komuniteti dhe bizneset. Kjo analizë synon të ofrojë jo

vetëm një panoramë të plotë të masave të planifikuara, por edhe një kuptim të qartë të aspekteve praktike që ndikojnë në realizimin e tyre.

4.2.1 Analiza e Kostos dhe Përfitimeve Mjedisore dhe Sociale

Për të kuptuar më mirë ndikimin e një projekti investimi, është thelbësore të kemi një pasqyrë të qartë mbi kostot dhe përfitimet që ai sjell, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë social dhe mjedisor. Analiza e Kostos dhe Përfitimeve Mjedisore dhe Sociale (ES-CBA) është mjeti i fuqishëm që mundëson një vlerësim të detajuar të këtyre faktorëve, duke ndihmuar vendimmarrësit të marrin vendime të informuara mbi realizueshmërinë e projekteve dhe përfitimet që ato mund të sjellin për komunitetin.

Ky proces nis me identifikimin e kostove dhe përfitimeve që rrjedhin nga zbatimi i projektit. Për këtë, përdoren të dhëna nga burime të ndryshme, si literaturë, intervista me palë të interesuara dhe informacion nga Bashkia e Mirditës. Pas kësaj, ato kuantifikohen dhe monetizohen, kur është e

mundur, për të pasur një pamje më të qartë të ndikimit financiar. Një hap i rëndësishëm është krahasimi midis skenarëve “me projektin” dhe “pa projektin”, i cili ndihmon në përcaktimin e ndryshimeve reale që do të ndodhin pa ndërhyrjen e projektit dhe që mund të jenë thelbësore për vendimmarrësit.

Për të pasur një pasqyrë të plotë, analizohet gjithashtu se si do të evoluojnë kostot dhe përfitimet gjatë periudhës së referencës. Duke përdorur norma rritjeje mesatare ose trende të njohura, mund të parashikohet si do të ndikojnë këto vlera me kalimin e kohës. Pastaj, ato diskontohen për të marrë vlerat aktuale, duke përdorur një normë sociale diskontimi që mundëson krahasimin e kostove dhe përfitimeve të ardhshme me ato të sotme.

Në fund, llogariten tregues të rëndësishëm të performancës ekonomike si vlera neto aktuale (NPV), norma e brendshme e kthimit (IRR) dhe raporti përfitim-kosto (BCR). Këta tregues ofrojnë një kuptim të thellë të efikasitetit ekonomik të projektit, duke siguruar një bazë të fortë për marrjen e vendimeve të informuara dhe për vlerësimin e mundësisë së investimeve të tilla në të ardhmen.

Tabela 21. Analiza Financiare e Masave të Eficiencës së Energjisë

Kodi i masës	Masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë	Burimi i financimit	Kosto e investimit	Periudha e thjeshtë e vetëshlyerjes	IRR në %	NPV
EE1	Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të energjisë	Buxheti i pushtetit vendor /Grante nga donatorë/ programe ndërkombëtare	(Lekë)	(Vite mesatarisht)	14%	277,717
EE2	Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë në Ndërtesa Publike	Grante nga donatorë/ programe ndërkombëtare	6,150,000		16%	2,069,756
EE3	Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë në Shërbimet e Bashkisë	Buxheti i shtetit/ Buxheti i pushtetit vendor/ Grante nga donatorë/ programe ndërkombëtare	26,930,000	4.6	18%	1,914,957

Kodi i masës	Masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë	Burimi i financimit	Kosto e investimit	Periudha e thjeshtë e vetëshlyerjes	IRR në %	NPV
EE4	Përfshirja e Komunitetit dhe Bizneseve në Eficiencën e Energjisë	Buxheti i shtetit/ Buxheti i pushtetit vendor	50,000,000	2.3	15%	68,898

5. SKEMAT E FINANCIMIT DHE PLANI FINANCIAR

Hartimi dhe zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PVVEE) është një hap i rëndësishëm drejt përbushjes së objektivave për një të ardhme më të qëndrueshme energjetike. Për të arritur këtë, nevojitet një qasje e strukturuar dhe gjithëpërfshirëse për financimin, që mundëson mbështetjen e masave dhe projekteve të planifikuara.

Skema e financimit për PVVEE synon të sigurojë burimet e nevojshme financiare për realizimin e objektivave të eficiencës së energjisë në nivel vendor, duke përdorur një kombinim të burimeve publike dhe private. Kjo skemë fokusohet në identifikimin e fondeve të disponueshme, përcaktimin e instrumenteve financiare më të përshtatshme dhe zhvillimin e partneriteteve strategjike për të maksimizuar ndikimin dhe për të minimizuar kostot.

Burimet kryesore të financimit përfshijnë buxhetin vendor, fonde dhe grante nga organizata ndërkombëtare, partneritete publike-private dhe instrumente të tjera inovative financiare. Kjo qasje siguron që masat për eficiencën e energjisë, si rinovimi i ndërtesave publike, optimizimi i ndriçimit publik dhe promovimi i teknologjive të gjelbra, të jenë të realizueshme dhe të qëndrueshme në afatgjatë.

Skema do të ofrojë një bazë të fortë për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive të financimit, duke siguruar transparencë, efikasitet dhe përgjegjshmëri

në përdorimin e burimeve financiare. Kjo është një domosdoshmëri për të mbështetur përmirësimin e cilësisë së jetesës për komunitetin lokal.

Buxheti total i vlerësuar për zbatimin e PVVEE 2025 – 2028 arrin në **94,325,000** lekë.

5.1 Skemat e financimit

Për realizimin e PVVEE, financimi i masave të përfshira është i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve të tij, duke siguruar burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme. Të shumta janë mundësitë për financim që mund të përdoren, dhe ato mund të klasifikohen si masat me financim të siguruar, ato në shqyrtimi, dhe mundësitë e financimit nga burime të tjera, duke përfshirë skema alternative të financimit.

Një pjesë e konsiderueshme e masave që përfshihen në PVVEE kanë tashmë financimin e siguruar. Ky financim është siguruar përmes granteve ndërkombëtare dhe fondeve të mbështetura nga organizata të tilla si Banka Botërore, Bashkimi European, dhe agjenci të tjera financiare që janë angazhuar në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe efikasitetit energjetik. Përmaset që kanë përfituar nga këto fonde përfshijnë përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike dhe infrastrukturën, me një fokus të veçantë në implementimin e masave si izolimi termik i ndërtesave dhe përmirësimi i sistemeve të ngrohjes.

Kjo përfshin gjithashtu zhvillimin dhe mbështetje për përdorimin e energjisë diellore dhe burimeve të rinovueshme, të cilat janë kritike për arritjen e objektivave të uljes së emetimeve të gazeve të efektit serrë. Të dhënat e marra nga këto investime do të ofrojnë mundësi për të matur ndikimin pozitiv që kanë në uljen e konsumit të energjisë dhe kursimet financiare për institucionet që zbatojnë masat.

Disa masa janë ende në proces të shqyrtimit për financim. Këto masa shpesh lidhen me projekte që kërkojnë implementim në infrastrukturën më të gjërë dhe përmirësimin e shfrytëzimit të energjisë nga burime të rinovueshme. Disa nga këto masa janë në fazën e negociatave me donatorët dhe institucionet ndërkombëtare si Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe KfW, të cilat janë të angazhuara në mbështetje të zhvillimit të projekteve të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës energjetike në rajon.

Po ashtu, përmasat që lidhen me modernizimin e infrastrukturës energjetike, si dhe zhvillimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, janë të rëndësishme për uljen e varësisë nga energjia fosile dhe për avancimin drejt një ekonomie të qëndrueshme.

Për realizimin e qëllimeve të PVVEE, mund të eksplorohej burime të tjera financimi, të cilat përfshijnë programet e financimit të Bashkimit European dhe fonde ndërkombëtare si Fondi i Investimeve të Energjetikës së Pasmë dhe Fondi Global për Energjinë. Këto fonde mbështesin projekte

që kontribuojnë në zhvillimin e energjisë së pastër dhe eficiencës energjetike, duke mundësuar implementimin e masave që ndihmojnë në zvogëlimin e ndikimit negativ mjedisor dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

Po ashtu, Financimi nga Banka Europiane për Investime (EIB) dhe Banka Botërore, që janë të angazhuara në mbështetje të politikave të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të energjisë së rinovueshme, do të ndihmojnë në financimin e masave të planifikuara për përmirësimin e efikasitetit energjetik në infrastrukturën publike dhe rritjen e përdorimit të energjisë diellore dhe erës.

Këto forma alternative të financimit do të ofrojnë mundësi për të ndihmuar në implementimin e masave të PVVEE-së, duke krijuar mundësi për të arritur objektivat për uljen e emetimeve dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik në nivel lokal dhe kombëtar.

5.2 Skema e Financimit

Ky buxhet i paraqitur është një komponent kyç për realizimin e programit të planifikuar, duke siguruar fonde të nevojshme për të përmbushur objektivat e tij afatshkurtra dhe afatgjata. Analiza e burimeve të financimit dhe shpërndarjes së buxhetit në tre vitet e ardhshme është thelbësore për planifikimin dhe ekzekutimin e suksesshëm të programit. Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të detajuar të burimeve të financimit dhe shpenzimeve që do të realizohen gjatë periudhës së realizimit të programit.

Tabela 22. Burimet e financimit dhe plani financiar i përmirësimit të eficiencës së energjisë

Nr.	Burimi i financave	Viti I	Viti II	Viti III	Buxheti total
1	Buxheti i shtetit	7,600,000	9,800,000	9,800,000	27,200,000
2	Buxheti i pushtetit vendor	5,030,000	5,890,000	5,890,000	16,800,000
3	Grante nga donatorë/ programe ndërkombëtare	19,425,000	20,425,000	10,425,000	50,325,000

Financimi i programit është një komponent kyç që mundëson realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara gjatë periudhës së tre viteve. Ky buxhet siguron fonde për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve për eficiencën e energjisë dhe energjinë e rinovueshme në bashkinë Mirditë, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe ruajtjen e mjedisit. Në këtë kuadër, burimet e financimit janë të ndara ndërmjet buxhetit të shtetit, pushtetit vendor dhe granteve ndërkombëtare.

Përdorimi i këtyre burimeve financiare do të përfshijë disa aktivitete kyçe, si investime në infrastrukturën energjetike, zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme, si energjia diellore, si dhe mbështetje për administratën lokale për të menaxhuar dhe zbatuar projekte energjetike. Ky financim do të kontribuoni gjithashtu në rritjen e kapaciteteve për zbatimin e masave që do të reduktojnë ndotjen dhe do të rrisin efikasitetin energjetik, siç janë investimet për ndriçimin publik.

Megjithatë, për realizimin e plotë të objektivave të programit, është e domosdoshme të merren parasysh disa mundësi dhe sfida. Ndërkohë që burimet e financimit janë të sigurta dhe mund të mbulojnë shumicën e aktiviteteve, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të fondeve dhe koordinimit të mirëfilltë midis aktorëve të ndryshëm, për të siguruar realizimin e aktiviteteve brenda afateve të parashikuara. Disa rreziqe mund të lidhen me mundësinë e vonesave në alokimin e fondeve ose me vonesa në implementimin e aktiviteteve për shkak të procedurave administrative, si dhe me paqartësitë që mund të lindin nga ndryshimet në politikën e donatorëve.

Në përfundim, ky buxhet dhe këto burime financimi janë të mjaftueshme për realizimin e objektivave të programit, por do të kërkohej një menaxhim i kujdesshëm dhe një koordinim i ngushtë për të siguruar që këto fonde të shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe për të arritur rezultatet e dëshiruara në përputhje me nevojat dhe prioritetet e Bashkisë Mirditë.

6. REFERENCAT

Hartimi dhe zbatimi i Planit Vendor Bashkia_Mirditë. (2017). Plani i Përgjithshëm Vendor.

Bashkia_Mirditë. (2019). Statistikat e Bujqësisë. Bashkia Mirditë.

Bashkia_Mirditë. (2020).

Bashkia_Mirditë. (2020). Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane të Bashkisë Mirditë 2020-2025.

Bashkia_Mirditë. (2020). Vlerësimi i Situatës së Qeverisjes Vendore në Shqiperi – VALA 2.

Bashkia_Mirditë. (2023). Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit.

Bashkia Mirditë(2022). Raporti i Performanës 2022

Drejtoria Rajonale e OSHEE, Burrel. (2024). Statistikat e energjisë elektrike për Vitin 2023,

Shërbimi i Ujësjiellës Kanalizimeve. (2018).

Drejtoria Rajonale e SHRUK, Rrëshen, 2024, Statistikat e Ujësjiellës

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE TË SHQIPËRI, 2023

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE TË SHQIPËRI 2023 – QARQE / BASHKI, LEZH

BASHKIA MIRDITË (2024). PROGRAMI BUXHETOR AFATMEËM 2025 – 2027

GHG Protocol Global Protocol for Communities Scale Greenhouse Gas Emission Inventor

DPSHTRR. (2024). Statistikat e transportit për Bashkinë Mirditë për vitin 2023

Renewable Energy Progress Reports 2020-2021, Republic of Albania (2023)



Financuar nga
Bashkimi Evropian